Instagram. <https://www.instagram.com/p/C-QHLo4JgcM/?igsh=cWw2eHh0N2N3dDd4>
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C-Qh2krN2Br/?igsh=YjRnaHF6ZDRzMWo3>
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C-QJUGeocar/?igsh=OHBubjlyY2w3MWVw>
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C-LhbQ7RyPb/?igsh=MXd6OTVnem91ajdkaQ==>
Instagram. https://www.instagram.com/reel/C-JB_qRjx7/?igsh=ZnhjYWVyeWg3N2Y2
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C-D3RysK3m6/?igsh=dXhvbZkajRvNnJ6>
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C-IyVzDxp3Z/?igsh=M2NwbHZ4MDY5NHJ1>
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C-FuANmpu0Y/?igsh=bnZ2YXk3dm80Zmli>
Instagram. https://www.instagram.com/reel/C9928JmNm_T/?igsh=MjYxcXg5ODVtY284
Instagram. <https://www.instagram.com/reel/C-EGQAKx2oh/?igsh=eXEwb201enZocXoz>
YouTube. https://youtube.com/shorts/-svr9y-QnH8?si=m_9kvysoqx_KXFfV
YouTube. <https://youtube.com/shorts/yK2jegALr0g?si=ErM2lxJS3dxgGDJy>
Instagram. <https://www.instagram.com/reel/C9vT4EGxUDG/?igsh=eWltc3J3eWI2NTdq>
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C9vgm-RRQsN/?igsh=MXdpcHVwNXJxYjAxZg==>
Instagram. <https://www.instagram.com/reel/C9ob2QSO2-i/?igsh=MXV1cHM3YWgxMHE2ZQ==>
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C9lNc3CxfJg/?igsh=b3RjNnE3cGpyNm5o>
Instagram. <https://www.instagram.com/p/C9fl4-GRSpV/?igsh=MXV6a28xcnJuMmc5cA==>
Instagram. <https://www.instagram.com/reel/C9fKEovK662/?igsh=aDdwanc3bHAxOTZ3>
Instagram. <https://www.instagram.com/reel/C9eBwD2KAYR/?igsh=MXhvd2xvZz3M3bjZ3dQ==>

Komunikim efektiv apo propagandë? Një analizë e strategjive të komunikimit digjital të pushtetit lokal

Prof. Asoc. Dr. Ramadan Çipuri

Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit

Universiteti i Tiranës

Email: ramadan.cipuri@fhf.edu.al

Abstrakt

Ky studim hulumton përdorimin e platformave sociale nga administrata dhe pushteti lokal, duke u fokusuar në manipulimin e agjendës së publikut dhe krijimin e narrativës specifike në përputhje me interesat dhe pozicionet politike. Përdorimi i platformave sociale nga bashkitë është një mjet kyç për komunikim dhe angazhim me qytetarët, por njëkohësisht është edhe një hapësirë ku aktorët politikë mund të ndërhyjnë për të promovuar dhe përhapur mesazhet e tyre.

Analiza mbështetet mbi të dhëna parësore të mbledhura gjatë një monitorimi dy-javor të rrjeteve sociale në dy bashki të ndryshme të qarkut Shkodër, Bashkia Shkodër dhe Bashkia Pukë, si edhe intervista cilësore me dy specialistë komunikimi/menaxhues të rrjeteve sociale në këto institucione.

Studimi prezanton një analizë të thelluar mbi mënyrën se si aktorët politikë ndikojnë në përmbajtjen dhe tonin e mesazheve të postuara në platformat sociale të bashkive. Në veçanti, studimi hulumton mekanizmat dhe strategjitë kryesore të përdorura nga administrata dhe drejtuesit e pushtetit lokal për të manipuluar agjendën dhe për të krijuar një narrativë specifike në komunikimin digjital të bashkive.

Rezultatet e këtij studimi ofrojnë një kuptim më të mirë të rolit të aktorëve politikë në përdorimin e rrjeteve sociale nga bashkitë dhe kontribuojnë në hartimin e strategjive të përshtatshme për të mbështetur transparencën dhe integritetin e proceseve vendimmarrëse lokale. Kështu, ndërsa platformat digjitale ofrojnë mundësi të mëdha për ndërveprim dhe transparencë, ato shpesh përdoren për të manipuluar perceptimin publik. Komunikimi digjital i bashkive të studiuara shpesh fokusohet në përhapjen e mesazheve që theksojnë arritjet e qeverisjes vendore, duke anashkaluar çështje kritike dhe duke injoruar kritikën publike.

Fjalë kyç: propagandë, rrjete sociale, bashki, administratë lokale, pushtet lokal, komunikim strategjik.

Hyrje

Komunikim efektiv apo propagandë? Një analizë e strategjive të komunikimit digjital të pushtetit lokal

Transformimet teknologjike të fund shekullit të kaluar dhe fillim shekullit të ri, përveç risive, u shoqëruan edhe me një lloj skepticizmi lidhur me ndikimin e tyre në transparencën e institucioneve ekzekutive dhe ndikimin në zhvillimin e proceseve demokratike. Vihet re se

kritika është ndarë më dysh, në mbështetje dhe kundërshtim të mundësive të reja që prodhuan këto transformime.

Kështu, përparësitë e komunikimit digjital përgjithësisht lidhen me mundësitë se interneti mund të shërbejë si një platformë për politika të informuara dhe pjesëmarrje politike, duke rritur transparencën dhe fuqizuar qytetarët për të monitoruar aktivitetin qeveritar. Nga një qasje racionale, teorikisht platformat digjitale duhet ta bëjnë informacionin qeveritar më të arritshëm e më të prekshëm, duke krijuar hapësira për debat publik dhe transparencë të shtuar.

Nga ana tjetër, shqetësimet që ngrenë studiuesit e fushës në përgjithësi theksojnë rrezikun se komunikimi politik po kushtëzohet gjithnjë e më tepër nga aktorë të prirur për ta përdorur median si mekanizëm përcaktimi agjende dhe propagande për të promovuar interesat e tyre. Këto strategji ndikojnë në rëndësinë që publiku i kushton çështjeve specifike dhe në mënyrën se si ato perceptohen.

Në kontekstin e komunikimit digjital të institucioneve qeveritare, si ato qendrore ashtu edhe ato lokale, vërehet një prirje për përgatitjen e lajmeve dhe mesazheve publike që synojnë të favorizojnë narrativa në mbështetje të një partie, politikani ose institucioni të caktuar. Ky fenomen ngre shqetësime të rëndësishme lidhur me potencialin për manipulimin e informacionit për qëllime politike dhe ideologjike. Në këto rrethana, ekziston një rrezik i shtuar për përhapjen e propagandës politike, e cila, ndonëse e manifestuar në forma më të buta krahasuar me ato të regjimit të kaluar totalitar, përbën një kërcënim të qenësishëm për transparencën dhe integritetin e proceseve demokratike.

Ky studim analizon strategjitë e komunikimit digjital në platformat sociale të pushtetit lokal në Shqipëri - Bashkia Shkodër dhe Bashkia Pukë - duke vlerësuar përputhshmërinë e mesazheve politike me strukturat e diktura nga vetë platformat sociale, tiparet e audiencave dhe natyrën e reagimeve të tyre. Synimi është të identifikohen se *si* dhe *në çfarë mase* komunikimi digjital i dy bashkive, pjesë e të njëjtit qark, kontribuon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore, përdorimin e këtij mjedisi për propagandë politike dhe nivelin e angazhimit qytetar, si edhe për të kuptuar më mirë dallimet e ngjashmëritë në këto procese komunikimi midis bashkive të mëdha dhe atyre më të vogla.

Analiza tregon se, ndërsa platformat digjitale ofrojnë mundësi të mëdha për ndërveprim dhe transparencë, ato shpesh përdoren për të manipuluar perceptimin publik. Komunikimi digjital i bashkive të studiuara shpesh fokusohet në përhapjen e mesazheve që theksojnë arritjet e qeverisjes vendore, duke anashkaluar çështje kritike dhe duke injoruar kritikën publike. Përmbajtjet e komunikimit në rrjetet sociale shpesh janë të dizajnuara për të tërhequr vëmendjen ndaj projekteve pozitive, duke përdorur gjuhë optimiste dhe imazhe të kuruara me kujdes për të krijuar një imazh të favorshëm të administratës. Këto praktika mund të reduktojnë hapësirën për debat të hapur dhe kritik, duke e devijuar komunikimin drejt një forme propagande politike.

Ndërsa komunikimi digjital ka potencialin për të rritur transparencën dhe përfshirjen qytetare, përdorimi i tij nga stafet e administratës publike për manipulimin e informacionit dhe promovimin e agjendave specifike politike mbetet një shqetësim serioz. Për të përfitur plotësisht nga këto platforma, është e nevojshme të ketë rregullime dhe praktika që nxisin llogaridhënien dhe angazhimin qytetar, duke shmangur shkarjen drejt propagandës.

Metodologjia

Studimi mbështetet kryesisht në analizën e të dhënave sasiore parësore të mbledhura nga monitorimi dy-javor i të gjitha kanaleve online të bashkive Shkodër dhe Pukë. Ky monitorim përfshin faqet e Facebook-ut, Instagramit, TikTok-ut dhe YouTube-it të bashkive dhe kryebashkiakëve respektivë.

Përmes këtij monitorimi, u mblodhën të dhëna mbi aktivitetet dhe ndërveprimet e këtyre bashkive në mediat sociale, duke ofruar një peizazh të qartë mbi mënyrën se si përdoren këto platforma për komunikim publik dhe ndërveprim me qytetarët. Të dhënat u analizuan për të identifikuar tendencat, modelet dhe efektivitetin e strategjive të komunikimit digjital, si edhe dinamikën e ndërveprimit me publikun të bashkive të Shkodrës dhe Pukës në platformat e ndryshme sociale, duke siguruar një bazë për vlerësimin e efektivitetit dhe transparencës së komunikimit të institucioneve publike në rajonet e studiuara. Kjo bazë të dhënash na ndihmon të kuptojmë deri në ç'nivel anojnë drejt propagandës bashkitë e mëdha, krahasuar me ato më të vogla.

Monitorimi u realizua për periudhën 2-16 mars 2024, duke u përqendruar në disa variabla për të ofruar një analizë të hollësishme të komunikimit digjital. Të dhënat për çdo postim u regjistruan një ditë pas publikimit të tij.

Në veçanti, studimi analizoi llojin e platformës së komunikimit (Facebook, Instagram, TikTok dhe YouTube), tipologjinë e postimeve, personazhin kryesor të përfshirë në postime, mesazhin kryesor të përcjellë përmes këtyre postimeve, si dhe ngjashmërinë e mesazheve të shpërndara në platformat e ndryshme. Gjithashtu, u vlerësua niveli i ndërveprimit, duke përfshirë numrin e pëlqimeve, ndarjeve dhe komenteve. Një analizë e veçantë iu kushtua natyrës së dhjetë komenteve të para dhe nivelit të identifikimit të njëzet personave të parë që reagojnë ndaj secilit postim.

Në kuadër të këtij studimi, u kryen intervista me dy specialistë në fushën e komunikimit, të cilët janë të përfshirë në menaxhimin e rrjeteve sociale në bashkitë në fjalë. Për të mbrojtur identitetin e tyre për shkak të arsyeve objektive, ata kanë zgjedhur të mbeten anonimë. Intervistat me ta kanë sjellë një vlerë të shtuar për studimin tonë, duke ofruar perspektivën e brendshme të tyre mbi mënyrën se si pushteti lokal përdor rrjetet sociale dhe se si aktorët politikë mund të ndikojnë në dinamikën e tyre.

Hipoteza

Mbështetur në shqetësimet e përmendura më sipër, por edhe mbi një sërë raportesh dhe debatesh publike që lidhen me mënyrën se si pushteti vendor i përdor mediat sociale, ngritëm hipotezën e mëposhtme:

Përdorimi i platformave të mediave sociale nga bashkitë ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga përpjekjet e aktorëve politikë - administratës dhe drejtuesve të pushtetit lokal - për të manipuluar agjendën e publikut dhe për të inkuadruar lajmet/mesazhet, duke krijuar kështu një narrativë specifike në funksion të interesave dhe pozicioneve të tyre politike.

Pyetje kërkimore

Në funksion të testimit të hipotezës së mësipërme, ngritëm pyetjet kërkimore të mëposhtme:

- Si ndikon ndërhyrja e aktorëve politikë në përmbajtjen dhe tonin e mesazheve të postuara në platformat sociale nga bashkitë?
- Cilët janë mekanizmat dhe strategjitë kryesore të përdorura nga aktorët politikë për të manipuluar agjendën dhe për të krijuar narrative specifike në komunikimin digjital të bashkive?

Rishikim i literaturës

Në një studim të mëhershëm mbi vlerat e lajmit, nënvizuar 'Vdekjen e Gutenbergut në Ballkan!', ku sollëm në vëmendje rastin e Kosovës si vendi i parë evropian pa media të shkruara, por gjithashtu edhe ndër vendet kryesore evropiane në lidhje me nivelin e qasjes në internet (Saliu, Çipuri dhe Izmaku 2024, 11). Ky kontrast i thellë tregon një transformim të rëndësishëm në mënyrën se si informacioni prodhohet dhe konsumohet, duke nënvizuar tranzicionin nga media tradicionale drejt platformave digjitale dhe rëndësinë e qasjes në teknologji për zhvillimin e peizazhit mediatik modern.

Statet e përdorimit të teknologjisë në industrinë e informacionit kanë qenë objekt i një sërë debatesh akademike, duke ndarë studiuesit në dy kampe kryesore: mbështetës dhe skeptikë. Mbështetësit më së shumti argumentojnë se teknologjia përmirëson efikasitetin, qasjen dhe shpërndarjen e informacionit, duke krijuar mundësi të reja për gazetari dhe komunikim. Nga ana tjetër, skeptikët theksojnë rreziqet që lidhen me varësinë nga teknologjia, cilësinë e informacionit dhe problemet etike, si privatësia dhe manipulimi i të dhënave. Këto debate kanë reflektuar një dinamikë komplekse, ku përfitimet dhe sfidat e teknologjisë në industrinë e informacionit vazhdojnë të shqyrtohen dhe të diskutohen në literaturën akademike bashkëkohore.

Në vazhden e këtyre hulumtimeve dhe studimeve të thelluara në këtë fushë, Marshall McLuhan zgjeroi teorinë e mëhershme mbi ndikimin e zhvillimeve teknologjike duke argumentuar përmes frazës "mediumi është mesazhi" se media dhe teknologjia formojnë përvojat, perceptimet dhe shoqëritë njerëzore. (McLuhan 1964, 9). "Si mite, ato promovojnë atë që historiani David Nye e ka quajtur një vizion të 'sublimes teknologjike', një shpërthim i mirëfilltë i ndjenjës që pushton shkurtimisht arsyen për t'u frenuar prej saj" (Mosco 2004, 22).

Parë nga ky këndvështrim, determinizmi i mediave sociale na shfaqet si një shprehje e sublimes digjitale, "ku hapësira kibernetike është bërë ikona më e fundit e sublimes teknologjike dhe elektronike, e lavdëruar për karakteristikat e saj epokale dhe transhendente dhe e demonizuar për thellësinë e së keqes që mund të sjellë në mendje" (Mosco 2004, 24).

Në një debat shkencor në lidhje me determinizmin teknologjik, Christian Fuchs mbron idenë e mbivlerësimit të teknologjisë në shoqëri nga ky lloj determinizmi. Sipas tij, nuk është teknologjia, por janë vetë njerëzit brenda shoqërisë ku jetojnë që rebelohen kundër marrëdhënieve të pushtetit dhe krijojnë trazira dhe revolucione (Fuchs 2014, 255). Fuchs vë theksin në atë se 'Teoria Kritike dhe Ekonomia Politike Kritike e Medias' analizojnë se si shfrytëzimi, dominimi, komodifikimi dhe ideologjia ndërveprojnë në formësimin e komunikimit mediatik në shoqëri, çfarë potencialesh për alternativa ekzistojnë dhe si mund t'i përdorin dhe

avancojnë këto potenciale betejat. Por, sipas tij, dukuritë shoqërore shprehen thjesht në komunikim dhe hapësirat teknologjike; teknologjitë nuk i shkaktojnë ato. Përkundër kësaj, determinizmi teknologjik fut fuqinë në teknologji; ai redukton fuqinë në një fenomen teknologjikisht të menaxhueshëm dhe në këtë mënyrë neglizhon ndërveprimin e teknologjisë dhe shoqërisë (Fuchs 2014, 137).

Megjithatë, duke filluar nga ngjarjet e 2011-ës, 'Pranvera Arabe', protesta të tjera në Amerikën e Veriut, në Greqi e në Spanjë, etj., dhe ngjarje të tjera të mëvonshme, media sociale ka luajtur në vazhdimësi rol të rëndësishëm në mobilizimin e qytetarëve dhe në shpërndarjen e informacionit (Gërguri 2021, 57).

Në një analizë krahasuese mbi mediat e vjetra dhe të reja, Andrew Chadwick, funksionimin e tyre e trajton brenda logjikës që buron nga teoria që ai zhvilloi mbi të ashtuquajturin 'sistem hibrid i medias'. Sipas tij, përtej dallimeve që mund të ekzistojnë mes tyre, mediat e reja dhe të vjetra i shërbejnë të njëjtit qëllim. "Ky sistem është ndërtuar mbi ndërveprimet ndërmjet logjikave të vjetra dhe më të reja mediatike - ku logjikat përcaktohen si teknologji, zhanre, norma, sjellje dhe forma organizative - në fushat e lidhura në mënyrë reflektive të medias dhe politikës" (Chadwick 2013, 4). Chadwick vlerëson se arsyetimet mediatike më të vjetra dhe më të reja në fushën e medias dhe politikës përzihen, mbivendosen, ndërthuren dhe evoluojnë së bashku. Kështu, për Chadwick, të menduarit në mënyrë hibride ofron një prirje të dobishme për të studiuar se si ndërveprojnë aktorët politikë, publiku dhe mediat e të gjitha llojeve.

Siç e theksuam edhe më sipër, studimet mbi mediat sociale dhe komunikimit që zhvillohet përmes tyre mund të ndahen në dy drejtime kryesore. Në njërën anë janë studiuesit me pikëpamje pozitive për rolin dhe rëndësinë e medias sociale në shoqëritë bashkëkohore, kurse, në anën tjetër janë ata të cilët e shohin me skepticizëm idenë se media sociale e ka përmirësuar shoqërinë për mirë, madje disa janë mjaft kritik duke theksuar se media sociale vetëm sa e ka shtuar numrin e levave që përdoren lehtësisht nga elitat politike e ekonomike për qëllimet e tyre (Gërguri 2021, 56).

Një grup autorësh si Clay Shirky, Zizi Papacharissi, Corinna di Gennaro, William Dutton, Homero Gil de Zuniga, Stefan Stieglitz dhe Linh Dang-Xuan mbështesin kryesisht pikëpamjet pozitive për rolin dhe rëndësinë e mediave sociale në shoqëri. Ndër të tjera, ata i mëshojnë përfitimeve që burojnë nga këto media, si rëndësia që ato kanë në lirinë e shprehjes, zgjerimin e hapësirës publike për diskutim, rritjen e alternativave për angazhim politik, zhvillimin e aftësive kritike për leximin dhe kuptimin e përmbajtjeve mediale.

Në një kontekst ku pjesëmarrja në debatet publike është më e hapur se kurrë më parë, pavarësisht pikëpamjeve kontradiktore që mund të kenë, individët, të lidhur me grupe të ndryshme përtej rrethit të tyre të zakonshëm, mund të kontribuojnë me ide të vlefshme, por edhe të përfitojnë nga pikëpamjet e të tjerëve. Sipas Shirky, ky fenomen ngjason me një formë kreativiteti të ngjashme me biznesin e import-eksportit. Një ide e zakonshme brenda një grupi mund të përbëjë një pasqyrë të vlefshme për një grup tjetër (Shirky 2008, 166).

Përfshirja në aktivitete vullnetare të kësaj natyre, nxit lidhjet dhe bashkëpunimin midis anëtarëve të komuniteteve online, në një mënyrë të tillë që e bën qytetarin pjesë të një

marrëdhënieje që lulëzon midis pushtetit dhe individëve, duke nxitur kështu zhvillimin e një demokracie më të shëndetshme (Gil de Zúñiga, Valenzuela dhe E. Weeks 2016, 4).

Për sa u përket institucioneve publike, shumë studiues vlerësojnë aspektin pozitiv të komunikimit digjital në mediat sociale. Rëndësi ka që këta institucione marrin pjesë aktive në komunikimin politik bazuar në përdorimin e këtyre mediave, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. “Në këtë mënyrë, mediat sociale përfaqësojnë mjetin ideal dhe bazën e informacionit për të vlerësuar opinionin publik mbi politikën dhe pozicionet politike, si dhe për të krijuar mbështetjen e komunitetit për kandidatët që konkurrojnë për poste publike” (Stieglitz dhe Dang-Xuan 2012, 2).

Në një botim të detajuar mbi komunikimin politik në mediat digjitale, studiuesi nga Kosova Dren Gërguri zgjeron diskutimin se krahas mundësive të mësipërme, mediat sociale kanë sjellë edhe mundësinë e manipulimit online. Sipas tij, kjo nuk do të thotë se këto media sociale nuk e fuqizojnë demokracinë, sepse, propagandë e manipulim ka pasur edhe në mediat tradicionale, gazetë, radio e televizion. Por, duhet kërkuar në vazhdimësi llogari nga udhëheqësit e mediave sociale, të cilët, tashmë, nëpërmjet algoritmeve, po mëtojnë të mbajnë diskutimet publike online, pa shpërfaqje të urrejtjes kombëtare, racore apo gjinore (Gërguri 2021, 60).

Përkundër konceptit të demokratizimit të sferës publike, ekziston një pikëpamje kritike që argumenton se komunikimi digjital mund të përdoret gjithashtu për të manipuluar dhe kontrolluar opinionin publik, duke forcuar agjendat propagandistike në vend të promovimit të një debati të hapur dhe të drejtë. “Kjo pikëpamje na përball me monopolin e informacionit që rrjedh nga platformat e rrjeteve sociale, kapitalizmin e informacionit dhe rolin e këtyre platformave në përqendrimin dhe kontrollin e tij” (Tufa dhe Çela 2022, 54).

Në lidhje me këtë shqetësim, Alban Tartari nënvizon se qytetarët sot përballen me dy elementë të rëndësishëm: mbytjen nga komunikimet publike dhe orientimin final bazuar në interesin e dhënësit të këtij informacioni / komunikimi. “Është e qartë se komunikimet publike sot synojnë mbi të gjitha t'i shërbejnë dhënësit. Dhe kur parësor është dhënësi, marrësi kthehet në një pikë fundore, koka e të cilit duhet të jetë në shërbim të pikës parësore” (Tartari 2021, 20-21). Pra, sipas Tartarit, marrësi nuk ka asnjë vlerë. Ai merr vlerë vetëm kur pranon, tund kokën në shenjë pohuese, për gjithçka që i jep dhënësi.

Vlerësuar në këtë këndvështrim, në literaturë së fundmi ka nisur të përdoret koncepti ‘*sharp power*’, (fuqi e mprehtë), fuqi as e butë, as e fortë. Kjo ka të bëjë me tentativën e një shteti apo aktorësh shtetërorë për manipulim të përmbajtjes në internet, përfshirë edhe në medie sociale (Gërguri 2021, 60).

Malcolm Gladwell, Evgeny Morozov, Jan Van Dijk dhe Michael Delli Carpini janë një grup autorësh që i bashkohen skepticizmit në lidhje me rolin e mediave sociale në fushën e komunikimit publik dhe politik. Shqetësimet e tyre përgjithësisht adresojnë çështje si manipulimi i përmbajtjeve në internet, ekspozimi i përdoruesve ndaj përmbajtjeve që gjenerohen në mënyrë algoritmike varësisht interesit në një moment të caktuar dhe lënia jashtë vëmendjes e informacioneve që mund të jenë më të rëndësishme, çështjet që lidhen me pronësinë e këtyre mediave dhe interesat e pronarëve të tyre, humbja e rolit të gazetarit si “gatekeeper” dhe

gjenerimi i përmbajtjeve nga përdoruesit duke i kthyer këta në burime informacioni të pa filtruara në mënyrë profesionale, etj.

Këto qëndrime arsyetohen edhe falë faktit se audiencat, shumica dërrmuese e të cilave kanë nivele të ulëta të edukimit mbi median dhe informacionin, janë kryesisht online dhe prania e tyre mund të gjurmohet në çdo çast. Ky realitet nxit burimet e informacionit të reflektojnë në kohë reale lidhur me natyrën e mesazhit që përcjellin. Prandaj, ekziston një rrezik i shtuar për manipulimin dhe ndikimin e opinionit publik përmes mesazheve të kurdisura dhe të kontrolluara në mënyrë rigorozë.

Pavarësisht mundësive për një qasje në rrjet ose jo, statistikave tregojnë se në vitin 2024, numri i përdoruesve të internetit në mbarë botën ishte mbi 5.3 miliardë, ku një person mesatarisht përdor 6.7 rrjete të ndryshme sociale në muaj, që do të thotë se rreth dy të tretat e popullsisë globale janë aktualisht të lidhur aktiv me rrjetin botëror (Statista.com 2024).

Referuar statistikave të tre mujorit të parë të vitit 2024, niveli i përdorimit të Facebook-ut arriti në rreth 89 për qind të atyre që kanë akses në internet, pasuar nga Instagram me rreth 80%. TikTok është platforma me rritjen më të shpejtë prej 100% të përdoruesve midis 2020 dhe 2022. Midis tremujorit të tretë 2022 dhe tremujorit të tretë 2023, përdoruesit aktivë mujorë të TikTok u rritën me 13%. Numri i përdoruesve të mediave sociale në mbarë botën u rrit me 320 milionë njerëz nga janari 2023 deri në janar 2024. Ndërkohë, sasia e kohës që përdoruesit e internetit shpenzojnë në mediat sociale ka pësuar një rënie të lehtë, në 143 minuta në ditë (Sprout-Social 2024).

Platformat e mediave sociale përdorin algoritme për qëllime të ndryshme arkitekturore, organizimi dhe moderimi të përmbajtjes. Por nga ana tjetër, publiku njih shumë pak detaje në lidhje me funksionimin e brendshëm të këtyre algoritmeve (Çipuri 2023, 123).

Rrjedhimisht, mediat sociale kanë pasur një ndikim të thellë në procesin e komunikimit politik, duke zhvendosur sferën publike të këtij komunikimi nga mjediset fizike në ato digjitale. Ky transformim ka ndryshuar mënyrën se si informacioni politik shpërndahet dhe perceptohet, duke krijuar një arenë të re për ndërveprim dhe debat publik. Kështu, kjo sferë, një komponent themelor dhe i rëndësishëm i demokracive moderne, është hapur tashmë për praktika dhe aktorë të rinj.

Të gjitha këto transformime janë shoqëruar edhe me një shqetësim të shtuar se komunikimet e kësaj natyre janë bërë objekt i formave të ndryshme të kontrollit dhe mbikëqyrjes. Partitë politike, qeveritë, korporatat apo aktorë të tjerë të interesuar po i përdorin teknologjitë e reja për të monitoruar dhe ndikuar në komunikimet publike dhe private. Kjo mbikëqyrje, siç mund të përdoret për të promovuar sigurinë dhe për të parandaluar krime, gjithashtu mund të kërcënojë edhe liritë qytetare dhe të drejtat e njeriut.

Kur bëhet fjalë për mënyrën e përdorimit të mediave sociale në kontekstin e zgjedhjeve politike, vëmë re se ato më së shumti shfrytëzohen për dy qëllime: "E para fokusohet në mundësinë e përdorimit të sinjaleve të mediave sociale për të parashikuar zgjedhjet politike. [...] E dyta heton sjelljet, opinionet dhe temat me interes politik të përdoruesve të mediave sociale, ndonjëherë duke propozuar metoda për të identifikuar rreshtimet e tyre politike." (Yang, etj. 2016, 332).

Ka disa faktorë që inkurajojnë qeveritë vendore të përdorin mediat sociale për përmirësimin e demokracisë, inkurajimin e pjesëmarrjes dhe njohurive të qytetarëve për proceset politike. Këta faktorë mund të diskutohen nga kornizat e kontekstit ekonomik, politik, administrativ dhe social. Ndërkohë, krizat ekonomike dhe financiare mund të rrisin përdorimin e mediave sociale nga pushteti vendor (Sobaci 2016, 6).

Një grup studiuesish nga Universiteti i Indianas në SHBA zhvilluan një analizë të sjelljes së politikanëve jo vetëm gjatë fushatave elektorale, por më shumë pas zgjedhjes së tyre. Kështu, sipas tyre, mediat sociale i lejojnë politikanët të përcaktojnë agjendën e tyre politike dhe të arrijnë drejtpërdrejt audiencën që dëshirojnë (Yang, etj. 2016, 333).

Nga aspekti teorik, kjo shpjegohet me supozimet e Maxwell McCombs dhe Donald Shaw në 1972 për teorinë e njohur të "Përcaktimit të agjendës" (*Agenda Setting Theory*), e cila shpjegon efektet e komunikimit masiv dhe ndikimit të masmedias në shoqëri. Ajo vë theksin në rolin e mediave dhe mjeteve të komunikimit masiv për të zgjedhur çështje të caktuara dhe për t'ua shërbyer, duke i nxitur ato t'i perceptojnë këto tema si më të rëndësishmet.

Lindita Camaj, Erlis Çela dhe Gjylie Rexha (2023), analizuan logjikën e audiencës në raportimin e lajmeve zgjedhore në Facebook, duke u fokusuar në atë se çfarë e shtyn angazhimin e saj në demokracitë në tranzicion, konkretisht në Shqipëri dhe Kosovë. Ata arritën në përfundimin se konteksti socio-politik është një faktor vendimtar që përcakton angazhimin me lajmet online, duke vlerësuar se partitë politike mobilizojnë bazën e tyre të votuesve në mediat sociale me synimin për të krijuar një klimë opinioni që i favorizon ato si kryesuese, duke rritur potencialisht numrin e angazhimeve të Facebook me raportimin e lojërave strategjike. "Për më tepër, postimet në Facebook që theksonin karakteristikat e kandidatit kishin më shumë gjasa të gjeneronin reagime dhe komente më të larta të përdoruesve. Këto rezultate sugjerojnë se personalizimi i lajmeve ka potencialin për të angazhuar votuesit në diskutimin e lajmeve që mund të kontribuojnë në mësimin dhe pjesëmarrjen e votuesve" (Camaj dhe Çela 2023, 49). Kjo ka nxitur një debat të shtuar mbi rolin e komunikimit digjital në mediat sociale në funksion të propagandës politike.

Mjafton një vrojtim sipërfaqësor i debatit publik, por edhe i përmbajtjeve informative të mediave tradicionale dhe të reja, për të kuptuar që burimi kryesor i çështjeve më të debatuar janë ato që përcaktohen nga burimet politike të informacionit. Këto tema variojnë nga ekonomia dhe edukimi, deri te shëndetësia, politika e jashtme, energjia, mjedisi, lëvizja e popullsisë, e shumë të tjera të ngjashme me to.

Organizimi i zyrave të marrëdhënieve publike dhe komunikimit në pushtetin lokal

Roli, misioni dhe funksionimi i zyrave të marrëdhënieve publike dhe komunikimit në pushtetin lokal në Shqipëri përgjithësisht parashikohet në akte të brendshme rregullatore, që mbështeten mbi parimin e transparencës.

Bashkitë e mëdha, kanë një strukturë të mirë organizuar që mbulojnë disa fusha të rëndësishme të komunikimit. Në rastin e Bashkisë Tiranë, më e madhja në vend, ajo ka "një strukturë të MP-ve për ndërtimin e komunikimit me qytetarët, [...] sektori i marrëdhënieve me

median, [...] sektori i publikimeve zyrtare dhe [...] një strukturë për imazhin e qytetit” (Tartari 2021, 102-103).

Në rastin e Bashkisë Shkodër, në organigramën e saj ndodhet “Zyra e Komunikimit dhe promovimit të territorit”, e cila nga detyrat dhe përgjegjësitë që i përcaktohen në rregulloren “për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës” përfshihet më shumë në çështjet e promovimit të turizmit. Marrëdhëniet publike dhe komunikimi me median parashikohet në nenet 19, 20 dhe 31 të kësaj rregulloreje, të mbështetur nga detyrimet që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Kështu, “Zyra e komunikimit me median” është përgjegjëse për administrimin e çdo çështjeje që lidhet me monitorimin e përditshëm dhe konstant të medias së shkruar, vizive dhe online, si dhe informimin e plotë për mediat dhe qytetarët mbi pasqyrimin e aktiviteteve të Bashkisë Shkodër. Ajo siguron shkallë maksimale të transparencës së komunikimeve në interes të institucionit dhe qytetarëve, me qëllim arritjen e objektivave dhe përmbushjen e rezultateve të kërkuara nga kjo njësi organizative nëpërmjet përdorimit eficient dhe efikas të burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion të tij.⁶

Ndër të tjera, kjo zyrë monitoron nga afër aktivitetet që zhvillohen nga bashkia Shkodër duke u kujdesur për pasqyrimin korrekt të tyre dhe monitoron përcjelljen e lajmeve pranë mediave respektive, duke siguruar shkallë maksimale të transparencës së komunikimeve, në interes të institucionit dhe qytetarëve.⁷

Në organigramën e Bashkisë Pukë të publikuar në faqen zyrtare në internet, nuk gjendet asnjë drejtori që në emërtimin e saj të përfshijë shërbimet e marrëdhënive me publikun dhe komunikimit me median.⁸ Referuar dokumentacionit të publikuar në faqen e saj, Këshilli Bashkiak i kësaj bashkie ka një rregullore “për marrëdhëniet e këshillit bashkiak me publikun dhe median”. Kjo rregullore parashikon se Këshilli Bashkiak ka ndërfaqen e tij në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë, si dhe median sociale zyrtare të tij, së paku Facebook dhe Twitter (Sot X, shënim nga autori).⁹ Aktivitetet e Këshillit, komisioneve dhe këshilltarëve pasqyrohen në faqen e internetit të Bashkisë, në një ndërfaqe të veçantë, dhe në median sociale të Këshillit. Komunikimi me median në emër të Këshillit mbahet nga Kryetari. Njoftimet për median hartohen dhe firmosen nga Kryetari i Këshillit dhe bëhen publike nga Sekretari.¹⁰

Ndërkohë, sipas një dokumenti të publikuar në faqen e Bashkisë Pukë në lidhje me organizimin e personelit dhe trajtimin financiar, rezulton se ka vetëm një specialist për marrëdhëniet me publikun dhe zëdhënës për mediat, i atashuar pranë kryetarit të Bashkisë.¹¹ Zyrat e mirë strukturuara të MP dhe komunikimit kërkojnë profile të ndryshme me detyra të mirë përcaktuara, ndër të cilët mund të përmendim hartuesit e teksteve, folësit publikë, prodhuesit e

⁶ Rregullore për “organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës”, Bashkia Shkodër, Neni 31
⁷ Rregullore për “organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës”, Bashkia Shkodër, Neni 31, pika 31.4, 31.5

⁸ <https://bashkiapuke.gov.al/organigrama-e-bashkise-puke/>, vizituar më 10 qershor, 2024

⁹ Rregullore “për marrëdhëniet e këshillit bashkiak me publikun dhe median”, Neni 7, Bashkia Pukë

¹⁰ Rregullore “për marrëdhëniet e këshillit bashkiak me publikun dhe median”, Nenet 48 dhe 49, Bashkia Pukë

¹¹ <https://bashkiapuke.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Vendim-nr-52-dt-05.01.20211.pdf>, vizituar më 10 qershor, 2024

përmbajtjeve, fotografët dhe kameramanët, ekspertët e faqeve të internetit, ekspertët e mediave sociale, monitoruesit dhe raportuesit, ekspertët e PSK-së dhe misionëve sociale, organizatorët, negociatorët, strategjistët dhe korrektorët letrarë. (Tartari 2021, 167)

Kjo mënyrë organizimi do të përbente një standard ideal të zyrave të MP dhe komunikimit, teksa është pothuajse e vështirë për bashkitë e vogla, por jo e pamundur për atë të kryeqytetit apo ndonjë tjetër të madhe. E vërteta e bashkive të vogla është se detyrat e mësipërme u besohen një grupi të vogël specialistësh, të cilët ndjekin pothuajse të gjithë zinxhirin e prodhimit, publikimit të përmbajtjeve digjitale dhe analizimit të reagimeve të publikut.

Në këtë pikë, vlen të theksojmë se në institucionet qendrore dhe lokale, krahas disa problemeve të tjera, roli i zëdhënësve dhe personave që komunikojnë me publikun, median dhe aktorët e interesuar mbi aktivitetet e institucioneve është në rënie të vazhdueshme.

Vëmendja po anon mbi imazhin në vend të aftësive profesionale. Zëdhënësit, aty ku janë të pranishëm, kryesisht luajnë rolin e folësve publik që artikulojnë mesazhe të parapërgatitura, pa iu përgjigjur interesimit të medias për çështjet institucionale. Kjo tregon një përqendrim të zëdhënësve te 'forma dhe imazhi', më shumë sesa te përmbajtja dhe aftësitë komunikative.

Vëmendja po anon mbi imazhin më shumë se sa në aftësitë profesionale. Zëdhënësit në fjalë, edhe kur janë të pranishëm, përgjithësisht shfaqen me rolin e një folësi publik, që artikulon një mesazh të parapërgatitur, pa iu përgjigjur interesimit të medias mbi çështjet që lidhen me institucionin në fjalë.

Një pikë e rëndësishme që kërkon vëmendje është mënyra si institucionet, veçanërisht ekzekutive, përdorin influencues të njohur për publikun dhe ndikimin e tyre. Ka një tendencë në rritje që aktorët politikë dhe zyrat e komunikimit të identifikojnë dhe të përfshijnë këta personazhe në fushatat e tyre. Lënia e mesazheve publike dhe imazhit të institucioneve në dorën e këtyre personazheve tërheqës për ekranet, por pa aftësitë profesionale të nevojshme, rëndon dhe dëmton rolin e profesionistëve të komunikimit dhe cilësinë e mesazheve të transmetuara.

Kjo praktikë ndihmon në manipulimin politik përmes përdorimit të influencuesve dhe përbën një strategji që dëmton cilësinë e komunikimit institucional duke favorizuar imazhin mbi aftësitë profesionale të komunikatorëve.

Analizë e të dhënave dhe gjetje

Edhe në vitin 2024, Facebook mbetet platforma sociale më e përdorur nga drejtuesit e qeverisjes vendore në dy bashkitë e përzgjedhura, duke shërbyer si mjet kryesor për komunikim publik, angazhim qytetar dhe shpërndarje të informacionit qeveritar, si dhe duke ndikuar kështu në transparencën dhe pjesëmarrjen demokratike lokale. Në këtë rast vihet re se numri i postimeve gjithsej rritet në raport të drejtë me madhësinë e bashkisë, ku ajo e Shkodrës ka një mesatare ditore prej 14.5 postimesh përmes platformave të ndryshme, përkundrejt rreth 6.5 postimesh në kanalet e komunikimit digjital të Bashkisë Pukë. (Tabela 1)

Në rastin e Bashkisë Shkodër, vihet re një tendencë për t'u dhënë përparësi mesazheve që burojnë nga faqet zyrtare të kryetarit të bashkisë. Kjo praktikë, reflekton një strategji të centralizuar komunikimi. Duket qartë që ky fokus i komunikimit nga figura e kryetarit përpiqet të forcojë imazhin e lidërshiptit.

Tabela 1 - Numri i postimeve në PMS nga bashkitë Shkodër dhe Pukë gjatë periudhës së monitoruar 2-16 mars 2024

		Platforma e komunikimit				
		Facebook - Bashki	Facebook - Kryetari	Instagram - Bashki	Instagram - Kryetari	TikTok - Kryetari
Bashkia	Pukë	46	28	16	2	0
	Shkodër	51	65	10	63	14
Total		97	93	26	65	14

Burimi: Ramadan Çipuri, Olta Jahaj, 2024

Ky model komunikimi përforcon shqetësimin që buron nga teoritë që lidhen me kultin e individit dhe studimet mbi liderët autoritarë, si edhe përpjekjet e tyre për të krijuar dhe ruajtur një imazh të fuqishëm, të pagabueshëm dhe imponues. Max Weber, kur fliste për liderin karizmatik, sillte në vëmendje nga njëra anë fuqizimin e tij, nga ana tjetër minimizimin e rolit të institucioneve. Në këndvështrimin e Weber, karizma bazohet në një marrëdhënie shoqërore midis mbajtësit dhe besimtarit të saj. Pra, cilësia e karizmës ndërlihet nga mënyra se si paraqitet lideri dhe niveli i vlerësimit nga ndjekësit e tij. “Weber theksonte se në një marrëdhënie karizmatike, nuk ka rregulla procedurale, nuk ka akte juridike abstrakte dhe nuk ka juridiksion racional. Ndërsa juridiksioni formal ekziston rast pas rasti në lidhje me përmbajtjen, mbajtësi i karizmës pretendon ‘imperativa të reja’. Lideri karizmatik krijon një pozicion të ri drejtues për veten e tij, si dhe pozicionin shoqëror të personave të bindur, d.m.th. të ndjekësve” (Lepsius 2013, 90).

Dëshira për të qenë të pranishëm në postimet publike vihet re në të dyja bashkitë. Në rreth 57 për qind të postimeve, ose 29 nga 51 gjithsej, që kanë një personash kryesor në platformat sociale të Bashkisë Shkodër, kryebashkiaku është në qendër të vëmendjes. Nga ana tjetër, ky fenomen vihet re në 11 nga 15 postime të tilla në Bashkinë Pukë (Tabela 2).

Tabela 2 Personazhi kryesor në postime

		Bashkia * Personazhi kryesor në postim							Total
		Personazhi kryesor në postim							
		Anëtarë të qeverisjes lokale	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë - Anëtarët e Qeverisë	Pasuri publike	Person publik i qytetit	Tjetër	
Bashkia	Pukë	2	11	2	0	0	0	77	92
	Shkodër	2	29	0	12	2	6	152	203
Total		4	40	2	12	2	6	229	295

Burimi: Ramadan Çipuri, Olta Jahaj, 2024

Postimet me përmbajtjeje imazhesh fotografike të shoqëruara me tekst zënë gjysmën e postimeve në total në rastin e Bashkisë Shkodër dhe rreth 85 për qind në rastin e Bashkisë Pukë. Pavarësisht se përmbajtjet filmike në format videosh mendohet se kanë një avantazh për shkak të aftësisë së tyre për të tërhequr dhe mbajtur vëmendjen, për të krijuar angazhim emocional dhe për të transmetuar mesazhe komplekse në mënyrë më gjithëpërfshirëse, përdorimi i fotografive dominonin ndjeshëm përmbajtjen online të këtyre bashkive. (Tabela 3)

Tabela 3 Lloji i postimit sipas bashkive Shkodër dhe Pukë

Bashkia * Lloji i postimit							
		Lloji i postimit					Total
		Foto	Tekst	Tekst+Foto	Tekst+Video	Video	
Bashkia	Pukë	0	4	78	10	0	92
	Shkodër	1	0	101	97	4	203
Total		1	4	179	107	4	295


Burimi: Ramadan Çipuri, Olta Jahaj, 2024

Nga një vërtetim kritik i kanaleve të komunikimit online, në të dyja bashkitë vihet re se mesazhet në to janë të thjeshta, që përcjellin pak detaje dhe nuk thellohen në aspekte që mund të jenë shqetësuese për banorët e zonave. Kjo prirje mund të shpjegojë edhe përdorimin e shtuar të fotografive, të cilat kanë një ndikim të madh në përcjelljen e mesazheve të thjeshta dhe të drejtpërdrejta.

Ndërkohë, postimet me video, ndonëse tërheqin më shumë vëmendjen dhe kanë një ndikim më të madh emocional tek audiencat, gjithashtu mund të identifikojnë më lehtësisht çështjet problematike të zonave të caktuara. Përdorimi strategjik i imazheve dhe videove në komunikimin publik nga qeverisja lokale synon jo vetëm të angazhojë dhe informojë qytetarët, por edhe të manipulojë perceptimet publike dhe të theksojë aspekte pozitive, duke minimizuar vizibilitetin e problemeve dhe kritikave.

Investimet në nivel bashkie zënë një vend të rëndësishëm në postimet në rrjetet sociale. Shumica e postimeve që kanë për personazh kryesor kryetarët e bashkive lidhen me investimet e realizuara nga bashkitë.

Figure 1 Mesazhi kryesor i postimit sipas bashkive



Mesazhet që lidhen me promovimin e qytetit, sportin, artin dhe kulturën, të cilat përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të postimeve gjithsej, janë një kombinim i imazheve audio dhe video

të shoqëruara me tekst. Kjo qasje e integruar synon të maksimizojë ndikimin vizual dhe emocional të përmbajtjes, duke informuar dhe angazhuar qytetarët në mënyrë efektive. Përdorimi i mediave të ndryshme për të shfaqur investimet dhe aktivitetet kulturore të bashkive tregon për një strategji të mirë përcaktuar të komunikimit të tyre publik (Figura 1, Tabela 4).

Tabela 4 Mesazhi kryesor i postimit

Platforma e komunikimit * Mesazhi kryesor i postimit								
		Mesazhi kryesor i postimit						Total
		Investim i bashkisë	Investim i qeverisë	Promovi m i qytetit	Sport, art, kulturë	Takim/vizitë rutinë	Tjetër	
Platforma e komunikimi	Facebook - Bashki	22	2	10	41	2	20	97
	Facebook - Kryetari	24	1	21	23	8	16	93
	Instagram - Bashki	7	0	8	3	0	8	26
	Instagram - Kryetari	17	1	15	16	8	8	65
	TikTok - Kryetari	2	0	6	4	1	1	14
Total		72	4	60	87	19	53	295

Burimi: Ramadan Çipuri, Olta Jahaj, 2024

Pavarësisht përdorimit të platformave të ndryshme sociale nga bashkitë e monitoruara, vërehet një fenomen që bie ndesh me parimet e pluralizmit të informacionit: *mesazhi politik i unifikuar*.

Në fakt, ky mesazh, i cili është i njëjtë në të gjitha kanalet e komunikimit është tregues i së paku dy gjërave: *e para*, mungesë profesionalizmi të stafeve të bashkive për të përgatitur përmbajtje të posaçme sipas strukturave që dikton secila platformë komunikimi social. Format dhe modelet e postimeve ndryshojnë nga një platformë në tjetër. Instagrami dhe TikTok-u janë platforma vizuale, të fokusuara kryesisht në shpërndarjen e imazheve dhe videove të shkurtra, të cilat synojnë të angazhojnë përdoruesit përmes përmbajtjes vizuale tërheqëse dhe shpesh virale. Ndërkohë, Facebook-u ofron një strukturë më të gjerë, duke kombinuar tekste më të gjata, postime me fotografi dhe video, lidhje të jashtme dhe grupe diskutimesh, duke lejuar një ndërveprim më kompleks dhe diversifikim të përmbajtjes.

Së dyti, i gjithë ky mesazh i unifikuar përbën një strategji të qëllimshme e propagandës politike, rrënjët e së cilës i gjejmë në një sërë studiuësh të fushës, veçanërisht tek Zhak Elyl (Jacques Elyl). Në rastin e Bashkisë Shkodër, 151 nga 203 postime në total, pra mbi 74 për qind e tyre janë të njëjtë në të gjitha faqet e mediave sociale të bashkisë dhe kryebashkiakut në detyrë (Figura 2). Në Bashkinë Pukë, kjo arrin në rreth 49 për qind (Figura 3).

Figure 2 Ngjashmëria e mesazhit në kanale të ndryshme komunikimi për Bashkinë Shkodër





Figure 3 Ngjashmëria e mesazhit në kanale të ndryshme komunikimi për Bashkinë Pukë



Nga sa më sipër, nëse do t'i ktheheshim qasjes së Ellul, ai thekson se propaganda ekziston dhe përhapet përmes medias. Krijimi i opinioneve në sferat e shoqërisë është i vështirë të mundësohet pa praninë e mjeteve të komunikimit masiv. Mungesa e këtyre mjeteve do ta bënte të pamundur suksesin e propagandës moderne. Për Ellul, e rëndësishme është të diskutohet nëse këto mjete të komunikimit masiv janë instrumente të propagandës. Për të qenë të tilla, ato duhet të jenë subjekt i një kontrolli të centralizuar nga njëra anë, si edhe të ndryshme përsa i përket produkteve që nxjerrin (Ellul 1973). E gjithë kjo përmbajtje në kanale të ndryshme komunikimi, ka një burim të centralizuar, zyrat e komunikimit të bashkive dhe të tjera që bashkërendojnë aktivitetin mes tyre.

Në këtë mënyrë, publiku përballlet me një mesazh të vetëm, të përcjellë përmes fuqisë së rrjeteve sociale, që në këtë rast përdoren për të manipuluar dhe orientuar opinionin publik. Ky homogjenitet në komunikim, përbën një provë të qartë të përdorimit të koordinuar të këtyre platformave për të konsoliduar pushtetin dhe për të promovuar influencën politike.

Ndërkohë, faqet e kryetarëve të bashkive kanë edhe reagimet më të larta në lidhje me postimet (Tabela 5). Konkretisht, 65 postime në faqet e Facebook-t të kryebashkiakëve dhe 60 të tillë në faqet e tyre të Instagramit kishin mbi 300 pëlqime në momentin e monitorimit. Ky reagim i audiencave është i ngjashëm edhe për ndarjet dhe komentet e bëra në postime.

Tabela 5 Interaktiviteti, pëlqimet (like) e audiencave sipas platformave sociale

Platforma e komunikimi * Interaktiviteti, pëlqimet (like) e audiencave									
		Interaktiviteti, pëlqimet (like) e audiencave							Total
		1-10	101-200	11-20	201-300	21-50	51-100	+300	
Platforma	Facebook - Bashki	50	11	0	0	0	36	0	97
	FB - Kryetari	0	12	0	12	0	4	65	93
	Inst. - Bashki	0	5	1	1	5	13	1	26
	Inst. - Kryetari	0	1	0	2	0	2	60	65
	TikTok - Kryetari	3	1	0	2	0	2	6	14
Total		53	30	1	17	5	57	132	295

Burimi: Ramadan Çipuri, Olta Jahaj, 2024

Në të tria rastet, niveli i interaktivitetit është më i lartë në Bashkinë Shkodër, krahasuar me atë të Pukës.

Tabela 6 Natyra e 10 komenteve të para

Bashkia * Natyra e 10 komenteve të para								
		Natyra e 10 komenteve të para						Total
		Më shumë negativ	Më shumë neutral	Më shumë pozitiv	Pa koment	Të barabartë	Tjetër	
Bashkia	Pukë	5	5	51	28	3	0	92
	Shkodër	10	16	124	45	4	4	203
Total		15	21	175	73	7	4	295

Burimi: Ramadan Çipuri, Olta Jahaj, 2024

Bie në sy se ka një numër të lartë komentesh pozitive krahasuar me ato negative në postimet në faqet e ndryshme të komunikimit të bashkive Shkodër dhe Pukë. Rreth 75 për qind e postimeve, 124 nga 158 që kanë komente në Bashkinë Shkodër janë vlerësime pozitive, përkundrazi vetëm 10 të tjerëve që janë me nota negative. Kjo përqindje është edhe më e lartë në Bashkinë Pukë, ku rreth 80 për qind e komenteve (51 nga 64) janë pozitiv dhe vetëm 5 të tillë janë negativ (Tabela 6).

I kontaktuar në kuadër të këtij studimi, specialist komunikimi në njërin nga këto bashki, pohon se ekipet e komunikimit përdorin disa metoda për të menaxhuar dhe fshirë komentet negative në postimet e tyre në rrjetet sociale. Sipas tij, sidomos në bashkitë e vogla ku ndërveprimi nuk është shumë i madh, menaxherët e rrjeteve dhe mediave sociale i fshijnë manualisht komentet nga postimet. Ai pranon se kjo s'është një metodë e vështirë në kushtet kur ndërveprimi nuk është aq i madh sa në bashkitë kryesore të vendit.

Tjetër metodë e përdorur gjerësisht është edhe bllokimi dhe raportimi i përdoruesve që lënë komente negative. Sipas specialistit të mësipërm, personat që komentojnë negativisht dhe nxisin kritikën ndaj bashkisë, kryetarit apo qeverisë, përgjithësisht bllokohen për të mos pasur

më mundësi reagimi. Në jo pak raste nuk mungon as organizimi brenda mbështetësve partiakë dhe stafit të bashkisë për të raportuar faqet e atyre që adresojnë dhe organizojnë komente negative në këto faqe.

Për bashkitë e vogla, në komunitete ku përdoruesit e rrjeteve sociale janë lehtësisht të identifikueshëm, gjë që në jo pak raste i frikëson ata për t'u shprehur lirisht në këto platforma, ka një rritje të përdoruesve të rremë. Nga një analizë e komenteve të tyre gjatë periudhës së monitorimit u vu re se përdoruesit e rremë ndahen në dy grupe, në mbështetës dhe kritikë.

I angazhuar edhe gjatë fushatës zgjedhore të njërit prej kryetarëve të bashkive të hulumtuara në këtë studim, një tjetër specialist komunikimi deklaroi se tashmë është praktikë e zakonshme që shumë prej mbështetësve të kandidatëve për kryetar bashkie të aktivizojnë edhe profile të rreme për të komentuar dhe ndarë mesazhet politike në periudha të ndryshme.

Tabela 7 Niveli i identifikimit të 20 personave që kanë reaguar ndaj postimit

Bashkia * Niveli i identifikimit të 20 personave që kanë reaguar ndaj postimit				
		Niveli i identifikimit të 20 personave që kanë reaguar ndaj postimit		Total
		1-5 profile të rreme	Të gjithë të identifikuar	
Bashkia	Pukë	7	85	92
	Shkodër	42	161	203
Total		49	246	295

Burimi: Ramadan Çipuri, Olta Jahaj, 2024

Fenomeni i mësipërm është më i dukshëm në Bashkinë Shkodër krahasuar me atë të Pukës (Tabela 7). Rreth 26 për qind e reagimeve vijnë nga profile të rreme, një përqindje kjo e konsiderueshme dhe shqetësuese për mjedisin e debatit publik. Prania e profileve të rreme minon integritetin e diskutimeve online, duke krijuar një iluzion të mbështetjes ose kundërshtimit dhe duke manipuluar perceptimet e publikut.

Tabela 8 Niveli i identifikimit të 20 personave që kanë reaguar ndaj postimit në raport me natyrën e komenteve

Natyra e 10 komenteve të para * Niveli i identifikimit të 20 personave që kanë reaguar ndaj postimit				
		Niveli i identifikimit të 20 personave që kanë reaguar ndaj postimit		Total
		1-5 profile të rreme	Të gjithë të identifikuar	
Natyra e 10 komenteve të para	Më shumë negativ	3	12	15
	Më shumë neutral	9	12	21
	Më shumë pozitiv	19	156	175
	Pa koment	14	59	73
	Të barabartë	1	6	7
	Tjetër	3	1	4
Total		49	246	295

Burimi: Ramadan Çipuri, Olta Jahaj, 2024

Ndërkohë, në grupin e komenteve nga profilet e rreme vihet re se ka më shumë komente pozitive sesa negative, duke përforcuar idenë e diskutuar më sipër se kandidatët apo përfaqësuesit qeveritarë angazhojnë ekipe të posaçme për të përhapur mesazhet e synuara (Tabela 8).

Kjo prirje sugjeron një strategji të qëllimshme të përdorimit të profileve të rreme për të krijuar një iluzion të mbështetjes së gjerë publike, duke manipuluar opinionin dhe perceptimet e qytetarëve. Prania e komenteve pozitive të fabrikuara dëmton autenticitetin e debatit publik dhe ngre shqetësime serioze për transparencën dhe etikën në përdorimin e rrjeteve sociale nga aktorët politikë.

Të dy specialistët e intervistuar pranojnë se së fundmi, në bashkitë e mëdha të vendit, krahas fshirjes manuale të mesazheve dhe bllokimit të përdoruesve që postojnë komente negative, kanë nisur të përdoren edhe metoda të avancuara për menaxhimin e komenteve.

Këto metoda përfshijnë filtrimin automatik për të bllokuar fjalë ose fraza specifike që lidhen me kritika, moderimin e komenteve përpara se të bëhen publike, përdorimin e boteve dhe algoritmeve të inteligjencës artificiale për monitorimin dhe fshirjen automatike të komenteve negative, si dhe kufizimin e mundësisë për të komentuar në postimet e tyre. Këto praktika të reja synojnë të mbrojnë imazhin publik të zyrtarëve dhe të kontrollojnë diskursin online, duke reduktuar ndikimin e kritikave dhe të komenteve negative në platformat e rrjeteve sociale.

Përfundime

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të analizuara, konfirmohet hipoteza e ngritur në fillim të këtij studimi: *aktorët politikë, konkretisht drejtuesit e qeverive vendore, përdorin platformat e mediave sociale për të manipuluar agjendën e publikut duke inkuadruar mesazhe që krijojnë një narrativë specifike në funksion të interesave të tyre politike.*

Kjo qasje rrezikon seriozisht transparencën dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale. Përdorimi strategjik i rrjeteve sociale nga drejtuesit lokalë për të formësuar perceptimet publike dhe për të theksuar vetëm aspekte pozitive ose për të shmangur çështjet kritike pengon informimin e drejtë dhe të balancuar të publikut. Si pasojë, kjo praktikë cenon proceset demokratike, kufizon aftësinë e qytetarëve për të marrë vendime të informuara dhe për të mbajtur përgjegjës drejtuesit e tyre.

Siç u vu re gjatë analizës së të dhënave, *stafet e zyrave të komunikimit në bashkitë e kampionuara në këtë studim, kontrollojnë jo vetëm përmbajtjen e mesazheve të publikuara, por edhe mënyrën se si zhvillohet ndërveprimi me qytetarët.*

Kjo përfshin monitorimin dhe menaxhimin e komenteve, përgjigjeve dhe diskutimeve në platformat sociale, duke siguruar që narrativat dhe imazhet publike të jenë në përputhje me strategjitë politike të drejtuesve lokalë. Ky kontroll i centralizuar i komunikimit mund të kufizojë dialogun e hapur dhe kritikën konstruktive, duke ndikuar negativisht në transparencën dhe pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse lokale.

Shqetësimi bëhet edhe më i madh kur *qeveritë vendore përdorin strategji të posaçme për të përçarur të njëjtat mesazhe propaganduese përmes kanaleve të ndryshme.* Këto strategji homogjenizojnë përmbajtjen dhe ulin nivelin e pluralizmit të informacionit që lidhet me këto institucione. Në shumë

raste, kjo çon deri në monopolizimin e burimeve të informacionit, duke kufizuar aksesin e qytetarëve në një gamë të gjerë perspektivash dhe duke penguar debatin e hapur dhe demokratik. Nga kjo analizë, del qartë se transformimet teknologjike kanë ndikuar thellësisht në shoqërinë globale, duke konfirmuar teorinë e Manuel Castells për 'vetë-komunikimin masiv'. *Institucionet politike janë kthyer në burime informacioni politik, duke funksionuar si media të pakontestueshme, veçanërisht në qytetet e vogla përtej kryeqytetit.*

Në këto kontekste, 'e vërteta qeveritare' mbizotëron në debatet publike, duke mbytur çdo zë kritik dhe duke eliminuar filtrat e gazetarisë profesionale. Kjo situatë ngre shqetësime të mëdha për transparencën dhe llogaridhënien, pasi monopoli i informacionit nga institucionet politike rrezikon pluralizmin dhe zvogëlon hapësirat për një diskurs demokratik të balancuar dhe të informuar.

Teoritë klasike që shpjegojnë rolin e medias në shoqëri dhe marrëdhënien e saj me publikun tani janë më se të zbatueshme edhe për institucionet politike, veçanërisht qeveritë vendore. Këto institucione përcaktojnë agjendën e publikut, duke marrë funksionet që dikur mbante media, sipas këtij këndvështrimi teorik. Në këtë mënyrë, ato ndikojnë në formësimin e perceptimeve publike dhe në strukturimin e diskutimeve shoqërore, duke u bërë aktorë kryesorë në komunikimin masiv.

Në këto kushte, mendimi se media është një mekanizëm për përcaktimin e agjendës (agenda setting) duket se sot po humbet terren ose, së paku, është pjesërisht i vërtetë. Aktualisht, përcaktimi i agjendës po zëvendësohet nga ndërtimi i agjendës (agenda building). Kjo e fundit përfshin agjendën e vendimmarrësve dhe është në kundërshtim me përcaktimin e agjendës, që është agjenda mediatike.

Sipas interesave politike, subjektet politike janë të vetëdijshëm për efektet që mjetet e komunikimit masiv kanë mbi publikun. Duke manipuluar përmes përzgjedhjes së mesazhit, hierarkisë dhe rëndësisë së tij, si dhe duke kontrolluar mediat online (platformat e mediave sociale) si një burim i rëndësishëm informimi, institucionet publike arrijnë të ndërtojnë agjendën e këtyre mediave dhe rrjedhimisht të përcaktojnë agjendën e publikut. Në këtë mënyrë, institucionet publike veprojnë si media, por jashtë funksionit fisnik të gazetarëve profesionistë, duke përjashtuar standardet etike dhe objektivitetin që karakterizon gazetarinë tradicionale. Kjo qasje ngre shqetësime serioze për pluralizmin mediatik dhe për aftësinë e qytetarëve për të marrë vendime të informuara, duke rrezikuar kështu përhapjen e propagandës, pengimin e proceseve demokratike dhe transparencën në qeverisje.

Bibliography

Camaj, Lindita, dhe Erlis, Rexha, Gjylie Çela. 2023. «The audience logic in election news reporting on Facebook: what drives audience engagement in transitional democracies of Albania and Kosovo?» *Journal of Information Technology & Politics* (Taylor & Francis) 21 (1): 38-53. doi:10.1080/19331681.2023.2227847.

Castells, Manuel. 2009. *Communication Power*. Nju Jork: Oxford University Press.

- Chadwick, Andrew. 2013. *The hybrid media system: Politics and power*. Oxford: Oxford University Press.
- Çipuri, Ramadan. 2023. «Media të reja, praktika të vjetra: Ndikimi i platformave të mediave sociale mbi ato tradicionale - Rreziku i një propagande dhe censure të re.» *Kanalet televizive shqiptare në rrjetet sociale*. Tiranë: Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës. 119-128.
- Ellul, Jacques. 1973. *Propaganda; The Formation of Mens` s Attitudes*. . New York: Random House of Canada Limited.
- Fuchs, Christian. 2014. *Social Media: A critical introduction*. Londër: Sage.
- Gërguri, Dren. 2021. *Komunikimi politik në epokën e mediave digjitale*. Prishtinë: Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës.
- Gil de Zúñiga, Homero, Sebastian Valenzuela, dhe Brian E. Weeks. 2016. «Motivations for Political Discussion: Antecedents and Consequences.» *Human Communication Research* (International Communication Association) 1-20. doi:10.1111/hcre.12086.
- Lepsius, M. Rainer. 2013. «Max Weber’s Concept of Charismatic Authority and Its Applicability to Adolf Hitler’s “Führerstaat.” Max Weber and Institutional Theory.» Në *Max Weber and Institutional Theory*, nga Claus Wendt, 89-109. Springer International Publishing Switzerland. doi:10.1007/978-3-319-44708-7_8.
- McLuhan, Marshall. 1964. *Understanding Media; The extensions of man*. Londër dhe Nju Jork: The MIT Press.
- Mosco, Vincent. 2004. *The Digital Sublime*. Cambridge, Massachusetts: The MIT Press.
- Rregullore, Bashkia Shkodër. a.d. «Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës.» Bashkia Shkodër. https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/rregullorja_bashkia_shkoder_2017_1185.pdf.
- Saliu, Hasan, Ramadan Çipuri, dhe Xhevahire Izmaku. 2024. «Gutenberg’s death in the Balkans: News values in Kosovo and Albania.» *Cogent Arts & Humanities* 11 (1). doi:<https://doi.org/10.1080/23311983.2024.2303197>.
- Sey, Araba, dhe Manuel Castells. 2004. «From media politics to networked politics: The Internet and the political process.» Në *The Network Society*, nga Manuel Castells, 363-381. Massachusetts: Edward Elgar Publishing Limited.
- Shirky, Clay. 2008. *Here comes everybody*. Londër: Penguin.
- Sobaci, Mehmet Z. 2016. «Social Media and Local Governments: An overview.» Në *Social Media and Local Governments: Theory and Practice*, nga Mehmet Z. Sobaci, 3-22. Londër: Springer.

- Sprout-Social. 2024. *Sprout-Social*. Prill. Qasja Qershor 1, 2024.
<https://sproutsocial.com/insights/social-media-statistics/#facebook-statistics>.
- Statista.com. 2024. Prill. Qasja Qershor 1, 2024.
<https://www.statista.com/topics/1145/internet-usage-worldwide/#topicOverview>.
- Stieglitz, Stefan, dhe Linh Dang-Xuan. 2012. «Social media and political communication: a social media analytics framework.» *Social Network* (Springer) 2-33. doi:10.1007/s13278-012-0079-3.
- Tartari, Alban. 2021. *Marrëdhëniet me publikun*. Botimi i dytë. Tiranë: Luis Print.
- Tufa, Alban, dhe Erlis Çela. 2022. «Roli i Facebook-ut në individualizimin e komunikimit me publikun nga drejtuesit e institucioneve të pushtetit vendor: Rasti i Bashkive.» *Beder Journal of Humanities*, Dhjetor: 53-72.
- Yang, Xinxin, Bo-Chiuan Chen, Mrinmoy Maity, dhe Emilio Ferrara. 2016. «Social Politics: Agenda Setting and Political Communication on Social Media.» *SocInfo* (Springer International Publishing) 330–344. doi:10.1007/978-3-319-47880-7 20.

Ndikimi i TikTok në kreativitetin e reklamave: risi dhe sfida

Prof. Asoc. Dr. Loreta Axhami

Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Tiranë

e-mail: loreta.axhami@fhf.edu.al

Abstrakt

Në një kohë kur teknologjia digjitale po ndryshon gjithçka, për firmat dhe agjencitë e reklamave mbetet sfida e vazhdueshme gjetja e mënyrave efikase se si të komunikojnë me konsumatorët e synuar. Kjo merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur rritja e përdorimit të Internetit dhe platformave sociale ka ndryshuar jo vetëm sjelljen e audiencave dhe mënyrën se si konsumojnë përmbajtjet mediatike por edhe qasjen e tyre ndaj reklamave. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij studimi është të analizojë nëse platformat sociale, specifikisht TikTok ka ndikuar në aspektet kreative të reklamave në tregun shqiptar. Disa prej pyetjeve kërkimore të cilave synojmë t'ju përgjigjemi janë: A kanë ndryshuar formatet digjitale të reklamave, dhe nëse po, si kanë ndryshuar? Sa prezente janë risitë kreative në reklamën digjitale shqiptare? A ka dallime ndërmjet markave lokale dhe atyre ndërkombëtare sa i takon përdorimit të reklamës digjitale vs tradicionale? Studimi mbështetet në të dhëna cilësore të përftuara nga intervista të thelluara realizuar me drejtorë kreativë të agjencive të reklamave, menaxherë marketingu, ekspertë të marketingut digjital të cilat ndërthuren me të dhëna sasiore të dy prej kompanive më të mëdha që operojnë në tregun shqiptar Agna Group dhe Air Albania. Rezultatet e studimit tregojnë se rritja e përdoruesve të TikTok në Shqipëri nuk ka sjellë ndryshime në formatet digjitale të reklamave, duke dëshmuar mungesë risish në aspektin kreativ.

Fjalë kyç: TikTok, platformë, media sociale, reklamë digjitale, kreativitet, risi.

Hyrje

Teknologjia digjitale po ndryshon çdo aspekt të jetës, dhe këtu nuk bën përjashtim as fusha e marketingut me të gjithë komponentët përkatës. Ajo çka nuk ka ndryshuar është rëndësia që mbart mesazhi i reklamës si një nga elementët kyç të çdo programi të komunikimeve të integruara të marketingut. Për shumë profesionistë të marketingut, faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në suksesin e një programi promociional janë si pjesa kreative e reklamave ashtu edhe gjetja e kanaleve të duhura të komunikimit me audiencat e synuara. Ndërkaq, për bizneset dhe agjencitë e reklamave një sfida e vazhdueshme mbetet komunikimi dhe tërheqja e vëmendjes audiencave që i përkasin brezit të milenialëve (të lindur ndërmjet viteve 1981 dhe 1996) dhe të gjeneratës Z (të lindur ndërmjet viteve 1997 dhe 2012), të cilët jetojnë në një mjedis ku kryefjala është ndërlidhja. Kjo ka bërë që specialistët e marketingut dhe reklamave të hedhin sytë drejt platformës TikTok, ku një pjesë e konsiderueshme e përdoruesve të saj i përkasin këtyre brezave.

TikTok është platforma sociale me rritjen më të shpejtë në rang global, me një rritje të përdoruesve nga viti në vit me 13.4% ndërsa gjatë vitit 2024 parashikohet një rritje e përdoruesve

në vlerën 9.3%¹². Ky trend shfaqet edhe në audiencat shqiptare. Sipas studimit shkencor më të fundit të realizuar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës në vitin 2023 rezultoi se 'ka një ndryshim të rëndësishëm në sjelljen e audiencave numerike përsa i përket parapëlqimit që ato tregojnë për secilin nga rrjetet sociale. Anketimi rikonfirmoi prirjen e dy apo tre viteve të fundit duke nxjerrë Instagramin si rrjetin social më të përdorur (32.3% e të anketuarve) ndërsa Facebook ka kaluar në vendin e tretë pas TikTok-ut me 25%' (DGK, 2023, fq. 98-99).

Rritja e përdorimit të platformave sociale ndryshoi sjelljen e audiencave dhe mënyrën se si konsumojnë përmbajtjet mediatike, përfshirë këtu edhe qasjen ndaj reklamave. Si rrjedhojë, profesionistët e fushës së marketingut u orientuan në studimin e platformave sociale dhe ndikimin e tyre në industrinë e reklamës. Në rastin e Shqipërisë, aktualisht mungojnë studime të thelluara që kanë në fokus këtë objekt studimi, prandaj qëllimi i këtij studimi është të analizojë nëse platformat sociale, specifikuat TikTok-u ka ndikuar në aspektet kreative të reklamave digjitale shqiptare. Disa prej pyetjeve kërkimore të cilave synojmë t'ju përgjigjemi janë: A kanë ndryshuar formatet digjitale të reklamave, dhe nëse po, si kanë ndryshuar? Sa prezente janë risitë kreative në reklamat digjitale shqiptare? A ka dallime ndërmjet markave lokale dhe atyre ndërkombëtare sa i takon përdorimit të reklamës digjitale vs tradicionale?

Rishikim i literaturës

Shumë autorë janë të mendimit se TikTok-u po ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në industrinë e marketingut digjital dhe reklamave duke i shtyrë krijuesit e përmbajtjes drejt shtigjeve të reja. Tre vjet më parë, drejtoresha kreative e Fortnite Collective, Mona Hasan-i (2021) e cilësoi TikTok-un si shkollën e re të reklamave, e cila po u mëson një qasje më moderne ndaj komunikimit brezave të tanishëm dhe atyre të ardhshëm. Ajo argumentoi se 'TikTok-u nuk është thjesht një platformë që u jep mundësi përdoruesve të ndajnë video me njëri-tjetrin, por që i frymëzon ata që të krijojnë vetë video. Kjo platformë po i jep formë të ardhmes së reklamave, duke na bërë që të mos e harrojmë se ç' do të thotë të jesh kreativ.'

Belch & Belch (2023) shpjegojnë se 'një prej faktorëve kyç që ka kontribuar në suksesin e TikTok-ut është autenticiteti i tij, fakti se ai është plotësisht ndryshe nga përmbajtjet e platforma të tjera të mediave sociale, që janë të krijuara paraprakisht dhe që kalojnë nëpër një filtër. Slogani i TikTok-ut është "Njerëz të vërtetë, video të vërteta" dhe këto video janë të njerëzve të zakonshëm, të cilët shfaqin mënyra të ndryshme jetese, prirje dhe këndvështrime të ndryshme nga e gjithë ShBA-ja dhe nga e gjithë bota'. Ata theksojnë se kompanitë që reklamojnë u duhet të gjejnë mënyra të tjera që ta integrojnë këtë autenticitet në mesazhet që krijojnë dhe të mos mbeten tek përmbajtjet tipike tepër të sofistikuar që krijojnë për të ndikuar tek audiencat. Në këtë kontekst, reklamuesit mund të krijojnë përmbajtje tërheqëse dhe argëtuese që rezonon me audiencën e tyre të synuar thjesht duke përdorur mjetet dhe formatet krijuese të TikTok-ut.

¹² Year-on-year user growth of selected social networks worldwide from 2021 to 2025: <https://www.statista.com/statistics/1401614/global-social-media-growth/>

Neoklis Delegos¹³, një profesionist i reklamave me eksperiencë të gjatë në tregun shqiptar dhe të huaj thekson se platforma TikTok ka ndikuar veçanërisht në aspektin kreativ të reklamave ku ndër tiparet kryesore rendit: 1. *Formati i shkurtër*: në dallim nga reklamat tradicionale, reklamat në TikTok janë të shkurtra, gjë që i detyron krijuesit të jenë të qartë në përcjelljen e mesazhit dhe të kapin vëmendjen e audiencave në pak sekonda. Kjo i shtyn krijuesit e reklamave që të prodhojnë përmbajtje sa më tërheqëse çka përshtatet më së miri me tendencat aktuale digjitale dhe preferencat e të rinjve. 2. *Përdorimi i muzikës dhe efekteve zanore*: TikTok-u ofron një larmishmëri të madhe muzikore dhe efekte zanore që mund të përdoren në reklama. Kjo ju mundëson krijuesve të eksperimentojnë me ritme të ndryshme për të rritur impaktin emocional të reklamave. 3. *Efektet kreative*: TikTok-u ofron një gamë të gjerë efektesh vizuale të cilat mund të shfrytëzohen nga krijuesit për të prodhuar përmbajtje/mesazhe inovative të cilat mund të tërheqin vëmendjen e audiencave të reja në moshë.

Mundësia e madhe për t'u bërë viral shumë shpejt konsiderohet si një avantazh i platformës TikTok. Sikurse dihet, algoritmi i TikTok është konceptuar për të promovuar përmbajtje që ka potencialin të bëhet virale. Videot e postuara në aplikacion mund të bëhen virale brenda natës dhe të arrijnë miliona përdorues në internet, gjë që është diçka që aplikacionet e tjera të mediave sociale nuk janë në gjendje ta ofrojnë.¹⁴

TikTok është më shumë i orientuar drejt argëtimit dhe kalimit të kohës sesa Twitter dhe Facebook, të cilët fokusohen më shumë në informacione, lajme dhe kontakte me të njohurit/të afërmit (Haenlein et al., 2020). Në fakt, sot shumica e ekspertëve të marketingut po i ndërthurun reklamat me argëtimin, që të krijojnë mënyra të reja për t'i arritur konsumatorët nëpërmjet mesazheve më tërheqëse. Në rast se reklamat nuk ofrojnë përmbajtje tërheqëse, të dobishme ose zbavitëse, shumë konsumatorë thjesht do t'i injorojnë ose do t'i kalojnë ato (Kotler & Armstrong, 2023, fq.473).

Reklamat në TikTok janë efektive edhe nga pikëpamja e kostos. Krahasuar me videot në format të gjatë, prodhimi i përmbajtjes në format të shkurtër dhe të krijuar nga përdoruesit mund të jetë me kosto më efektive. Me një kohë më të shkurtër ekzekutimi, kërkohet më pak kohë dhe burime për skenarin, filmimin, montimin dhe post-produksionin. Kjo i bën të aksesueshme për bizneset e të gjitha madhësive, duke përfshirë startup-et dhe bizneset e vogla, duke u mundësuar të krijojnë përmbajtje tërheqëse brenda buxhetit të tyre.¹⁵ Gjithashtu, në ndryshim nga Instagrami ku ndikuesit/influencerat e mirënjohur kërkojnë shuma të mëdha parash për të publikuar përmbajtjen e markës, shumica e TikTokers-ave kërkojnë më pak para sepse TikTok është një treg i ri ku ata thjesht po ndërtojnë vetëm markën e tyre personale (Barta et al, 2023).

Ndërkaq, vetë TikTok-u po i nxit kompanitë të ndryshojnë mënyrën se si komunikojnë me audiencat. Përmes hedhjes në treg të programit *TikTok for Business*, këshilla e TikTok për të arritur suksesin e markës përmbledhej në sloganin “Mos krij reklama. Krij TikTok” (Forbes,

¹³ Neoklis Delegos, Drejtor marketingu VERNILAC, intervistë realizuar më 13.06.2024.

¹⁴ Dencheva, Valentina. (2023). TikTok ad revenue worldwide 2020-2027.

<https://www.statista.com/statistics/1305708/tiktok-ad-revenue/>

¹⁵ Versa Creative (2023). How has TikTok changed Marketing? <https://versacreative.com/blog/how-has-tiktok-changed-marketing/>

2022), slogan që fton krijuesit të përqafojnë kreativitetin dhe autenticitetin që e karakterizon TikTok-un.

Metodologjia

Studimi mbështetet në të dhëna cilësore të përfuara nga intervistat e thelluara të realizuara me menaxherë marketingu të dy prej kompanive më të mëdha që operojnë në Shqipëri. Për përzgjedhjen e kompanive në studim janë ndjekur dy kritere: 1) Pësia e kompanive në industrinë ku operojnë për të cilën i kemi referuar performancës financiare për vitin 2023; 2) Operimi në sektorë të ndryshëm, konkretisht: AGNA Group - sektori i FMCG; Air Albania - sektori i aviacionit.

Krahas të dhënave cilësore janë shfrytëzuar edhe të dhëna sasiore lidhur me shpërndarjen e buxhetit të marketingut, konkretisht marketingu tradicional vs marketingu digjital (këtu është përfshirë dhe reklama digjitale) gjatë tre viteve të fundit: 2022, 2023 si dhe parashikimet për vitin 2024. Këto të dhëna kanë shërbyer për të kuptuar se cilat janë prirjet në tregun shqiptar dhe nëse ka dallime mes strategjive të komunikimit marketing ndërmjet markave shqiptare dhe atyre ndërkombëtare. Në këtë kontest, janë shfrytëzuar të dhëna dhe raporte periodike të agjencive ndërkombëtare si Statista. com, DataReportal, etj., të cilat kanë shërbyer për zhvillimin e analizës krahasuese. Ndërsa për të analizuar ndikimin e TikTok në kreativën e reklamave janë realizuar intervista me drejtore creative/prodhimi të reklamave në Shqipëri.

Analiza e të dhënave dhe gjetjet

Sipas Statista¹⁶, TikTok ishte aplikacioni celular më i shkarkuar në mbarë botën në vitin 2021 dhe tërheqja masive e platformës së videove me format të shkurtër nuk ka kaluar pa u vënë re nga reklamuesit. Të ardhurat nga reklammat në TikTok në vitin 2023 në rang botëror arritën në shifrën 18.04 miliard dollarë, ndërsa për vitin 2027 parashikohet që të arrijnë në vlerën 53.95 miliard dollarë. Ndonëse këto shifra dëshmojnë për rritjen e shpenzimeve për reklama digjitale në rang botëror nga viti në vit (në vitin 2023 arriti vlerën 601.84 miliardë dollar), tregu shqiptar paraqet disa specifika.

Shifrat e DataReportal¹⁷ tregojnë se në Shqipëri në janar 2024 kishte 1.53 milionë përdorues të mediave sociale. Ndërsa Facebook dhe Instagram kishin përkatësisht 1.20 milionë përdorues, TikTok kryesonte me 1.53 milionë përdorues të moshës 18 vjeç e lart në janar të vitit 2024. Edhe shifrat mbi shikueshmërinë e reklamave tregojnë epërsinë e platformës TikTok. Shikueshmëria e reklamave të TikTok në Shqipëri ishte 62.9 për qind e bazës lokale të përdoruesve të internetit (pavarësisht moshës) kundrejt 49.4 për qind në Facebook dhe Instagram në fillim të vitit 2024. Megjithatë, pavarësisht statistikave që janë në favor të TikTok-ut, kompanitë që operojnë në tregun shqiptar preferojnë më shumë reklammat tradicionale krahasuar me reklammat digjitale.

¹⁶ Dencheva, Valentina. (2023). TikTok ad revenue worldwide 2020-2027.

<https://www.statista.com/statistics/1305708/tiktok-ad-revenue/>

¹⁷ DataReportal, (2024). Digital 2024: Albania. Social media statistics for Albania in 2024.

<https://datareportal.com/reports/digital-2024-albania?rq=albania>

Nga analiza e të dhënave të kompanive të marra në shqyrtim rezulton se ka dallime ndërmjet markave ndërkombëtare me markat lokale (kombëtare) përsa i përket shpenzimeve për marketing. Sikurse evindentohet në Tabelën nr.1, në rastin e kompanisë Agna Group e cila ka ekskluzivitetin e një numri të madh markash ndërkombëtare, shpenzimet për median digjitale janë rritur me + 7% nga viti 2022 në vitin 2024, ndërsa markat lokale shqiptare vazhdojnë t'i kushtojnë më shumë rëndësi medias tradicionale kundrejt asaj digjitale ndonëse vërehet prirja për rritje e kësaj të fundit. Drejtoresha e marketingut të Agna Group, A. Bici thekson se buxheti alokohet në mediat sociale, shumë pak është në *Display ads*, dhe një pjesë vendoset për influencers. Për markat ndërkombëtare përdoret kryesisht Instagrami, ndërsa TikTok nuk lejohet të përdoret. Markat lokale, krahas Instagramit përdorin edhe platformën TikTok si psh. Glina, Spring, Dragon, etj.¹⁸

Tabela 1: Buxheti marketing në %, media tradicionale vs media digjitale, 2022-2024, Agna Group

Lloji i markave	Viti	Media tradicionale	Media digjitale
Marka ndërkombëtare	2022	84%	16%
	2023	83%	17%
	2024	77%	23%
Marka lokale	2022	93%	7%
	2023	90%	10%
	2024	86%	14%

Në rastin e kompanisë Air Albania ndryshimi është shumë i madh përsa i përket ndarjes së buxhetit marketing për median tradicionale vs digjitale. Gjatë vitit 2024 është parashikuar që shpenzimet për median dixhitale të shkojnë në vlerën 50 % duke treguar një rritje më 30% krahasuar me vitin 2022 (shih Tabelën nr.2). Për drejtoreshën e marketingut dhe shitjeve të Air Albania, M. Shehu, reklamimi në mediat sociale ka qenë shumë efektiv ndërsa platforma TikTok nuk është e preferuar pasi nuk përshtatet me profilin e klientëve të kompanisë.¹⁹

Tabela 2: Buxheti marketing në %, media tradicionale vs media digjitale, 2022-2024, Air Albania

Kompania	Viti	Media tradicionale	Media digjitale
Air Albania	2022	80%	20%
	2023	80%	20%
	2024	50%	50%

¹⁸ Alma Bici, Menaxhere marketingu në Agna Group, intervistuar më 31.5.2024

¹⁹ Manjola Shehu, Drejtore e marketingut dhe shitjeve të Air Albania, intervistuar më 7.6.2024

Edhe pse ka një politikë marketingu të markave ndërkombëtare që e kanë zhvendosur reklamën nga televizioni linear në reklamën digjitale (Axhami, L., 2023, fq. 139), vlen të theksohet se në tregun shqiptar televizioni vazhdon të kryesojë për buxhetin e reklamës. Statistikat pozitive të reklamimit në platformën TikTok duket se nuk kanë ndikuar tek bizneset shqiptare të cilat vazhdojnë të shpenzojnë më shumë për marketingun tradicional sesa atë digjital. Sipas një raporti të fundit të TikTok, rreth 68% e përdoruesve të TikTok-ut gjejnë përmbajtje reklamuese në platformë të ndryshme nga ajo e platformave të tjera konkurruese. Gjithashtu, 63% e të gjitha reklamave të suksesshme të TikTok-ut komunikojnë mesazhin e tyre menjëherë si dhe reklamën e tyre me mesazhe emocionale nxisin më shumë njerëz dhe angazhim më të lartë.²⁰

Nisur nga të dhënat e mësipërme është e kuptueshme se ndikimi i platformës TikTok në aspektin kreativ të reklamave në Shqipëri është thuajse i papërfillshëm. Ndërkohë që shumë marka ndërkombëtare e kanë kthyer në një praktikë të zakonshme shfrytëzimin e përdoruesve të platformës TikTok si krijues përmbajtjeje, në tregun shqiptar kjo praktikë është ende në hapat e para. Markat lokale janë të prirura për të bashkëpunuar më tepër me influencues të afirmuar në treg sesa me përdorues të zakonshëm të TikTok-ut për të krijuar përmbajtje/reklama autentike cka do të përcillte te audiencat më shumë besueshmëri.

Përfundime

Rritja e jashtëzakonshme e popullaritetit të TikToku-t me mbi 1.5 miliard përdorues në mbarë botën ka ndikuar në tërheqjen e audiencës nga llojet e tjera të mediave dhe platformave sociale, e për rrjedhojë ka ndikuar edhe industrinë e marketingut e reklamës. Në tregjet e huaja TikTok ka revolucionarizuar mënyrën se si reklamën krijohen dhe konsumohen, duke inkurajuar kreativitetin, autenticitetin dhe përfshirjen e përdoruesve në procesin e krijimit të përmbajtjes (Belch & Belch, 2023).

TikTok, ndonëse ka një rritje të madhe të përdoruesve në Shqipëri, nuk ka sjellë ndikim të qenësishëm sa i përket kreativitetit të reklamave. Marketerët shqiptarë janë ende në hapat fillestarë për të gjetur mënyra kreative për t'u lidhur nëpërmjet TikTok-ut me audiencat e synuara.

Formatet digjitale të reklamave shqiptare nuk kanë pësuar shumë ndryshime duke dëshmuar mungesë risish në aspektin kreativ. Kjo është një ndër arsyt kryesore që përdoruesit/audiencat që vizitojnë reklamën baner që shfaqen në ekranet e kompjuterëve apo të mjeteve elektronike të lëvizshme të jenë të pakët dhe, shpeshherë zgjedhin që të mos i shohin fare reklamën video që shfaqen në ekran duke zgjedhur opsionin "skip video". Aktualisht, gjasat që TikTok-u të ndryshojë edhe sferën e argëtimit, nëpërmjet karakteristikave të kësaj platforme dhe mesazheve të reklamave janë të pakta.

Edhe pse markat ndërkombëtare që operojnë në tregun shqiptar janë më shumë të orientuara drejt marketingut dixhital sesa atij tradicional, kjo nuk ka diktuar ndryshime në tregun

²⁰ TikTok Statistics: Usage, Revenue, & Key Facts. (2023). <https://www.feedough.com/tiktok-statistics-usage-revenue-key-facts/>

e reklamës teksa markat lokale shqiptare vazhdojnë t'i kushtojnë më shumë rëndësi medias tradicionale kundrejt asaj digjitale ndonëse vërehet prirja për rritje e kësaj të fundit.

Në kushtet e një tregu të vogël dhe rritjes së konkurrencës, reklamimi në TikTok mund të jetë një çelës suksesi për bizneset shqiptare, veçanërisht për ato që kanë buxhete të kufizuara marketingu dhe që duan të kapin audiencat e reja. Sfida e vazhdueshme për marketerët shqiptar mbetet krijimi i përmbajtjeve që paraqesin realisht interes për audiencat.

Bibliografia

- Axhami, L. (2023). 'Sportelizimi i përmbajtjes së TV linear në mediat sociale'. *Kanalet televizive shqiptare në rrjetet sociale. Vështrim analitik, gjetje, përfundime*. Tiranë: Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës.136-143.
- Barta, S., Belanche, D., Fernandez, A., Flavian, M. (2023). Influencer marketing on TikTok: The effectiveness of humor and followers' hedonic experience. *Journal of Retailing and Consumer Services* 70 (2023) 103149 <https://doi.org/10.1016/j.jretconser.2022.103149>
- Belch, G., Belch, M. (2023). *Advertising and Promotion: An Integrated Marketing Communications Perspective*. Thirteenth Edition, Mc Graw Hill.
- Bici, Alma. Menaxhere marketingu në Agna Group, intervistuar më 31.5.2024
- DataReportal, (2024). Digital 2024: Albania. Social media statistics for Albania in 2024. <https://datareportal.com/reports/digital-2024-albania?rq=albania>
- Delegos, Neoklis. Drejtor marketingu VERNILAC, intervistuar më 13.06.2024.
- Dencheva, Valentina. (2023). TikTok ad revenue worldwide 2020-2027. <https://www.statista.com/statistics/1305708/tiktok-ad-revenue/>
- Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës (2023). 'Kanalet televizive shqiptare në rrjetet sociale. Vështrim analitik, gjetje, përfundime'. Tiranë.
- Forbes, (2022). 6 Red-Hot Influencer Marketing Predictions for 2022. <https://www.forbes.com/councils/forbesagencycouncil/2022/01/11/6-red-hot-influencer-marketing-predictions-for-2022/>
- Haenlein, M., Anadol, E., Farnsworth, T., Hugo, H., Hunichen, J., Welte, D., (2020). Navigating the new era of influencer marketing: how to be successful on Instagram, TikTok & Co. *California Management Review*, 63 (1), 5–25. <https://doi.org/10.1177/0008125620958166>
- Hasan, M. (2021). TikTok is the new ad school. Platform is shaping the future of ads by helping us remember what being creative is all about. <https://adage.com/article/opinion/tiktok-new-ad-school/2379736>
- Kotler, P., Armstrong, G. (2023). *Bazat e marketingut*. Botimi i 18, AADF, Pearson.
- Shehu, Manjola. Drejtore e marketingut dhe shitjeve të Air Albania, intervistuar më 7.6.2024
- TikTok Statistics: Usage, Revenue, & Key Facts. (2023). <https://www.feedough.com/tiktok-statistics-usage-revenue-key-facts/>
- Versa Creative (2023). How has TikTok changed Marketing? <https://versacreative.com/blog/how-has-tiktok-changed-marketing/>

Roli i inteligjencës artificiale në ridimensionimin e gazetarit në rajonin e Ballkanit

Dr. Valmora Gogo

Kolegji Universitar Bedër, Tiranë

Email: valmoragogo@gmail.com

Abstrakt

Zhvillimi i teknologjisë gjithnjë ka ngritur pyetje për nevojën e ridimensionimit të gazetarit në shërbim të publikut por së fundmi zhvillimi i inteligjencës artificiale, me debatet për gjenerimin e pafundëm të ideve dhe mungesën e kontrollit të saj nga shoqëria, ka nxjerrë në pah nevojën për diskutimin imediat e të thelluar të mënyrës së si po ridimensionohet profili i gazetarit dhe mediat tani dhe në të ardhmen e afërt. Prandaj ky punim ka si qëllim të analizojë perspektivat e ndryshme të aktorëve në tregun mediatik të Ballkanit sa u përket ndikimeve të inteligjencës artificiale në shërbimin ndaj audiencave, duke patur si fokus gazetarët dhe drejtuesit e disa prej mediave në rajon. Pyetjet kërkimore janë të lidhura me mënyrën se si mediat dhe gazetarët po e përdorin inteligjencën artificiale në Ballkan dhe si po ndikon në ridimensionimin e gazetarit ajo. Metodatat e përdorura janë përqendruar te intervistat e strukturuar me gazetarë e drejtues mediash, duke marrë edhe raste specifike të implementimit të inteligjencës artificiale në operacionet e përditshme mediatike. Ky punim konkludon se drejtuesit mediatikë dhe gazetarët në Ballkan kanë nisur në disa raste ta përdorin inteligjencën artificiale në proceset e prodhimeve të tyre mediatike duke ngritur pyetje mbi avantazhet dhe disavantazhet e saj.

Fjalë kyç: Inteligjenca Artificiale, Industria Mediatike, Transformimi Mediatik, Profili i Gazetarit, Media dhe Ballkani

1. Hyrje

Analiza e perspektivave të ndryshme të aktorëve mediatike për ndikimet e inteligjencës artificiale; gazetarë, drejtues mediash, konsulentë, drejtues organizatash mediatike, lektorë etj., merr një rëndësi në këtë fazë të parë të përbaljes serioze. Si mediat dhe gazetarët në rajonin e Ballkanit po e përdorin inteligjencën artificiale dhe si po ndikon inteligjenca artificiale në ridimensionimin e gazetarit? Këto janë dy pyetjet kryesore të këtij studimi ngritur metodologjikisht në intervistat e strukturuar²¹ me profesionistë të mediave, të cilët analizojnë dhe raste specifike të implementimit të inteligjencës artificiale në operacionet e përditshme mediatike. Dy janë hipotezat e ngritura në studim:

H1-Përdorimi i inteligjencës artificiale te mediat në rajonin e Ballkanit është në fazë fillestare, megjithëse kjo inteligjencë artificiale do ta ridimensionojë profesionin e gazetarit në pikëpamje të mjeteve që gazetari do të përdorë por duke mos vënë asnjëherë në dyshim nevojën për gazetarin në informimin e publikut.

²¹ Studimi është fokusuar në 6 vende të rajonit të Ballkanit: Shqipëri, Kosovë, Serbi, Mal i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoni e Veriut. Janë kryer 23 intervista me gazetarë, drejtues mediash, konsulentë në përdorimin e inteligjencës artificiale, drejtues organizatash të gazetarëve dhe lektorë universitetesh në profilet e gazetarisë dhe të komunikimit.

H2 - Gazetarët dhe mediat në rajonin e Ballkanit e njohin pak inteligjencën artificiale dhe përfitimet që mund të kenë nga përdorimi i saj në operacionet e përditshme por janë të vetëdijshëm për rreziqet që mund të sjellë si propaganda, dezinformimi, problemet e autorësisë, mungesa e privatësisë etj.

1.1. Një shikim mbi përdorimin e inteligjencës artificiale nga mediat

Chomsky (2023) dhe Harari (2024) kanë ngritur në nivelin e debatit se çfarë përfaqëson për njerëzimin inteligjenca artificiale dhe se cilat do të jenë ndikimet e saj. Duke iu referuar “ChatGPT”-së, Chomsky (2023) thekson se ajo ndryshon nga mënyra si njerëzit arsyetojnë dhe e përdorin gjuhën, teksa shton se të menduarit njerëzor bazohet te shpjegimet e mundshme dhe në korrigjimin e gabimeve, por “ChatGT” dhe programe të ngjashme sipas tij janë dizenuar që në mënyrë të pakufizuar të “mësojnë” duke memorizuar, pra janë të paaftë për të dalluar të mundurën, nga e pamundura. Chomsky (2023) thekson se parashikimet e sistemeve të lidhura me inteligjencën artificiale gjithmonë do të jenë sipërfaqësore dhe të dyshimta, sepse nuk mund të shpjegojnë sintaksën e gjuhës. Inteligjencën e vërtetë Chomsky (2023) e lidh edhe me të menduarit me moral, që do të thotë të kufizojmë krijimtarinë e pakufishme të mendjeve tona me një sërë parimesh etike që përcaktojnë se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të jetë, duke ia nënshtruar këto parime dhe kritikës krijuese. Për të, “ChatGPT”-ja shfaq diçka që ka lidhje me banalitetin e së keqes si plagjiarizmi, apatia dhe shmangia. “Ata ose mbigjenerojnë (duke prodhuar të vërteta dhe të pavërteta, duke miratuar njësoj vendimet etike dhe joetike) ose nëngjenerojnë (duke shfaqur mospërkushtim ndaj çdo vendimi dhe indiferencë ndaj pasojave). Duke pasur parasysh amoralitetin, shkencën e rreme dhe paaftësinë gjuhësore të këtyre sistemeve, ne mund të qeshim ose të qajmë me popullaritetin e tyre.” - thekson Chomsky. Mirëpo Harari (2024) e sheh në një kënd më dramatik, teksa thotë se inteligjenca artificiale është teknologjia e parë në histori që mund të na heqë neve fuqinë, ndërsa teknologji të tjera si bomba atomike na fuqizuan sepse vendimi se si do përdorej mund të merrej vetëm nga një qenie njerëzore. Janë pikërisht aftësia për të marrë vetë vendime dhe aftësia për të gjeneruar ide të reja, ato që e trembin Hararin. “Inteligjenca artificiale është mjeti i parë teknologjik në histori që mund të krijojë histori vetë”, thekson Harari, duke shtuar se ka një set totalisht të rregullave tjera lidhur me limitet se çfarë mund të bëjë dhe deri ku mund të shkojë. Inteligjenca artificiale, shpjeguar nga ai, ka hakuar tashmë bashkëbisedimet tona, ka përvetësuar gjuhë, është gati të prodhojë tekst dhe zëra falsë, madje duke krijuar intimitet me ne, edhe në mungesë të ndjenjave dhe është gati të stisë marrëdhënie intime. “Inteligjenca artificiale është armë sociale e shkatërrimit në masë”, thekson Harari.

Ndërsa Harari e mban diskutimin te efektet më të gjera të inteligjencës artificiale në jetën e njeriut, Deuze dhe Beckett (2022) fokusohen te efektet që kjo inteligjencë artificiale do të ketë te mediat dhe gazetarët duke theksuar nevojën e Edukimit mbi Inteligjencën Artificiale, pra njohjen me setin e rregullave dhe të dijes mbi të. “..., nuk duhet të jetë një histori e teknologjisë, por një histori e njerëzve: njerëzit që trajnojnë inteligjencën artificiale, njerëzit që lundrojnë nëpër

këto sisteme për të raportuar dhe që lidhen me audiencën dhe njerëzit që zhvillojnë marrëdhënie besimi me gazetarinë dhe gazetarët përmes një sërë platformash.”, theksojnë Deuze dhe Beckett.

Në fakt, disa redaksi dhe organizata botërore të gazetarisë kanë nisur punën me krijimin e rregullave në përdorimin e inteligjencës artificiale. Gama e depërtimit të inteligjencës artificiale në organizatat mediatike dhe te gazetarët mund të shfaqet siç Biswali dhe Kulkarni (2024) theksojnë, kryesisht për mbledhjen e lajmeve, për prodhimin e tyre (krijimin e përmbajtjeve, paketimin dhe ripaketimin), për shpërndarjen e lajmeve te konsumatorët, për përkthim, për filtrimin e lajmeve të rreme etj. Granados (2023) shkruan për “Forbes” se teknologjitë e inteligjencës artificiale e kanë potencialin për të përmirësuar krijimin e përmbajtjes dhe përvojën e konsumit të medias. Chazen konfirmon se përdorimi i inteligjencës artificiale në industrinë mediatike dhe atë të argëtimit ka një prirje drejt rritjes, ndërsa Simoni (2024) pasi ka studiuar situatën te 35 organizata mediatike; në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar dhe në Gjermani, thotë se efektet e inteligjencës artificiale në industrinë e lajmeve dhe mjedisin e informacionit e atë të arenës publike kuptohen shumë pak, duke shtuar se si me çdo teknologji të re që hyn në lajme, efektet e inteligjencës artificiale nuk do të jenë as aq të tmerrshme as aq utopike. Në studim theksohet se organizatat më të mëdha dhe me burime më të mira të lajmeve kanë më shumë gjasa të angazhohen në zhvillimin e brendshëm të inteligjencës artificiale ndërsa shumica e publikuesve të tjerë më të vegjël marrin zgjidhje nga palë të treta për shkak të kostove të larta që lidhen me inteligjencën artificiale të personalizuar. Një nga përfundimet më shqetësuese të studimit ka të bëjë me atë të krijimit të efekteve mbyllëse që rrezikojnë organizatat e lajmeve, për shkak se kompleksiteti i inteligjencës artificiale rrit kontrollin e kompanive të inteligjencës artificiale mbi këto organizata duke i mbajtur të lidhura. Kjo, me sa duket kufizon autonominë e organizatave të lajmeve dhe të gazetarëve dhe i bën këto organizata të prekshme ndaj rritjes së çmimeve ose ndryshimit të prioriteteve të kompanive teknologjike.

Po cilat janë raportet e gazetarëve dhe punonjësve të industrisë mediatike me inteligjencën artificiale? A do arrijë që inteligjenca artificiale të zëvendësojë gazetarët? Elmesselmani (2023) në studimin e ndikimit të inteligjencës artificiale në rrjetin “Al Jazeera” thekson se shumica e të anketuarve nuk ishin dakord që inteligjenca artificiale mund të zëvendësojë njerëzit në redaksi për të shkruar artikuj ndërsa 66% e të anketuarve besojnë se inteligjenca artificiale do të rrisë shkallën e papunësisë në lajme pasi industria do të zëvendësojë njerëzit; punët administrative, gazetarët e lajmeve dhe prodhuesit e redaktorët. Rezultatet e studimit theksojnë se 39% e të anketuarëve në rrjetin “Al Jazeera” besojnë se inteligjenca artificiale do të jetë e dobishme nëse zbatohet në industrinë e lajmeve, ndërsa 33% besojnë se nuk do të bënte një ndryshim të rëndësishëm. Një numër i madh i të anketuarve treguan mospajtim me atë që inteligjenca artificiale do të respektojë etikën e gazetarisë. Një raport tjetër, ai i “Thomson Foundation” (2024) lidhur me depërtimin e inteligjencës artificiale në organizatat mediatike në Çeki, Hungari, Poloni dhe Sllovakia thekson se në përgjithësi nuk i kalon 15%. “Me disa përjashtime, mediat maqedonase ende nuk e përdorin inteligjencën artificiale në punën e tyre të përditshme dhe nuk kanë përgatitur udhëzime dhe rekomandime për gazetarët dhe punonjësit e medias në lidhje me përdorimin e mundshëm të saj.”, shkruan Evrosimoska (2024) për situatën në Maqedoninë e

Veriut. Kurse situata tranzitore në Bosnje dhe Herzegovinë sipas autoreve Kostić dhe Sindere (2022) ka nevojë për të qartësuar Edukimin mbi Median dhe Informacionin në kontekstin e ri.

2. Metodologjia e studimit dhe rezultatet e para

Metodologjia e studimit përqendrohet te analiza e intervistave të strukturuar, ku u përzgjedhën për t'u përgjigjur disa profesionistë të mediave dhe përfaqësues nga universitetet. Ata u kontaktuan paraprakisht ku iu shpjegua qëllimi i studimit dhe mënyra se si do të dërgonin përgjigjet dhe më pas iu dërguan pyetjet nëpërmjet emailit. U kujdesëm që te përzgjedhja e profesionistëve të kishim përfaqësues të industrisë mediatike nga disa lloje të mediave: televizione dhe media online etj., me disa lloje të ndryshme përvojash të profesionistëve (me shumë vite përvojë dhe më të rinj në profesion, gazetarë televizioni, gazetarë investigativë etj), në disa role të ndryshme brenda mediave (gazetar, redaktor, kryeredaktor, drejtues programesh etj.), në role të ndryshme edhe sa i përket fuqisë vendimarrëse ku kemi intervistuar edhe disa drejtues ekzekutivë të mediave apo konsulentë për inteligjencën artificiale si dhe përfaqësues edhe të organizimeve të gazetarëve apo përfaqësues edhe nga akademia siç janë universitetet në Kosovë, Serbi dhe Bosnje dhe Herzegovinë. Në total janë realizuar 23 intervista me profesionistë të mediave në Bosnje dhe Herzegovinë (3), në Kosovë (3), në Serbi (3), në Mal të Zi (3), në Shqipëri (7) dhe në Maqedoninë e Veriut (4).

Emri i të intervistuarit	Media/ Organizata	Roli në Media/Organizatë	Shteti
Amela Delić Aščić	Universiteti i Tuzlës, Departamenti i Gazetarisë	Asistent Profesor	Bosnja dhe Herzegovina
Nataša Tadić	TV N1	Journalist	Bosnja dhe Herzegovina
Tahir Zustra	Nova TV	Journalist	Bosnja dhe Herzegovina
Eraldin Fazliu	Kohavision- KTV	Redaktor/Autor “Interaktiv”	Kosova
Serbeze Haxhijaj	RTK	Gazetare	Kosova
Haris Ademi	ATV dhe Kolegji AAB	Redaktor dhe Asistent Profesor	Kosova
Aleksandra Krstić	Universiteti i Beogradit, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit	Profesor i Asocuar	Serbia
Aleksa Tešić	BIRN Serbia	Gazetar	Serbia
Milica Srejić	Vreme	Gazetare	Serbia
Mustafa Canka	Portali Ul-Info	Kryeredaktor Portali Ul-Info	Mali i Zi
Ilmira Lika	TV Teuta	Gazetare	Mali i Zi
Ismet Kallaba	Koha Javore	Gazetar	Mal I Zi
Koloreto Cukali	Këshilli Shqiptar i Medias	Drejtues	Shqipëria
Gledis Bozo	Euroneës Albania	Konsulente	Shqipëria
Erjona Rusi	Top Channel	Moderatore	Shqipëria
Merita Haklaj	A2 CNN	Zevendëskryeredaktore	Shqipëria
Nolian Lole	Radiotelevizioni Shqiptar	Kryeredaktor -RTSH 24	Shqipëria
Roden Hoxha	Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore	Drejtor Ekzekutiv	Shqipëria
Isa Myzyraj	Ora News	Gazetar	Shqipëria

Dragan Sekulovski	Asosacioni i Gazetarëve të Maqedonisë	Drejtor Ekzekutiv	Maqedonia e Veriut
Goran Lefkov	Qendra për Gazetari Investigative SCOOP	President	Maqedonia e Veriut
Xhelal Neziri	BIRC Intitute	President	Maqedonia e Veriut
Seladin Xhezairi	Portali KDP	Kryeredaktor	Maqedonia e Veriut

Figura 1. Tabela me emrat e profesionistëve të intervistuar në rajonin e Ballkanit.

Përgjigjet e intervistave zbulojnë se pjesa më e madhe e profesionistëve mendojnë që zhvillimi i inteligjencës artificiale te mediat e rajonit të Ballkanit është në fazën fillestare (16 prej tyre), ndërsa vetëm 8 prej tyre mendojnë se është në zhvillim. Asnjë nga profesionistët nuk mendon se zhvillimi i inteligjencës artificiale është në fazë të avancuar. Kur pyeten nëse e përdorin inteligjencën artificiale në mediat ku punojnë apo drejtojnë, 10 prej profesionistëve thonë se e përdorin, 10 prej tyre tregojnë se nuk e përdorin dhe 1 po mendon ta përdorë.

Por çfarë thonë këta profesionistë se përdorin te inteligjenca artificiale dhe për çfarë qëllimesh? Çfarë mendojnë ata se mediat e tjera në Ballkan përdorin si dhe si i konsiderojnë përfitimet që kanë mediat nga përdorimi i inteligjencës artificiale? Të dhënat e sistemuara në tabelën e mëposhtme japin një përmbledhje të mjeteve të përdorura si dhe përfitimet që vijnë me inteligjencën artificiale sipas të intervistuarëve. Përfitimet që profesionistët mendojnë se vijnë me përdorimin e inteligjencës artificiale, duke evidentuar edhe mungesën e trajnimeve apo aftësimin te stafet gazetareske dhe më gjerë në media për përdorimin e inteligjencës artificiale, kanë të bëjnë kryesisht me rritjen e shpejtësisë, kreativitetin, uljen e kostove, shpërndarjen e personalizuar të përmbajtjeve, ndihmën në hulumtimin, mbledhjen, përpunimin dhe analizën e informacionit, njohjen më thellë të audiencës etj.

Përdorimi i inteligjencës artificiale në mediat e rajonit të Ballkanit			
Shteti	Në mediat e tyre (Mjeti/qëllimi)	Në mediat e tjera (Mjeti/Qëllimi)	Përfitimet nga përdorimi i inteligjencës artificiale
Bosnja dhe Herzegovina	-Për të ndihmuar prodhimet e programeve -Trajnime stafi	-Mjete të Inteligjencës Artificiale	-Kursen kohë dhe më lirë -Rritja e kreativitetit dhe inovacionit -Rutinë me eficiente të punëve të përditshme
Kosova	-Përdoret nga gazetarët dhe dizajnerët, kryesisht për transkriptim të deklaratave dhe krijim të grafikave.	-Për punë teknike -ChatGPT (shkrim të teksteve dhe transkriptim) -Krijim grafikash dhe foto ilustruese -Për automatizim	-Ndihmon me aspektet teknike, -Ndihmon me aspektet e hulumtimit -Kursen kohë -Ndihmon në kreativitet
Serbia	-ChatGPT -DALL-E	-ChatGPT për ide dhe transkriptim -Verifikim i autenticitetit të fotove	-Kursen kohë -Përmirëson cilësinë e gazetarisë dhe mbledhjen e informacionit e analizën e tij -Shkurton kërkimin dhe rikërkimin -Ndihmon gazetarët investigativë -Jep struktura tekstesh të gatshme (LLM) -Përshtatshmëri dhe produktivitet
Shqipëria	-Prezantues lajmesh -Për skaletë programi -Asistencë -ChatGPT -Për përmbledhjen dhe përpunimin e informacionit	-Euronews (Speaker Tokyo Tirana) -Riprodhim	-Shkurtim i kohës, më efikase, pa kosto njerëzore -Eksperimentime të reja tërheqëse për audiencën -Përmbajtje më të personalizuar -Lehtësira në përpunimin e të dhënave

	<ul style="list-style-type: none"> Montazh(Autopod) -Përkthim automatik -Postim automatik në mediat sociale 		<ul style="list-style-type: none"> -Menaxhimi i kohës së automatizuar me proceset si montazhi -Përkthimi, Postimet -Storyboard mbi informacione të ushqyera nga përdoruesit
Maqedonia e Veriut	<ul style="list-style-type: none"> -ChatGPT -Trajnime gazetarësh për Inteligjencën Artificiale 	<ul style="list-style-type: none"> - Algoritmet për personalizim të shpërndarjes së përmbajtjes (Meta.mk, Portalb.mk) -Për përkthim nga Maqedonishtja në Shqip 	<ul style="list-style-type: none"> -Kostot dhe impakti -Mbledhja efikase e lajmeve -Kreativiteti -Shpejtësi dhe më pak shpenzime -Rritet efikasiteti
Mali i Zi	<ul style="list-style-type: none"> -Për përkthim, për ide dhe kreativitet për tema 	<ul style="list-style-type: none"> -Përkthime -Radiotelevizioni Publik Kombëtar i Malit të Zi përdor LitterApp (program që transkripton audio dhe video) 	<ul style="list-style-type: none"> -Lehtësim në kreativitet, gjetje të materialeve, ulja e shpenzimeve -Mjete për prodhimin më efikas dhe më të sigurt të përmbajtjes -Përpunim i sasisë së madhe të të dhënave për investigim, gazetarët do merren me të vërtetën dhe më pak me elementët teknike

Tabela Nr.2. Çfarë thonë profesionistët e intervistuar për studimin se përdoret nga mediat e rajonit të Ballkanit sa i përket inteligjencës artificiale dhe çfarë përdorin në mediat e tyre. Përfitimet që ata gjykojnë se do vijnë nga përdorimi

Kur profesionistët pyeten nëse kanë njohuri për media në rajonin e Ballkanit që nuk e përdorin inteligjencën artificiale dhe pse, ajo që vihet re është se një pjesë e profesionistëve të intervistuar nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe të tjerë nuk kanë informacion të konsoliduar për këtë pyetje duke mos dhënë përgjigje. Ata që përgjigjen, si të intervistuarit e Bosnje dhe Herzegovinës, shohin si faktorë pengues nivelin e ulët të njohjes së teknologjisë nga popullata, ekzistencën e një numri të madh të websiteve informative si dhe mungesën e besimit të inteligjencës artificiale pasi sipas tyre gazetaria kërkon njerëz dhe jo mjete teknologjike. Për të intervistuarit në Kosovë, gazetarët nuk janë informuar siç duhet mbi inteligjencën artificiale në mungesë të trajnimeve, duke çuar në mospërdorimin e inteligjencës artificiale ndërsa edhe madhësia e audiencave të mediave mbetet përcaktuese për përdorimin ose jo të saj. Sa më e madhe media, aq më shumë ka gjasa ta përdorë. E njëjta arsye përsëritet edhe nga të intervistuarit në Serbi, si ajo se inteligjencën artificiale nuk është një teknologji shumë e njohur por po ashtu mediat dhe gazetarët nuk janë të ndërgjegjshëm për përfitimet. Një arsye për ta mbetet edhe mungesa e saktësisë. Profesionistët e Malit të Zi shprehen se ekziston ndrojtje dhe frikë nga keqpërdorimi të inteligjencës artificiale, duke sjellë mundësi manipulimi të informacionit e deri te përhapja e lajmeve të rreme që çenojnë objektivitetin dhe reputacionin e medias. Arsye për frenimin e përdorimit nga mediat e rajonit sipas tyre janë edhe mungesa e edukimit të profesionistëve dhe mungesa e rregullave të qarta ligjore e të transparencës. I njëjti arsyetim përmendet edhe nga të intervistuarit në Shqipëri, teksa ata mendojnë se inteligjencën artificiale nuk është kuptuar ende ndërsa mediat e gazetarët janë në fazë eksplorimi por nga ana tjetër ka mungesa të ardhurash financiare dhe duket se nuk është rregulluar ende aspekti i furnizimit në gjuhën shqipe apo furnizimi me përmbajtje për mediat lokale.



Figura Nr. 1. “Tokoy Tirana”, spikerja virtuale e gjeneruar nga intelijenca artificiale në televizionin Euronews Albania.
Foto marrë nga <https://euronews.al/en/innovation-at-euronews-albania-virtual-news-anchor-to-deliver-news/>

Megjithëse një pjesë e madhe e profesionistëve mendojnë se intelijenca artificiale nuk është kuptuar mirë nga profesionistët e medias dhe vetë mediat, ata janë të mendimit se ndërgjegjësimi të profesionistët për rreziqet që mund të sjellë intelijenca artificiale është më i lartë. Njëzëri 20 profesionistë të intervistuar miratojnë ekzistencën e rreziqeve, ndërsa 3 profesionistë të tjerë janë më të balancuar për të evidentuar në radhë të parë mundësitë e pafundme që sjell për mediat dhe profesionistët intelijenca artificiale, në raport me rreziqet.

“Unë shoh shumë mundësi për të krijuar mjete softuerike gazetareske me elementë të inteligjencës artificiale që do të ndihmonin punën gazetareske.”, thekson Aleksa Tešić, gazetar i “BIRN Serbia”. Po kështu, dy profesionistët nga Shqipëria, Merita Haklaj dhe Roden Hoxha e shohin “gotën” gjysmëplot. “Nuk mendoj se sjell rreziqe për shkak se vetë nga natyra është një mjet ndihmës dhe jo zëvendësues. Është në të njëjtat linja si “Google”, ku një kërkim i thjeshtë tashmë mund të bëhet nga zyra, pa qenë nevoja për të hulumtuar në biblioteka dhe pirgje dokumentash të printuara.”, shpjegon Roden Hoxha, drejtor ekzekutiv i Qendrës Shqiptare për Gazetari Cilësore. Por po kështu edhe për zëvendëskryeredaktoren e A2CNN-it në Shqipëri, media ka rreziqe më të mëdha se intelijenca artificiale. “Mendoj se risqet më të mëdha në vend për median nuk janë nga intelijenca artificiale por nga cënimi i lirisë së fjalës.”, thekson Merita Haklaj.

Rreziqet që profesionistët mendojnë që do sjellë intelijenca artificiale sa u takon mediave dhe gazetarisë	
Më i lehtë manipulimi i njerëzve	Mbiprodhimi i përmbajtjeve mediatike
Makineritë nuk kanë sens etike	Shkurtime në vendin e punës
Manipulimi i së vërtetës, i lajmeve, dezinformimi, përhapja e teorive të konspiracionit	Ulja e rëndësisë së gazetarëve dhe të redaktorëve
Vështirësia për të njohur informacionin e vërtetë	Probleme të tjera sociale
Ndërhyrja e botës së biznesit të mediat dhe audiencat	Ulja e besimit të lajmet dhe media
Mediume të caktuara do ta refuzojnë ta përdorin	Mungesë e qartësisë për mbrojtjen e viktimave nga intelijenca artificiale
Përdorimi joadekuat i inteligjencës artificiale	Shkelja e të drejtave të autorit
Humbja e vendeve të punës për shkak të automatizimit	Shndërrimi i punës së gazetarit në një proces mekanik
Manipulimi me përmbajtjen dhe raportimin	Audienca mund të ketë vështirësi në dallimin e lajmeve të rreme nga ato të vërteta

Ka rreziqe keqpërdorimi dhe keqinformimi	Përmbajtjet e inteligjencës artificiale mund të përmbajnë gabime apo keqinterpretime të të dhënave
Profilizimi i audiencës nëpërmjet personalizimit të përmbajtjes (thyerja e privatësisë)	Rreziku i plagjiaturës
Probleme me etikën e gazetarisë	Mungon kreativiteti, origjinaliteti, emocionaliteti që ndihet në tekstet e gjeneruara nga inteligjenca artificiale (publiku e ndjen këtë)
Në përdorim edhe nga audiencia, duke mos qenë vetëm në dorën e mediave dhe gazetarëve	Ka për të thelluar hendekun mes gjeneratave të reja dhe të vjetra të profesionistëve

Tabela Nr.3. Rreziqet që profesionistët e mediave në Ballkan mendojnë që do sjellë inteligjenca artificiale

Të dhënat e përftuara nga përgjigjet e profesionistëve të intervistuar vërtetojnë se përdorimi i inteligjencës artificiale është në fazën fillestare të mediat dhe gazetarët në rajonin e Ballkanit si dhe që gazetarët dhe mediat e njohin pak inteligjencën artificiale dhe përfitimet që mund të vijnë prej saj. Por nga ana tjetër vërtetohet nga intervistat e profesionistëve se janë më të vetëdijshëm për rreziqet që sjell.

3. Ridimensionimi i profesionit të gazetarit në Ballkan nën ndikimin e inteligjencës artificiale

Deuze dhe Witschge (2018) shkruajnë se "...të kuptuarit e gazetarisë do të thotë të vlerësosh përpjekjet personale të gazetarëve përtej mbrojtjeve institucionale dhe privilegjetve të profesionit.", duke theksuar rolin individual që gazetari ka në të gjithë procesin. Deuze dhe Beckett (2022) thellohen më shumë në ndikimin që u vjen këtyre gazetarëve nga inteligjenca artificiale në këto kohë transformimi. Çfarë u duhet gazetarëve të dinë për inteligjencën artificiale? Sipas tyre u duhen njohuri për inteligjencën artificiale, aftësi për të njohur raste dhe aftësi për të ndihmuar, trajnuar ose mësuar të tjerët kur kuptojnë, imagjinojnë, zhvillohen në mënyrë strategjike. "Puna...identifikoi një deficit të njohurive mbi inteligjencën artificiale brenda industrisë së re, si në aspektin e të kuptuarit të përgjithshëm ashtu edhe në atë të specializuar.

Edhe pse ky deficit po trajtohet, sinjalizojmë se rreziku është se ai nuk po ndryshon mjaftueshëm shpejt për të reduktuar rrezikun e ngecjes, të përkeqësimit të pabarazive (digjitale) dhe të rritjes së rrezikut real që gazetaria të kapet nga teknologjia (dhe sektori i teknologjisë), dhe jo përdorimi në mënyrë autonome i makinerive.", theksojnë Deuze dhe Beckett. Ata vënë në pah nevojën për riorganizimin e redaksive sa u përket rekrutimit, vendosjes së marrëdhënieve mes departamenteve, trajnimit dhe roleve, duke shtuar një fushë të re të punës gazetareske lidhur me angazhimin dhe kuptimin e sjelljes dhe nevojave të audiencës përmes personalizimit, eksplorimit të mundësive të reja të të ardhurave, interaktivitetit dhe bashkëpunimit. Megjithatë redaksitë, sipas Krampit dhe Loosenit (2018) janë përshtatur me padurim ndaj praktikave të tyre komunikuese për të arritur audiencën nëpërmjet kanaleve dhe platformave të ndryshme, siç kanë bërë me mediat sociale për shembull. Kjo ka ngritur nevojën për gazetarë që kryejnë disa punë njëherësh, duke sjellë qartësisht deprofesionalizimin e tyre siç e thekson Steve Paulussen (2012). Por nga ana tjetër inteligjenca artificiale mund të lehtësojë edhe punën investiguese të gazetarëve, siç shkruan Toledo (2024) apo që në gazetari është kthyer inovacioni siç shprehet Caswell (2023), ku të dy autorët japin orientime praktike për përdorimin e inteligjencës artificiale në përditshmërinë e punës së gazetarëve. Ndërsa Diab (2023), duke ngritur pyetjen për të ardhmen

e gazetarisë në epokën e inteligjencës artificiale thekson se gazetarët kanë nisur të zëvendësohen me mjetet e inteligjencës artificiale dhe profesioni sërish e gjen veten në një pikë kthese.

Në këtë studim 11 prej profesionistëve të pyetur theksojnë në mënyrë të qartë e të prerë se inteligjenca artificiale nuk do ta zëvendësojë gazetarin, ndërsa 9 profesionistët e tjerë të intervistuar mendojnë se inteligjenca artificiale do zëvendësojë pozicione të caktuara që lidhen me aspekte teknike dhe prodhimin. Një prej profesionistëve të intervistuar mendon se inteligjenca artificiale do zëvendësojë redaktorët. Sipas tyre inteligjenca artificiale do ndikojë në aspekte të tilla si shkrimi, editimi, transkriptimi i intervistave, transmetimi i lajmeve duke krijuar madje dhe një standardizim të shkrimit të lajmit apo duke ndikuar në uljen e barrierave të gjuhëve, uljen e origjinalitetit apo në uljen e rëndësisë së gazetarisë së terrenit nga kompanitë që do influencojnë në përhapjen e inteligjencës artificiale.

Gledis Bozo, konsulentja e "Euronews Albania" për inteligjencën artificiale, televizion që ka hedhur hapin i pari në Shqipëri me spikerin virtuale, thotë se aftësitë e gazetarit nuk mund të kodohen në një algoritëm. "A mund të shkruajë inteligjenca artificiale një artikull të mirë? Ndoshta. Por a mund të shkruajë një artikull që të të bëjë të qash, të qeshësh, të mendohesh dy herë? Një artikull që të ndryshojë mënyrën se si e shikon botën? Kjo është një histori tjetër. Dhe kjo është ajo që e bën gazetarinë kaq të veçantë. Është një ndërthurje e artit dhe shkencës, e fakteve dhe emocioneve, e mendjes dhe zemrës. Dhe kjo është diçka që vetëm një qenie njerëzore mund ta bëjë.", shprehet Bozo. Ajo shton se inteligjenca artificiale mund të automatizojë disa detyra që kryhen nga gazetarët, vendimmarrësit dhe specialistët e montazhit dhe transmetimit.

Dragan Sekulovski, drejtuesi i Asosacionit të Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut mendon se jo vetëm inteligjenca artificiale nuk do zëvendësojë gazetarët, përkundrazi do e rrisë rëndësinë e tyre, duke bërë që të rriten edhe aftësitë e efikasiteti në punën që kryejnë. "Inteligjenca artificiale ka një ndikim të thellë në proceset e shkrimit, të redaktimit dhe transmetimit të lajmeve, duke e transformuar çdo fazë të procesit në mënyra që rrisin efikasitetin, saktësinë dhe personalizimin. Mund të gjenerojë lajme, veçanërisht për tema me të dhëna të ngjeshura, të tilla si raportet financiare, përmbledhjet sportive dhe përditësimet e motit dhe të prodhojë përmbajtje të lajmeve elektronike shpejt dhe në masë të madhe duke i lejuar organizatat mediatike të mbulojnë një gamë të gjerë temash në të njëjtën kohë dhe të ofrojnë përditësime në kohë reale. Inteligjenca artificiale mund t'u ofrojë gazetarëve informacione dhe burime, të sugjerojë tituj dhe madje të propozojë kënde të historive bazuar në tendencat aktuale dhe të dhënat historike. Inteligjenca artificiale mund të analizojë sjelljen dhe preferencat e përdoruesve për të rekomanduar përmbajtje të personalizuar të lajmeve.", shtron Sekulovski mundësitë e krijuara në punën profesionale.

Amela Delić Aščić, profesoreshë në Universitetin e Tuzlës, jo vetëm që mendon se gazetarët nuk zëvendësohen nga inteligjenca artificiale por shton duke shpjeguar se arsyeja lidhet me filtrimin e informacionit si proces specifik që kërkon aftësi logjike specifike dhe sens moral. "Teknologjia di vetëm atë që ne i kemi mësuar. Gazetaria e mirë do të ketë gjithmonë të bëjë me njeriun. Vetëm njeriu mund të marrë vendime morale, etike, profesionale. Vetëm njeriu mund të krijojë një histori të jashtëzakonshme, autentike. Nëse mbledhim të gjitha njohuritë nga inteligjenca artificiale dhe përpiqemi të bëjmë vetëm një roman që do të tejkalojë zgjuarsinë për

shembull të romaneve të Tolstoit, Oruellit apo Karahasanit - jam e sigurt që do të zhgënjeheshim”, mendon Aščić.

Mirëpo, në vëzhgimin e drejtuesit të Këshillit Shqiptar të Medias në Shqipëri, Koloreto Cukalit, po krijohet një standardizim në shkrimin e lajmit. “Inteligjenca artificiale po krijon standardizim të shkrimit të lajmit – gjë jo shumë e mirë. Inteligjenca artificiale po krijon shpejtësi dhe përpunim më të mirë gjatë editimit. Shpejtësia dhe sasia në transmetim rriten”, mendon Cukali.

“Inteligjenca artificiale ndikon në pasurimin e teksteve me informacione, sidomos me sfond të ngjarjeve, biografi të personaliteteve të njohura, ngjarje historike në kalendar etj. Nëse përdoret për këto qëllime, atëherë ka ndikim pozitiv. Përndryshe, nëse i lihet në dorë komplet përmbajtja, atëherë shkrimi i lajmeve është pa ngjyra, pa kontekst dhe nuk i plotëson kushtet për publikim.”, thekson redaktori i “ATV”-së në Kosovë, Haris Ademi.

Milica Srejić, gazetare e “Vreme”-s në Serbi mendon se pyetja nëse inteligjenca artificiale do t’i zëvendësojë apo jo gazetarët, bëhet me shumë gjasa për shkak të frikës. “Mendoj se nuk mundet sepse natyra e punës përfshin ndërveprimin me burime të ndryshme dhe shkrimin e analizave. Gjithashtu besoj se inteligjenca artificiale nuk duhet të zëvendësojë moderatorët e programeve, ose të shërbejë si një mjet për të shkruar raporte investigative...Mendoj se në Serbi, inteligjenca artificiale nuk ka pasur ende një ndikim të rëndësishëm dhe nuk është zhvilluar në atë nivel. Lajmet, artikujt, redaktimi dhe aspekte të tjera ende shkruhen dhe menaxhohen kryesisht nga gazetarët dhe redaktorët.”, thotë Srejić.

Në Shqipëri Erjona Rusi, drejtuese e programit “Shqipëria Live” në Top Channel, megjithëse mendon se pjesët teknike që nuk kanë nevojë detyrimisht për një mendje njerëzore mund të zëvendësohen lehtësisht nga inteligjenca artificiale, ekzistojnë disa aspekte që nuk mund të zëvendësohen kurrë. “Megjithatë, gazetarët, ose atë që mund ta quajmë si “shpirti” i televizionit, nuk mund të zëvendësohet. Arsyeja është e thjeshtë, sepse nuk mund ta ndash mendimin nga ndjenja.”, shprehet Rusi. Po kështu edhe për gazetarin e “Nova TV” në Bosnje dhe Herzegovinë, Tahir Zustrën, mungesa e mundësisë që inteligjenca artificiale të zëvendësojë gazetarët ka si shkak atë se inteligjencës artificiale “i mungojnë ndjenjat si faktori kryesor dallues nga njerëzit si qenie të gjalla dhe sociale”. Megjithatë redaktori i “KTV”-së në Kosovë Eraldin Fazliu thotë se inteligjenca artificiale nuk mund të zëvendësojë të menduarit kritik. “Ndonëse nuk ka depërtuar me të madhe në trevat tona, përdorimi i inteligjencës artificiale mund të mbartë në vete edhe rreziqe të mëdha...Kjo ka të ngjarë mund të përdoret nga komuniteti biznesor me motive përfitimi ashtu që gazetarisë klasike, gazetarisë së terrenit do t’i ulej rëndësia.”, shpreh shqetësimin Fazliu.

Megjithatë gazetarja Nataša Tadić e “TV N1” në Bosnje dhe Herzegovinë mendon se rreziku për zëvendësim është në derën e redaktorëve, të cilin nuk e sheh si një zhvillim të mirë. Po pse inteligjenca artificiale nuk i zëvendëson dot gazetarët përtej aspektit se i mungon pjesa emocionale dhe sensi moral? Çfarë bën një gazetar që inteligjenca artificiale nuk e arrin dot? Gazetari i “BIRN Serbia”, Aleksa Tešić ka një shpjegim të hollësishëm. “Unë nuk shoh që inteligjenca artificiale të zëvendësojë gazetarët investigativë dhe të thelluar, sepse këta gazetarë duhet të “bëjnë lidhjen” e historisë në mendjet e tyre, duke lexuar shumë materiale dhe burime,

duke ruajtur kontekstet socio-ekonomiko-politike dhe duke gjetur histori në interes të publikut. Për më tepër, shumë histori investigative vijnë nga sinjalizues dhe burime dhe ky informacion nuk është i disponueshëm publikisht. Që një model i inteligjencës artificiale ta bëjë këtë, do t'i duhet qasje në pothuajse të gjitha burimet e informacionit, artikujt e lajmeve, postimet e mediave sociale, akses në grupet/kanalet në internet dhe të gjitha ato burime ku gazetaret gërmojnë - gjë që nuk ka gjasa të ndodhë për shkak të rezistencës nga kompanitë që zotërojnë këto faqe dhe të dhëna, duke përmendur të drejtat e autorit, privatësinë dhe interesat komerciale. Për më tepër, interesi publik ndryshon në çdo shtet. Intuita gazetareske gjithashtu nuk është diçka që një makinë mund ta mësojë lehtësisht.", arsyeton Tešić.

Në Mal të Zi gazetarja e "TV Teuta", Ilmira Lika mendon që jo vetëm nuk do zëvendësohen gazetaret nga inteligjenca artificiale por nëse ndodh, do të thotë "vrasje e inteligjencës së opinionit publik". Dhe nëse ndodh që inteligjenca artificiale të zëvendësojë gazetaret, atëherë nuk mbetet veçse të ndodhë ajo që Ismet Kallaba e formulon me fjalët "atëherë gazetaria ka vdekur". "Saktësia, drejtësia dhe shpejtësia janë vlerat kryesore për mediat e besueshme dhe besoj se përdorimi i kujdesshëm i inteligjencës artificiale mund t'u shërbejë këtyre vlerave dhe të përmirësojë punën tonë me kalimin e kohës.", mendon Mustafa Canka, kryeredaktori i "Portalit Ul-Info" në Mal të Zi.

Në kushtet e reja të krijuara, gazetari i televizionit "Ora News" në Shqipëri, Isa Myzyraj i druhet një rreziku tjetër. "Gazetarët nuk janë të rrezikuar nga inteligjenca artificiale, pasi askush, asgjë dhe kurrë nuk mund ta zëvendësojë rolin e gazetarit në gjetjen e lajmit apo kontaktit me burime. Ndërkohë mediat janë në rrezik për shkak se duhet të shtojnë kapacitetet sa i përket identifikimit të vërtetësisë së lajmeve, imazheve dhe videove.", përgjigjet Myzyraj. Nolian Lole, kryeredaktor i "RTSH 24" në Shqipëri mendon se inteligjenca artificiale do krijojë më shumë mundësi automatizimi por nuk do ndryshojë dot thelbin. "Nuk besoj se do të mund të zëvendësojë faktorin njeri. Mund të zëvendësojë personelin teknik, montazhin, lekturën, përkthimin, prezantimin...- por jo edhe gazetarin.", thotë Xhelal Neziri, president i organizatës mediatike "BIRC" në Maqedoninë e Veriut, duke shtuar se mediat dhe gazetaret ende janë në procesin e njohjes me inteligjencën artificiale.

Duke qenë se profesionistët e intervistuar parashikojnë një ridimensionim të profesionit të gazetarit, ata japin dhe sugjerimet e tyre lidhur me aftësitë e reja për të cilat gazetaret duhet të investojnë për t'i përvetësuar. Përshtatja me karakteristikat specifike teknike, rritja e shpejtësisë dhe e prirjes për inovacion, bashkëpunimi me redaksitë për aplikime të dedikuara të inteligjencës artificiale apo edhe orientimi të raportimit më të thelluar që punët rutinë t'i kryejë inteligjenca artificiale janë disa orientimet e profesionistëve në rajonin e Ballkanit.

Serbeze Haxhiaj, gazetare e "RTK"-së në Kosovë edhe pse e thekson se zhvillimet teknologjike po ecin me shpejtësinë e dritës, sipas saj po lënë shumë pas të mësuarit në gazetari, ku mbizotërojnë mënyrat tradicionale. "Mendoj që katedrat e gazetarisë sidomos këto në Ballkan nuk do jenë në gjendje të përgatisin ende një staf që përballon një treg të tillë, por as gjeneratat më të vjetra nuk do ta kenë shumë të lehtë për t'u përshtatur me trendet", përgjigjet Haxhiaj. "Inteligjenca Artificiale nuk është për t'u pasur frikë, por për t'u shfrytëzuar për mirë. Gazetarët në çdo rast do ta gjejnë veten e tyre, si dikur që rrezikohej radio nga televizioni, apo tani gazetaret

dhe televizioni nga media online. Se fundmi është inteligjenca artificiale, e cila kërkon vigjilencë. Kurrikulat e universiteteve për gazetarët e rinj duhet të përshtaten me urgjencë në funksion të një bote që po ndryshon me urgjencë.”, shprehet Merita Haklaj, zëvendëskryeredaktore e A2 CNN-it në Shqipëri. Për Goran Lefkovicin, president i Qendrës për Gazetari Investigative “SCOOP” profesioni i gazetarit mbetet 100% punë intelektuale. “Pra, në pjesën teknike ndoshta inteligjenca artificiale do të bëjë ndryshime, por nëse e krahasojmë me sektorët e tjerë, mendoj se në gazetari ajo nuk do të ndihmojë shumë në kreativitet. Ndoshta te pjesët video dhe audio mund të zëvendësojë por në gazetarinë investigative aty ku jam duke punuar, kreativiteti është më shumë i nevojshëm sesa pjesa teknike, kështu që nuk pres që disa robotë të vijnë dhe të bëjnë hulumtime në vend të fuqisë njerëzore.”, thekson ai. Profesoresha e gazetarisë dhe komunikimit në Universitetin e Beogradit Aleksandra Krstić jep një orientim krejt praktik duke thënë se profesionistët mund të përdorin me zgjuarsi teknologjitë e inteligjencës artificiale “në atë mënyrë që do ju jepte atyre më shumë kohë të mbulonin më thellë historitë dhe ta linin inteligjencën artificiale të bënte gjërat “e thjeshta” për ta”.

Analiza e intervistave të marra nga 23 profesionistë të medias dhe gazetarisë në rajonin e Ballkanit thekson se inteligjenca artificiale do ta ridimensionojë profesionin e gazetarit në pikëpamjeve të mjeteve që gazetari do të përdorë duke mos vënë asnjëherë në dyshim apo në rrezik gazetarin në rolin që ka mbajtur prej kohësh. Për të ruajtur këtë rol gazetarit do t'i duhet jo vetëm një përshtatje me inteligjencën artificiale por mundësisht të veprojë me vizion.

Është e dukshme se në këtë fazë gazetarët dhe mediat në rajonin e Ballkanit e njohin pak inteligjencën artificiale dhe përfitimet që mund të kenë nga përdorimi i saj në operacionet e përditshme por janë të vetëdijshëm për rreziqet që mund të sjellë si propaganda, dezinformimi, problemet e autorësisë, mungesa e privatësisë etj.

4. Disa përfundime dhe një ftesë për debat

Studimi tregon se përdorimi i inteligjencës artificiale te mediat dhe gazetarët e rajonit të Ballkanit është në fazë fillestare dhe që gazetarët dhe mediat e njohin pak inteligjencën artificiale dhe përfitimet që mund të vijnë prej saj. Por nga ana tjetër shihet se profesionistët janë të vetëdijshëm për rreziqet që sjell si dezinformimi, mungesa e origjinalitetit, çështjet etike, çështjet e privatësisë, përshtatja me gjuhët dhe mediat lokale etj.

Është e sigurt se me depërtimin e inteligjencës artificiale profili i gazetarit do ndryshojë. Tashmë inteligjenca artificiale në media është realitet me implementimet e para, edhe pse para pak kohësh qëndrimi i profesionistëve e çonte peshoren më shumë drejt indiferencës përballë saj. Inteligjenca artificiale do ta ridimensionojë profesionin e gazetarit në pikëpamjeve të mjeteve që gazetari do të përdorë duke mos vënë asnjëherë në dyshim gazetarin në rolin që ka mbajtur prej kohësh. Për të ruajtur këtë rol gazetarit do t'i duhet jo vetëm një përshtatje me inteligjencën artificiale por mundësisht të veprojë me vizion.

Është e dukshme se gazetarët dhe mediat në rajonin e Ballkanit e njohin ende pak inteligjencën artificiale dhe përfitimet që mund të kenë nga përdorimi i saj në operacionet e përditshme.

Parashikimi i profesionistëve të intervistuar? Zhvendoset nga formulimi i Mustafa Cankës se “do të ishte e rrezikshme për gazetarinë të mos mendonte se si duhet përdorur inteligjenca artificiale” te parashikimi i Erjona Rusit se mund të kemi një treg mediatik me një format më shumë mekanik, apo ai i Nolian Loles se “do të zgjidhen shume probleme teknike që egzistojnë aktualisht, por e ardhmja do te ketë shumë të panjohura.”

Shqetësimet mbeten te rregullimi ligjor në përdorimin e inteligjencës artificiale në atë që Ilmira Lika thekson se: “Shteti duhet të krijojë disa rregulla të reja në fushën e mediave, me qëllim që inteligjenca artificiale të mos fajësohet për shkak të keqpërdorimeve që mund t’i bëjnë disa media apo individë”.

“... Duhet të jemi gati të marrim kthesën pak më shpejt se dikur për t’iu përshtatur kohës, por për të mos humbur misionin e gazetarisë.”, mendon Merita Haklaj, ndërsa Dragan Sekulovski e thotë hapur se: “Ata që mund të integrojnë në mënyrë efektive inteligjencën artificiale ndërsa adresojnë rreziqet e saj do të jenë të pozicionuar mirë për të lulëzuar në tregun e ardhshëm të medias.”

Eraldin Fazliu thekson se “Në terma pesimist, do të shkaktojë një tërmet dhe humbje të vendeve të punës si dhe degradim të profesionit të gazetarit. Gjithsesi do ta dembelojë një pjesë të madhe të gazetarëve duke qenë se do e shohin më të lehtë përmes inteligjencës artificiale të kryejnë punën më shpejt. Në kuptimin më pozitiv, inteligjenca artificiale mund të sjellë disa benefite krejtësisht teknike, gjithnjë nëse do të reduktohej si një mjet i tillë”.

“Por ndryshimi më i madh do të jetë në mënyrën se si konsumojmë lajmet. Do të shohim një zhvendosje nga platformat tradicionale të transmetimit drejt një përvoje më interaktive dhe të personalizuar. Do të jemi në gjendje të zgjedhim se cilat lajme duam të shohim. Megjithatë, jam e bindur se përfitimet e IA-së do të tejkalojnë sfidat. Duke përqafuar këtë teknologji revolucionare, ne mund të krijojmë një treg mediatik që është më i gjallë, më i angazhuar dhe më i rëndësishëm se kurrë më parë. Një treg që nuk i shërben vetëm audiencës, por edhe e fuqizon atë.”, thotë Gledis Bozo. Përkundër dramaticitetit në analizën e Yuval Hararit, Xhelal Neziri qetëson lexuesit e profesionistët duke përfunduar se inteligjenca artificiale “Nuk është as armë bërthamore e as rrezik për njerëzimin. Ata që do të dijnë ta përdorin natyrisht se do të përfitojnë shumë, ata që s’dinë – nuk do të humbasin gjë.”.

A do të arrijë që gazetaria të bëhet më cilësore me inteligjencën artificiale? A do ta shohin gazetarët dhe mediat inteligjencën artificiale thjesht si mjetin e radhës në funksion të një të mire më të madhe apo do të bien në një marrëdhënie plot kushte në tavolinë ku peshorja do të anojë nga kompanitë që e ideuan dhe po synojnë depërtimin pa ndalim? A do të jetë inteligjenca artificiale “arma” në dorën e policit që garanton sigurinë për shoqërinë apo “arma” në dorën e kriminelit që bën të kundërtën?!

Bibliografia

Biswal, S.K., & Kulkarni, A.J. (2024). Exploring the Intersection of Artificial Intelligence and Journalism: The Emergence of a New Journalistic Paradigm (1st ed.). *Routledge India*.
<https://doi.org/10.4324/9781032716879>

- Caswell, D. (2023, Shtator 19). AI and journalism: What's next? Reuters Institute. <https://reutersinstitute.politics.ox.ac.uk/news/ai-and-journalism-whats-next>
- Chazen, D. AI in Media Industry: Artificial Intelligence and Latest Technology. Verbit. <https://verbit.ai/media/ai-in-media-industry-latest-technology/>
- Chomsky, N. (2023, Mars 8). Noam Chomsky: The False Promise of ChatGPT. The New York Times. <https://www.nytimes.com/2023/03/08/opinion/noam-chomsky-chatgpt-ai.html>
- Deuze, M., & Beckett, C. (2022). Imagination, Algorithms and Neës: Developing AI Literacy for Journalism. *Digital Journalism*, 10(10), 1913–1918. <https://doi.org/10.1080/21670811.2022.2119152>
- Deuze, M., & witschge, T. (2018). Beyond journalism: Theorizing the transformation of journalism. *Journalism*, 19(2), 165-181. <https://doi.org/10.1177/1464884916688550>
- Diab, K. (2023, Korrik 19). What future for journalism in the age of AI? Aljazeera. <https://www.aljazeera.com/opinions/2023/7/19/what-future-for-journalism-in-the-age-of-ai>
- Granados, N. (2023, Nëntor 6). Predicting The Pivotal Role of AI In Media And Entertainment. Forbes. <https://www.forbes.com/sites/nelsongranados/2023/11/06/predicting-the-pivotal-role-of-ai-in-media-and-entertainment/>
- Elmesselmani, J. (2023). The Perception of Artificial Intelligence in the Neës Industry A Study of AI Jazeera Network. AI Jazeera Centre for Studies. <https://studies.aljazeera.net/en/theses-al-jazeera/perception-artificial-intelligence-neës-industry-study-al-jazeera-network>
- Evrosimoska, B.M. (2024, Mars 18). Artificial intelligence – an enigma for macedonian media. ResPublica. <https://respublica.edu.mk/blog-en/politics/artificial-intelligence-an-enigma-for-macedonian-media/?lang=en>
- GZERO Media. (2024, Mars 12). Yuval Noah Harari: AI is a “social weapon of mass destruction” to humanity | GZERO World [Video]. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=QsyY1CKzSww>
- Këshilli i Europës. (2022). Responsible Artificial Intelligence-An overview of human rights’ challenges of Artificial Intelligence and media literacy perspectives in the context of Bosnia and Herzegovina. <https://rm.coe.int/mil-study-3-artificial-intelligence-final-2759-3738-4198-2/1680a828cf>
- Kramp, L., & Loosen, W. (2018). *The Transformation of Journalism: From Changing Neësroom Cultures to a New Communicative Orientation?*. In: Hepp, A., Breiter, A., Hasebrink, U. (eds) *Communicative Figurations. Transforming Communications – Studies in Cross-Media Research*. Palgrave Macmillan, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-319-65584-0_9
- Paulussen, S. (2012). Technology and the transformation of news work. Are labor conditions in (online) journalism changing? In E. Siapera, & A. Veglis (Eds.), *The Handbook of Global Online Journalism* (pp. 192-208). Blackwell-Ëiley.

- Simon, M. F. (2024). Artificial Intelligence in the News: How AI Retools, Rationalizes, and Reshapes Journalism and the Public Arena. Tow Report. https://www.cjr.org/toe_center_reports/artificial-intelligence-in-the-news.php
- Thomson Foundation. (2024). AI in Central European Newsrooms: Thomson's New Study Reveals Insights. https://www.thomsonfoundation.org/media/269005/tf_ai_in_v4_newsrooms.pdf
- Toledo, L.F. (2024, Mars 19). How artificial intelligence can facilitate investigative journalism. Center for International Media Assistance. <https://www.cima.ned.org/blog/how-artificial-intelligence-can-facilitate-investigative-journalism/>

Përdorimi i mediave sociale për informim

Shyhrete Maloku

Fakulteti i Komunikimit Masiv (Programi Master), Kolegji AAB

Email: shyhrete3.maloku@aab-edu.net

Abstrakt

Ky punim flet për përdorimin e mediave sociale si burim informacioni, duke analizuar anët pozitive dhe negative të kësaj praktike. Mediat sociale ofrojnë shpejtësi dhe kohë reale të shpërndarjes së informacionit, duke lejuar përdoruesit të qëndrojnë të informuar në çast. Përveç kësaj, ato ofrojnë një platformë për ndarjen e opinionëve dhe për të marrë pjesë në diskutime publike, duke forcuar pjesëmarrjen qytetare dhe demokratike. Megjithatë, përdorimi i mediave sociale për informim paraqet edhe sfida të konsiderueshme. Mungesa e verifikimit të fakteve dhe përhapja e dezinformatave dhe lajmeve të rreme janë disa nga problemet kryesore. Sipas raportit të Reuters Institute për Studimin e Gazetarisë (2023), shumë përdorues janë të shqetësuar për dallimin midis informacionit të vërtetë dhe atij të rremë, veçanërisht në rrjetet sociale të reja si TikTok dhe Instagram, ku influencerët dhe personalitetet shpesh marrin më shumë vëmendje sesa gazetarët. Punimi do të mbështetet në literaturë që trajton këtë fenomen dhe do të analizojë raste konkrete. Do të shqyrtohen rekomandimet për përdoruesit e mediave sociale që të jenë më të kujdesshëm dhe të informuar në mënyrë kritike. Përfundimisht, do të theksohet rëndësia e edukimit mediatic për të përmirësuar aftësitë e përdoruesve në identifikimin e burimeve të besueshme dhe shmangien e dezinformatave, duke marrë parasysh ndryshimet e vazhdueshme në shumëllojshmërinë e platformave dixhitale.

Fjalë kyç: media sociale, informim, dezinformim, fake news

Hyrja

Termi "media sociale" përshkruan një sërë mjetesh teknologjike që lejojnë njerëzit të ndajnë informacione dhe ide me njëri-tjetrin. Përafërsisht 60% e popullsisë globale, ose mbi 4.7 miliardë individë, përdorin mediat sociale, duke përfshirë Facebook, Instagram, YouTube dhe platformën X (më parë Twitter). Në fillim të vitit 2023, 94.8% e përdoruesve vizituan faqet e internetit dhe aplikacionet për chat dhe mesazhe, me platformat e mediave sociale që vijnë në vendin e dytë me 94.6% të përdoruesve (Sunstein, 2017).

Në epokën dixhitale, media sociale ka ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si njerëzit marrin dhe shpërndajnë informacion. Nga Facebook dhe Twitter, deri te Instagram dhe TikTok, këto platforma kanë bërë të mundur që lajmet dhe informacionet të përhapen më shpejt dhe më gjerësisht se kurrë më parë. Përdorimi i medias sociale për informim ka krijuar një paradigmë të re komunikimi ku individët jo vetëm që janë konsumatorë të informacionit, por edhe krijues dhe shpërndarës të tij. Ndërkohë që këto platforma ofrojnë mundësi të shumëta për të qenë të informuar në kohë reale dhe për të ndarë perspektiva të ndryshme, ato gjithashtu përballen me sfida të mëdha në lidhje me besueshmërinë e informacionit dhe përhapjen e lajmeve të rreme. Ky studim synon të analizojë rolin e medias sociale në procesin e informimit, përfitimet që ofron dhe

sfidat që paraqet, duke përfshirë ndikimin e saj në shoqëri dhe demokraci përmbledh Pariser (2011).

Ndërsa mediat tradicionale, si gazetat dhe televizionet, kanë luajtur një rol qendror në informimin publik për dekada të tëra, media sociale ka sjellë një revolucion të vërtetë në këtë fushë. Platforma si Facebook, Twitter dhe Instagram i lejojnë përdoruesit të ndajnë lajme dhe informacion në kohë reale, duke krijuar një burim informacioni të decentralizuar dhe të aksesueshëm për të gjithë. Kjo ka ndryshuar mënyrën se si njerëzit konsumojnë lajme, duke i bërë ata më aktivë dhe të përfshirë në diskutime publike. Për më tepër, këto platforma ofrojnë mundësi për organizata të ndryshme, aktivistë dhe gazetarë qytetarë për të arritur një audiencë më të gjerë dhe për të ngritur çështje që mund të mos marrin vëmendje të mjaftueshme në mediat tradicionale (Sunstein, 2017).

Megjithatë, përdorimi i medias sociale për informim nuk është pa sfida dhe rreziqe. Një nga problemet kryesore është përhapja e lajmeve të rreme dhe dezinformatave. Algoritmet që drejtojnë përmbajtjen në këto platforma shpesh favorizojnë përmbajtje të ndjeshme dhe provokuese, e cila mund të çojë në përhapjen e shpejtë të informacionit të pasaktë. Përveç kësaj, bota virtuale e medias sociale mund të krijojë dhoma jehone, ku përdoruesit ekspozohen kryesisht ndaj informacionit që përputhet me bindjet e tyre ekzistuese, duke përforcuar polarizimin dhe ndarjet shoqërore. Për të adresuar këto sfida, është e nevojshme të zhvillohen strategji dhe politika efektive që promovojnë edukimin medial dhe rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e verifikimit të burimeve të informacionit thekson Newman, Levy dhe Nielsen, 2023.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë rolin e medias sociale në procesin e informimit, duke vlerësuar përfitimet që ajo ofron dhe sfidat që paraqet. Studimi synon të shqyrtojë ndikimin e medias sociale në shoqëri dhe demokraci, duke adresuar aspektet pozitive si aksesueshmëria dhe përfshirja aktive e përdoruesve në diskutime publike, si dhe aspektet negative si përhapja e lajmeve të rreme dhe krijimi i dhomave jehonesh. Përmes këtij analizimi, studimi do të kontribuojë në zhvillimin e strategjive dhe politikave që mund të promovojnë një përdorim më të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm të medias sociale për informim përmbledh Sunstein, (2017).

Hipoteza e këtij punimi:

Hipoteza e këtij studimi është se përdorimi i medias sociale për informim ka një ndikim të dyfishtë në shoqëri: media sociale rrit qasjen dhe përfshirjen e qytetarëve në diskutimet publike, duke përmirësuar kështu ndërgjegjësimin dhe angazhimin civil. Kontribuon gjithashtu edhe në përhapjen e dezinformatave dhe polarizimin shoqëror.

Kjo hipotezë sugjeron që, ndërsa media sociale mund të luajë një rol pozitiv në informimin e publikut, është gjithashtu thelbësore të adresohen sfidat dhe rreziqet e lidhura me të për të siguruar një mjedis informues më të besueshëm dhe të qëndrueshëm.

Shqyrtimi i literaturës

Funksioni i mediave sociale në shoqëri

Mediat sociale të sotme përdoren për shënimin e faqeve sociale, lajmet sociale, ndarjen e mediave, mikroblogging dhe forumet në internet janë gjashtë kategoritë në të cilat zakonisht ndahen platformat e mediave sociale.

Këto platforma të ndryshme kujdesen për një gamë të gjerë interesash dhe objektivash të përdoruesve. Disa janë më tërheqës për hobistët sesa për profesionistët. Ato përdoren nga njerëzit për të gjetur njerëz në mbarë botën që kanë opinione të ngjashme politike ose të tjera. Mediat sociale lidhin politikanët me votuesit, argëtuesit me fansat dhe bamirësitë me donatorët. Mediat sociale janë një mjet i zakonshëm që përdoret nga qeveritë për të shpërndarë informacione të rëndësishme gjatë katastrofave (Silverman, 2013).

Rrjetet sociale janë bërë një mjet jetik marketingu për kompanitë. Bizneset e përdorin atë për të gjetur dhe ndërvepruar me konsumatorët, për të promovuar dhe reklamuar për të rritur shitjet, për të dalluar tendencat e konsumatorit në zhvillim të shpejtë dhe për të ofruar kujdes ndaj klientit.

Facebook tani ka rreth 25% të popullsisë globale në të. Përafërsisht 80% e të gjithë përdoruesve të internetit në Shtetet e Bashkuara përdorin këtë platformë. Rrjetet sociale fitojnë fuqi ndërsa zgjerohen sepse ushqehen nga ndërveprimet njerëzore (Newman, Levy, & Nielsen, 2023). Çdo individ me opinione marginale tani mund të kuptojë se nuk është vetëm për shkak të internetit. Dhe sapo këta individë të lidhen me njëri-tjetrin në mediat sociale, ata mund të bëjnë gjëra të tilla si: botime, meme dhe komunitete të tëra virtuale që mbështesin këndvështrimin e tyre përpara se të bëhen të njohur.

Padrejtësitë politike, etike, mjedisore dhe sociale do të ishin shumë më pak të dukshme pa mediat sociale. Publiku tani ka më shumë ndikim se një numër i vogël njerëzish për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit për shqetësimet (Gaitho, 2022).

Efeket pozitive të mediave sociale

Lidhshmëria- Lidhshmëria është ndër përfitimet më të rëndësishme të mediave sociale. Mund të lidhë përdorues të panumërt në çdo kohë, kudo. Informacioni mund të përhapet globalisht përmes mediave sociale dhe lidhjes së tyre, duke e bërë të thjeshtë që njerëzit të ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Rezulton në marrëdhënie globale.

Arsimi- Përdorimi i mediave sociale në arsim është i lavdërueshëm. Nxënësit dhe edukatorët mund të regjistrohen në platforma globale bashkëpunuese për të lehtësuar të mësuarit konstruktiv. Ai gjithashtu ndihmon në përmirësimin e aftësive duke nxitur njohuritë dhe kreativitetin.

Informacion dhe përditësime- Qëndroni të informuar për ngjarjet që ndodhin në të gjithë globin ose në jetën e njerëzve të tjerë duke përdorur mediat sociale. Në ndryshim nga televizioni, radioja apo gazetat, mediat sociale i lejojnë të gjithë të përcjellin informacionin me saktësi duke paraqitur pamjen reale. Ndihmon në shfaqjen e lajmeve të botës reale në të gjithë globin.

Ndërgjegjësimi- Njerëzit janë bërë më të ndërgjegjshëm falë mediave sociale. Ai shërben si një kanal informacioni, duke hapur kështu rrugën drejt inovacionit dhe suksesit nëpërmjet zhvillimit të njohurive dhe aftësive të tyre. Mediat sociale mbulojnë mirë ngjarjet globale, duke i bërë njerëzit më të vetëdijshëm për rrethinën e tyre.

Ndarja e çdo gjëje me të tjerët- Mediat sociale janë platforma më e mirë për të përcjellë ndjenja dhe opinione - një këngë, një poezi, një vepër arti, një ëmbëlsirë dekadente ose çdo gjë tjetër. Çdokush mund të lejojë që krijimtaria e tij të shkëlqejë përmes platformës që ajo të ndahet nga miliona të tjerë. Ndarja e veprave artistike me të tjerët mund të hapë derën e arritjeve dhe disa piketa. (Gaitho, 2022)

Efektet negative të mediave sociale

Meqenëse media sociale është një teknologji relativisht e re, mund të jetë sfiduese për të përcaktuar përfitimet dhe të metat e saj afatgjata. Megjithatë, një numër studimesh kanë gjetur një lidhje të drejtpërdrejtë midis përdorimit të tepërt të mediave sociale dhe një rreziku më të lartë të ankthit, vetmisë, dëshpërimit dhe vetë-dëmtimit.

Mediat sociale pengojnë lidhjet emocionale. Gjithçka transmetohet përmes teksteve në mënyrë dixhitale, të cilat mund të pengojnë shprehjet. Zgjuarsia humbet kur njerëzit që në mënyrë ideale do të vizitonin njëri-tjetrin për të përcjellë përshëndetje dërgojnë vetëm mesazhe me tekst në vend të përfaqimeve Sunstein, (2017).

Zvogëlon aftësitë e zgjuarsisë- Me uljen e bisedave reale ballë për ballë dhe bisedave personale, zgjuarsia e shpejtë është e rrallë. Ndjenja e humorit dhe ballafaqimet sportive janë komprometuar - ndjenja e dashurisë, miqësisë, argëtimit dhe kënaqësisë janë zhdukur të gjitha për shkak të efekteve të mediave sociale në shëndetin mendor të njeriut.

Shkaktimi i shqetësimit në ndjenjat e dikujt- Njerëzve që përdorin rrjetet sociale për të komunikuar u mungon empatia dhe nuk i shkelin syrin kur duhet të lëndojnë dikë. Trollet e fundit, komentet negative dhe reagimet janë të gjitha dëshmitarë të zemërgurësisë që ka evoluar për shkak të natyrës së padukshme të mediave sociale.

Prezenca e personit fizikisht por jo mendërisht- Kalimi i kohës me njëri-tjetrin ka të bëjë me të qenit 'prezent' dhe në moment. Ndërsa miqtë dhe familja mblidhen, krijoni kujtime duke folur me njëri-tjetrin për kohët e kaluara, të tashmen dhe të ardhmen. Fatkeqësisht, sot që mediat sociale janë vënë në dispozicion në celular, njerëzit kalojnë kohë me njëri-tjetrin duke 'lëvizur' nëpër postime.

Mungesa e mirëkuptimit dhe e mendimit- Ndjenjat përcillen përmes fjalës dhe zërit - por për ta bërë këtë, duhet të jeni fizikisht të pranishëm para personit tjetër për të komunikuar ndjenjat në mënyrë efektive. Megjithatë, mediat sociale i japin një ngjyrim tjetër kur dikush i vendos ato në një tekst, duke maskuar kështu kuptimin e vërtetë.

Mungesa e kohës cilësore të familjes- Mediat sociale kanë qenë shkak i shumë marrëdhënieve të ndërprera thjesht sepse familjet nuk mund të kalojnë kohë cilësore me njëra-tjetrën. Koha e familjes ka marrë një goditje me 'unë' dhe privatësia ka marrë përparësi (për shkak të cilësisë së teksteve që shfaqen në mediat sociale) (Gaitho, 2022).

Keqinformimi i shoqërisë nga mediat sociale

Keqinformimi në mediat sociale mund të ketë efekte të thella dhe të gjera në shoqëri, duke ndikuar në aspekte të ndryshme të jetës sociale, politike dhe ekonomike. Këtu janë disa mënyra kryesore se si dezinformimi në mediat sociale ndikon në shoqëri:

Sipas Sunstein, (2017) keqinformimi thyen besimin e publikut në media, qeveri dhe institucione të tjera. Kur informacioni i rremë përhapet gjerësisht, mund të çojë në skepticizëm për besueshmërinë e të gjitha burimeve të informacionit, duke e bërë të vështirë për individët të dallojnë se çfarë është e vërtetë dhe kujt t'i besojnë. Ky erozion i besimit mund të destabilizojë proceset demokratike dhe të reduktojë angazhimin qytetar.

Platformat e mediave sociale shpesh krijojnë dhoma jehone ku përdoruesit janë të ekspozuar kryesisht ndaj informacionit që përputhet me besimet e tyre ekzistuese. Keqinformimi mund t'i përkeqësojë këto ndarje duke përforcuar paragjykimet dhe duke thelluar ndarjet ideologjike. Ky polarizim mund të çojë në rritje të armiqësisë dhe ulje të gatishmërisë për t'u përfshirë në dialog konstruktiv me ata që kanë pikëpamje të kundërta Chadwick & Vaccari, (2019).

Keqinformimet në lidhje me shëndetin, si pretendimet e rreme për vaksinat ose trajtimet, mund të kenë pasoja serioze për shëndetin publik. Për shembull, gjatë pandemisë COVID-19, keqinformimi rreth virusit dhe vaksinave çoi në hezitim të vaksinave, duke minuar përpjekjet e shëndetit publik dhe duke kontribuar në sëmundje dhe vdekje të parandalueshme.

Keqinformimi mund të përdoret si mjet për manipulim politik, duke ndikuar në zgjedhje dhe duke minuar proceset demokratike. Informacioni i rremë rreth kandidatëve, procedurave të votimit dhe rezultateve të zgjedhjeve mund të ngatërrojë votuesit, të shtypë pjesëmarrjen e votuesve dhe të gërryjë besimin në sistemin zgjedhor (Chadwick, & Vaccari, 2019).

Informacioni i rremë mund të ndikojë gjithashtu në vendimet ekonomike dhe tregjet. Për shembull, keqinformimi për tregjet financiare ose veprimet e korporatave mund të çojë në paqëndrueshmëri të tregut të aksioneve, duke ndikuar në investimet dhe stabilitetin ekonomik. Për më tepër, bizneset mund të pësojnë dëmtim të reputacionit për shkak të pretendimeve të rreme të përhapura në mediat sociale.

Ekspozimi ndaj përmbajtjes ekstremiste dhe teorive konspirative në mediat sociale mund të kontribuojë në radikalizimin dhe nxitjen e dhunës. Individët që konsumojnë dhe besojnë në një dezinformim të tillë mund të kenë më shumë gjasa të përfshihen në veprime të dëmshme, duke përfshirë krimet e urrejtjes dhe aktet e terrorizmit (Chadwick & Vaccari, 2019).

Përhapja e dezinformatave mund të ketë edhe efekte psikologjike te individët. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj informacionit të rremë mund të shkaktojë konfuzion, ankth dhe stres. Mund të çojë gjithashtu në një ndjenjë pafuqie dhe zhgënjimi kur përpigëni të lundroni në kompleksitetin e peizazhit të informacionit.

Keqinformimi mund të dëmtojë të kuptuarit publik të shkencës dhe arsimit. Pretendimet e rreme për tema shkencore, të tilla si ndryshimet klimatike ose trajtimet mjekësore, mund të pengojnë vendimmarrjen e informuar dhe politikat publike. Kjo mund të ngadalësojë përparimin në adresimin e çështjeve kritike si mbrojtja e mjedisit dhe shëndeti publik.

Adresimi i ndikimit të keqinformimit në mediat sociale kërkon një qasje të shumëanshme, duke përfshirë përmirësimin e shkrim-leximit dixhital, zbatimin e politikave më të forta të moderimit të përmbajtjes dhe promovimin e burimeve të besueshme të informacionit. Është thelbësore që shoqëria të zhvillojë qëndrueshmëri ndaj dezinformatave për të mbrojtur proceset demokratike, shëndetin publik dhe kohezionin social (Silverman, 2013).

Metodologjia

Përcaktimi i kornizës teorike: Rishikimi i studimeve ekzistuese mbi rolin e medias sociale në informim, përfitimet dhe sfidat e saj. Përfshirja e teorive mbi komunikimin masiv, ndikimin e medias dhe edukimin medial.

Identifikimi i studimeve empirike: Shqyrtimi i hulumtimeve të mëparshme që kanë analizuar përhapjen e dezinformatave, ndikimin e algoritemve të medias sociale.

Analiza e statistikave të vitit 2023: Nga të dhënat e nxjerra nga literatura, bëhet krahasimi dhe analizimi mes shteteve dhe përdoruesve të rrjeteve sociale në vitin 2023

Pyetjet e rast studimit:

1. Si ndikon përdorimi i medias sociale në mënyrën se si individët marrin dhe shpërndajnë informacion?

- Kjo pyetje synon të shqyrtojë ndryshimet në praktikën e konsumimit të informacionit midis medias sociale dhe medias tradicionale, duke përfshirë faktorët që ndihmojnë në rritjen e angazhimit dhe ndërgjegjësimin publik.


2. Cilat janë sfidat kryesore të përhapjes së dezinformatave në media sociale dhe si ndikojnë ato në perceptimet dhe sjelljet e përdoruesve?

- Kjo pyetje synon të identifikojë problemet kryesore të përhapjes së lajmeve të rreme në media sociale dhe të shqyrtojë se si këto dezinformata ndikojnë në bindjet dhe veprimet e përdoruesve, duke kontribuar në polarizimin dhe ndarjen shoqërore.

Rezultate

Në tabelat e mëposhtme janë parqitur disa të dhëna nga statistikat e mbledhura bazuar në mediat sociale dhe përdorimin e tyre nga shtresa të ndryshme të shoqërisë.

Tabela 1 Statistikat e përdoruesve të rrjeteve të ndryshme sociale



Burimi: Newman, Levy, & Nielsen, 2023.

Kjo tabelë ilustron burimet kryesore të lajmeve në disa platforma të medias sociale për tregje të ndryshme. Kategoritë e burimeve përfshijnë: media tradicionale, burime të vogla ose alternative të lajmeve, politikanë/aktivistë politikë, personalitete (përfshirë të famshëm dhe influencers), dhe njerëz të zakonshëm. Këtu është një analizë e detajuar për secilën platformë:

Twitter

Media tradicionale (55%): Shumica e përdoruesve të Twitter-it marrin lajme nga burime tradicionale dhe gazetarë të njohur.

Personalitete dhe politikanë (43%): Një përqindje e barabartë marrin lajme nga personalitete dhe politikanë/aktivistë politikë.

Facebook

Media tradicionale (43%): Facebook ka një përdorim të konsiderueshëm të mediave tradicionale për marrjen e lajmeve.

Njerëz të zakonshëm (37%) dhe burime alternative (38%): Përdoruesit marrin lajme edhe nga burime jo-tradicionale dhe njerëz të zakonshëm.

Personalitete (27%) dhe politikanë (24%): Këto burime janë më pak të përdorura krahasuar me Twitter.

YouTube

Personalitete (45%): Ky është burimi kryesor i lajmeve në YouTube, duke reflektuar ndikimin e influencersve dhe të famshëmve.

Media tradicionale (42%): Një përqindje e konsiderueshme përdorin edhe media tradicionale.

Burime të vogla/alternative (30%) dhe njerëz të zakonshëm (29%): Burimet alternative dhe njerëzit e zakonshëm gjithashtu kanë një pjesë të konsiderueshme.

Instagram

Personalitete (52%): Burimi më i përdorur për lajme në Instagram janë personalitetet, duke përfshirë të famshëm dhe influencers.

Media tradicionale (42%): Gjithashtu, media tradicionale mbetet një burim i rëndësishëm.

Njerëz të zakonshëm (33%) dhe burime alternative (31%): Përdoruesit marrin lajme edhe nga burime alternative dhe njerëz të zakonshëm.

Snapchat

Personalitete (55%): Ashtu si Instagram dhe TikTok, personalitetet janë burimi kryesor i lajmeve në Snapchat.

Media tradicionale (36%): Media tradicionale ka një prani të konsiderueshme.

Njerëz të zakonshëm (30%) dhe burime alternative (25%): Këto burime kanë një pjesë të konsiderueshme të përdoruesve që marrin lajme.

TikTok

Personalitete (55%): TikTok ndan të njëjtin trend me Snapchat dhe Instagram, me personalitetet si burimi kryesor i lajmeve.

Njerëz të zakonshëm (44%): Një përqindje e lartë e përdoruesve marrin lajme nga njerëz të zakonshëm.

Media tradicionale (33%) dhe burime alternative (31%): Media tradicionale dhe burime alternative kanë një prani të konsiderueshme.

Kjo tabelë tregon se ndonëse media tradicionale mbetet një burim i rëndësishëm i lajmeve në disa platforma, ndikimi i personaliteteve (përfshirë të famshëm dhe influencers) është shumë i lartë, veçanërisht në platformat vizuale si Instagram, Snapchat, dhe TikTok. Po ashtu, njerëzit e zakonshëm dhe burimet alternative të lajmeve kanë një rol të konsiderueshëm, duke reflektuar natyrën e decentralizuar të informimit në epokën e medias sociale.


Tabela 2. Rëndësia e mediave të shërbimit ndaj shoqërisë

Country	Net: Important for me ▼	Neither/Don't know
Finland	+60	19%
Denmark	+59	23%
Norway	+53	23%
Sweden	+50	21%
Portugal	+46	27%
Netherlands	+44	32%
South Korea	+43	29%
Belgium	+41	32%
Switzerland	+36	30%
Australia	+34	30%
Italy	+28	35%
Ireland	+25	29%
Germany	+22	27%
UK	+20	28%
Canada	+19	37%
France	+18	38%
Austria	+16	26%
Spain	+15	35%
Japan	±0	39%

Burimi: Newman, Levy, & Nielsen, 2023.

Në rreth 80% të vendeve të mbuluara, shumica e të anketuarve thonë se mediat e shërbimit publik janë të rëndësishme për shoqërinë, dhe në të 19 vendet, më shumë njerëz thonë se janë të rëndësishme për shoqërinë sesa të parëndësishme. Në më shumë se gjysmën e vendeve, shumica e të anketuarve thonë se mediat e shërbimit publik janë të rëndësishme për ta personalisht, dhe në 18 nga 19 vendet, më shumë njerëz thonë të rëndësishme për ta personalisht sesa të parëndësishme (në Japoni, numrat e fundit janë të barabartë).

Tabela 3



Burimi: Newman, Levy, & Nielsen, 2023.

Më shumë se gjysma (56%) thonë se shqetësohen për identifikimin e ndryshimit midis asaj që është e vërtetë dhe e rreme në internet kur bëhet fjalë për lajmet – me 2 pikë përqindjeje më shumë se vitin e kaluar. Ata që thonë se përdorin kryesisht mediat sociale si burim lajmesh janë shumë më të shqetësuar (64%) sesa njerëzit që nuk e përdorin fare (50%) ndërsa shumë vende me nivelet më të larta të shqetësimit gjithashtu priren të kenë nivele të larta të përdorimit të lajmeve të mediave sociale.

Kjo tabelë tregon përqindjen e përdoruesve që marrin lajme nga rrjetet sociale në rajone të ndryshme të botës. Afrika ka përqindjen më të lartë me 77%, duke treguar një varësi të lartë nga rrjetet sociale për informim. Amerika e Veriut (65%) dhe Amerika Latine (62%) gjithashtu kanë përqindje të larta, duke reflektuar ndikimin e fortë të medias sociale në këto rajone. Azia Paqësori (56%) dhe Europa (53%) kanë përqindje më të ulëta në krahasim me rajonet e tjera, por ende tregojnë se më shumë se gjysma e përdoruesve në këto rajone marrin lajme përmes rrjeteve sociale. Kjo diferencë mund të jetë e lidhur me nivelin e zhvillimit të infrastrukturës digjitale, nivelin e besueshmërisë në media tradicionale, dhe faktorë të tjerë kulturorë dhe ekonomikë.

Diskutime

Facebook mbetet një nga rrjetet sociale më të përdorura në përgjithësi, por ndikimi i saj në gazetari është në rënie pasi ajo e zhvendos fokusin e saj nga lajmet. Ai gjithashtu përballet me sfida të reja nga rrjetet e krijuara si YouTube dhe rrjetet vibrante të fokusuara tek të rinjtë si TikTok. Rrjeti social në pronësi kineze arrin në 44% të moshës 18-24 në tregje dhe 20% për lajme. Ajo po rritet më shpejt në pjesë të Azisë-Paqësorit, Afrikës dhe Amerikës Latine.

Kur bëhet fjalë për lajmet, audienca thotë se u kushton më shumë vëmendje personave të famshëm, ndikuesve dhe personaliteteve të mediave sociale sesa gazetarëve në rrjete si TikTok, Instagram dhe Snapchat. Kjo është në kontrast të fortë me Facebook dhe Twitter, ku mediat e lajmeve dhe gazetarët janë ende në qendër të bisedës.

Pjesa më e madhe e publikut është skeptik për algoritmet e përdorura për të zgjedhur atë që ata shohin nëpërmjet motorëve të kërkimit, mediave sociale dhe platformave të tjera. Më pak se një e treta (30%) thonë se të kesh histori të zgjedhura për mua në bazë të konsumit të mëparshëm është një mënyrë e mirë për të marrë lajme, 6 pikë përqindjeje më e ulët se kur e bëmë pyetjen për herë të fundit në 2016. Pavarësisht kësaj, mesatarisht, përdoruesit ende preferojnë pak lajmet e zgjedhura në këtë mënyrë ndaj atyre të zgjedhura nga redaktorët ose gazetarët (27%),

duke sugjeruar se shqetësimet rreth algoritmeve janë pjesë e një shqetësimi më të gjerë për lajmet dhe mënyrën se si ato përzgjidhen.

Pavarësisht shpresave se interneti mund të zgjerohet demokratik debat, ne shohim se më pak njerëz po marrin pjesë tani në internet lajme se sa në të kaluarën e afërt. Të grumbulluara vetëm nëpër tregje rreth një e pesta (22%) tani janë pjesëmarrës aktivë, me rreth gjysma (47%) nuk marrin pjesë fare në lajme. Në Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara , përqindja e pjesëmarrësve aktivë ka rënë me më shumë se 10 pikë përqindjeje që nga viti 2016. Në të gjithë vendet ne zbulojmë se ky grup priret të jetë meshkuj, më të arsimuar dhe më partizan në pikëpamjet e tyre politike.

Besimi në lajmet ka rënë, në tregje, me 2 pikë përqindje të tjera vitin e kaluar, duke përmbysur në shumë vende fitimet e arritura në kulmin e pandemisë së Coronavirus. Mesatarisht, katër në dhjetë nga 40%) thonë se i besojnë shumicës së lajmeve shumicën e kohës. Finlanda mbetet vendi me nivelet më të larta të besimit të përgjithshëm (69%), ndërsa Greqia (19%) ka nivelin më të ulët pas një viti të karakterizuar nga argumente të nxehta për lirinë e shtypit dhe pavarësinë e medias.

Përfundime

Raporti i Lajmeve Dixhitale nga RISJ (Reuters Institute for Study of Journalism) është raporti vjetor më gjithëpërfshirës mbi konsumin e lajmeve në mbarë botën. Raporti i këtij viti zbulon njohuri të reja bazuar në një anketë të YouGov me mbi 93,000 konsumatorë të lajmeve në internet në 46 tregje, duke mbuluar gjysmën e popullsisë së botës.

Raporti ofron dëshmi se audiencia e lajmeve po bëhet më e varur nga platformat dixhitale dhe sociale, duke ushtruar presion të mëtijshëm si mbi modelet e biznesit të bazuara në reklama ashtu edhe mbi modelet e abonimit të organizatave të lajmeve në një kohë kur shpenzimet e familjeve dhe të kompanive janë duke u shtrydhur.

Si interesi ashtu edhe besimi për lajmet vazhdojnë të bien në shumë vende pasi lidhja mes gazetarisë dhe pjesës më të madhe të publikut vazhdon të rrënohet. Ka prova që audiencat vazhdojnë të shmangin në mënyrë selektive histori të rëndësishme si lufta në Ukrainë dhe kriza e kostos së jetesës, ndërsa reduktojnë lajmet dëshpëruese dhe kërkojnë të mbrojnë shëndetin e tyre mendor.

Rekomandime

Duke pasur parasysh ndikimin e rëndësishëm të mediave sociale në shpërndarjen e informacionit dhe potencialin për keqinformim, këtu janë disa rekomandime për përdoruesit e mediave sociale për t'u siguruar që ata konsumojnë dhe ndajnë informacionin me përgjegjësi:

Verifikimi i burimeve - Burimet e besueshme zakonisht kanë një histori raportimi të saktë dhe transparencë në procesin e tyre editorial.

- Fakte të kryqëzuara: Krahasoni informacionin me burime të tjera me reputacion për të konfirmuar saktësinë e tij përpara se ta besoni ose ta shpërndani.

- Ji kritik dhe skeptik - Jini të kujdesshëm ndaj titujve ose postimeve që duken tepër sensacionale ose të ngarkuara emocionalisht. Këto shpesh synojnë të provokojnë një reagim dhe jo të informojnë.

- Kuptimi i paragjyqimeve - Jini të vetëdijshëm për paragjykimet tuaja dhe se si ato mund të ndikojnë në gjykimin tuaj. Përpiquni të konsumoni një përzierje të ekuilibruar informacioni nga këndvështrime të ndryshme.

- Identifikoni paragjykimet në burime: Kuptoni paragjykimet e mundshme të burimeve që po lexoni. Asnjë burim nuk është plotësisht objektiv, por njohja e prirjeve të tyre mund të ndihmojë në vlerësimin kritik të informacionit.

- Zgjatjet e shfletuesit: Merrni parasysh përdorimin e shtesave të shfletuesit që tregojnë faqet e internetit të pabesueshme ose nxjerrin në pah përmbajtjen e kontrolluar nga faktet.

- Raportoni informacion të rremë: Përdorni mjetet e raportimit të ofruara nga platformat e mediave sociale për të raportuar dezinformata ose përmbajtje të dëmshme.

Duke ndjekur këto rekomandime, përdoruesit e mediave sociale mund të kontribuojnë në një ekosistem informacioni më të shëndetshëm, duke siguruar që përmbajtja që ata konsumojnë dhe ndajnë të jetë e saktë, e besueshme dhe e dobishme për shoqërinë.

Referencat

Allcott, H., & Gentzkow, M. (2017). Social media and fake news in the 2016 election. *Journal of Economic Perspectives*, 31(2), 211-236. <https://doi.org/10.1257/jep.31.2.211>

Bruns, A., & Highfield, T. (2016). From news blogs to news on Twitter: Gatewatching and collaborative news curation. In A. Bruns, E. Skogerbø, C. Christensen, A. Olof Larsson, & G. Enli (Eds.), *The Routledge Companion to social media and Politics* (pp. 325-338). Routledge.

<https://eprints.qut.edu.au/215471/1/Gatewatching%2Band%2BNews%2BCuration%2B%282018%29.pdf>

Chadwick, A., & Vaccari, C. (2019). News sharing on UK social media: Misinformation, disinformation, and correction. *New Media & Society*, 21(2), 356-375. https://repository.lboro.ac.uk/articles/report/News_sharing_on_UK_social_media_misinformation_disinformation_and_correction/9471269

Gaitho, M. (2022). What Is the Real Impact of social media? Retrieved from Simplilearn.com website: <https://www.simplilearn.com/real-impact-social-media-article>

Guess, A., Nagler, J., & Tucker, J. (2019). Less than you think: Prevalence and predictors of fake news dissemination on Facebook. *Science advances*, 5(1), eaau4586. <https://doi.org/10.1126/sciadv.aau4586>

Tandoc, E. C., Lim, Z. W., & Ling, R. (2018). Defining "fake news": A typology of scholarly definitions. *Digital Journalism*, 6(2), 137-153. https://www.researchgate.net/publication/319383049_Defining_Fake_News_A_typology_of_scholarly_definitions

Newman, N., Levy, D. A. L., & Nielsen, R. K. (2023). Reuters Institute Digital News Report 2023. *SSRN Electronic Journal*. <https://doi.org/10.2139/ssrn.2619576>

Pariser, E. (2011). *The filter bubble: How the new personalized web is changing what we read and how we think*. Penguin Books. https://hci.stanford.edu/courses/cs047n/readings/The_Filter_Bubble.pdf

- Pew Research Center. (2021). News use across social media platforms in 2021. <https://www.pewresearch.org/journalism/2021/09/20/news-consumption-across-social-media-in-2021/>
- Silverman, C. (Ed.). (2013). Verification handbook: An ultimate guideline on digital age sourcing for emergency coverage. European Journalism Centre. https://www.google.com/url?sa=i&url=https%3A%2F%2Fjournals.eu%2Fpliki_artykulu_czasopisma%2Fpelny_tekst%2Feb50e776-1534-4c89-a10b-44f3b21eae48%2Fpobierz&psig=AOvVaw0TWit6e3bigCHKKxsjhENG&ust=1718231182510000&source=images&cd=vfe&opi=89978449&ved=0CacQrpoMahcKEwiIvf6LzNSGAxUAAAAAHQAAAAAQBA
- Sunstein, C. R. (2017). Republic: Divided democracy in the age of social media. Princeton University Press. <https://www.degruyter.com/document/doi/10.1515/9781400890521/html>
- Vosoughi, S., Roy, D., & Aral, S. (2018). The spread of true and false news online. *Science (New York, N.Y.)*, 359(6380), 1146-1151. <https://ide.mit.edu/wp-content/uploads/2018/12/2017-IDE-Research-Brief-False-News.pdf>

Gjuha e urrejtjes në mediat sociale, pasojat dhe zgjidhjet e mundshme

Artan Haraqia

Fakulteti i Komunikimit Masiv (Programi Master), Kolegji AAB

Email: artan.haraqia@aab-edu.net

Abstrakt

Rritja e mundësive të komunikimit, marrja dhe ndarja e shpejtë e informacionit dhe rritja apo plotësimi i dijës individuale e shoqërore, janë disa prej elementeve pozitive që kanë sjellur në shoqërinë tonë rrjetet sociale. Por, në të njëjtën kohë, rrjetet sociale u kanë dhënë të drejtën e fjalës legjioneve të idiotëve (Eco 2015). Toni i bisedës në internet është bërë dukshëm më agresiv vitet e fundit pasi platformat e rrjeteve sociale janë shfaqur si një hapësirë në të cilën lulëzon armiqësia dhe gjuha e urrejtjes (Mondal, 2017). Në mesin e efekteve negative, gjuha e urrejtjes mbetet ndër më shqetësueset edhe në Kosovë. Prandaj, qëllimi i kryesor i këtij punimi është që përmes analizës së përmbajtjes së komenteve të verifikojë dhe të analizojë disa prej rasteve të përditshme të shfaqjes së gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, me theks të veçantë në rrjetin social Facebook, si rrjeti më i përdorur në vendin tonë. Të ndajë ato sipas temave dhe të tentojë të identifikoj nxitësit dhe ndjekësit. Në fokus të këtij punimi është vënë edhe trajtimi ligjor e shoqëror që i bëhet kësaj dukurie. Pa pretenduar që të japë zgjidhje përfundimtare, punimi synon gjithashtu të përmend disa shembuj konkret dhe disa mundësi, të paktën, për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale.

Paralajmërim: Emrat dhe fotografitë e komentuesve si dhe fjalët e fyese dhe të papërshtatshme janë mbuluar.

Fjalë kyç: gjuhë e urrejtjes, rrjetet sociale, internet, nxitje

Hyrje

Gjuha e urrejtjes në internet është një fenomen gjerësisht i dukshëm pa një përkufizim të pranuar botërisht. Megjithatë, koncepti i gjuhës së urrejtjes si i tillë nuk është një fenomen i ri, pasi me zhvillimin e internetit dhe ndryshimet në sjelljen e përdoruesve kanë zgjeruar përkufizimin e tij dhe tani ai përfshin akte të shumta të të folurit dhe sjellje të tjera të vrazhda dhe të papranueshme nga shoqëria online dhe offline (Assimakopoulos et. al., 2017; Laaksonen et al., 2020). Gjuha e urrejtjes është një term me kuptime të ndryshme dhe nuk ka një përkufizim të vetëm dhe të qëndrueshëm. Përkufizohet nga Fjalori i Kembrixhit si "fjalë publike që shpreh urrejtje ose inkurajon dhunën ndaj një personi ose grupi bazuar në diçka të tillë si raca, feja, seksi ose orientimi seksual". Enciklopedia e Kushtetutës Amerikane thotë se gjuha e urrejtjes "zakonisht mendohet se përfshin komunikime armiqësore ose përcmimi të një individi ose një grupi për shkak të një karakteristike grupi si raca, ngjyra, origjina kombëtare, seksi, paaftësia, feja ose orientimi seksual". Nuk ka asnjë përkufizim të vetëm se çfarë përbën "urrejtje" ose "përcmim". Përkufizimet ligjore të gjuhës së urrejtjes ndryshojnë nga vendi në vend. Interneti dhe mediat sociale janë bërë një vend ideal për rritjen e gjuhës së urrejtjes në internet, e cila konsiderohet një problem serioz dhe përbën temën e një debati publik ndërkombëtar dhe nismave që synojnë të

gjejnë zgjidhje që synojnë të kufizojnë shpërndarjen e Gjuha e urrejtjes në internet, e cila është një detyrë problematike (Kovács, Alonso, & Saini, 2021; Tontodimamma et al., 2021).

E përderisa gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale vazhdon të mbetet temë shqetësuese në tërë botën, e cila megjithatë po bën përpjekje maskimale për përmirësimin e situatës, në Kosovë, aty ku duket se askush nuk po bën asgjë në këtë drejtim, gjuha e urrejtjes pothuajse është kthyer në një normalitet të përditshmërisë sonë.

Në një vend në tranzicion post - konfliktual, me shkallë të lartë të varfërisë, me nivel të ulët të arsimimit e vetëdijes qytetare, por me shtrirje enorme të internetit dhe qasje të lartë në rrjete sociale, gjuha e urrejtjes ka gjetur një shtrat të mirë për të rrjedhur lirshëm, në shumicën e rasteve, e pa kontrolluar dhe e pa penguar nga shteti dhe shoqëria.

Duke funksionuar si e tillë, dukuria e shpërndarjes së gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, cdo ditë e më tepër po sjellë ndikim të keq në shoqërinë kosovare, shpesh herë duke nxitur dehumanizim, ndasi, urrejte e deri tek dhuna psikike e fizike.

Gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale në Kosovë është e përhapur pothuajse në secilin segment të jetës, por politika, feja, orientimi seksual, ndarja në baza etnike, racore e gjinore, janë pistat “më të preferuara” për “dhunuesit online”.

Qëllimi i punimit

Qëllmi i kryesor i këtij punimi është të verifikojë dhe të analizojë disa prej rasteve të përditshme të shfaqjes së gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale, më konkretisht në rrjetin social Facebook, i cili vazhdon të mbetet kanali më i përdorur në vendin tonë. Të ndajë ato sipas temave dhe të tentojë të gjejë nxitësit dhe ndjekësit.

Një fokus në këtë punim është vënë edhe në trajtimin ligjor e shoqëror që i bëhet kësaj dukurie.

Ky punim synon të përmend disa nga dëmet që po i shkaktohen shoqërisë nga vala e dhunës online si dhe pasojat eventuale që mund të paraqiten në vitet e mëvonshme.

Pa pretenduar që të japë zgjidhje përfundimtare, punimi synon gjithashtu të përmend disa shembuj konkret dhe disa mundësi, të paktën, për parandalimin dhe zvogëlimin e dukurisë së gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale.

Objektivat e punimit

- Të informojë lidhur me dukurinë e përdorimit dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale
- Të shpjegojë rëndësinë që ka studimi i kësaj dukurie
- Të analizojë ndikimet dhe pasojat që ka përdorimi dhe nxitja e gjuhës së urrejtjes
- Të ndërjegjësoje masën lidhur me problematikën me qëllim reduktimin e saj

Rezultatet e pritura

Pasqyrimi i realitetit. Shkaqet dhe pasojat e gjendjes aktuale. Mangësitë dhe përparësitë në prespektivë.

Metodologjia

Metoda e përdorur në këtë punim është e bazuar në analizën kualitative të disa rasteve të shfaqjes së gjuhës së urrejtjes në rrjete sociale, përkatësisht në Facebook, si njëra prej platformave më të përdorura në Kosovë. Gjithashtu punimi tenton të sjellë edhe një analizë të personave dhe subjekteve të ndryshme, si nxitës dhe përkrahës të kësaj dukurie.

Politika, motivuesi kryesor i gjuhës së urrejtjes

Ndonëse me rënie të intensitetit, shfaqja e gjuhës së urrejtjes që për temë e ka politikën ditore ende vazhdon të mbetet në nivel të frikshëm. Akuzat për tradhëti, për vjedhje e korrupsion, mbeten të vazhdueshme, sidomos në pjesën e komenteve që vijnë nga qytetarët. Sidomos në periudha kritike, si gjatë zgjedhjeve, koncepti i gjuhës së urrejtjes mund të jetë i prirur për manipulim: akuzat për nxitje të gjuhës së urrejtjes mund të tregtohen mes kundërshtarëve politikë ose të përdoren nga ata në pushtet për të frenuar mospajtimin dhe kritikën (Gagliardone 2015).

Por, jo në pak raste, këto komente motivohen edhe nga vet njerëzit e politikës, të cilët lëshojnë akuza e kundër akuza për kundërshtarët e tyre politik. Kjo ndodhë sidomos afër apo gjatë fushatave zgjedhore, por nuk mungojnë as në ditë të zakonshme pune, qoftë në seanca të rregullta të kuvendit, qoftë në studio televizive, deklarata këto që më pastaj publikohen në rrjete sociale përmes mediave online dhe faqeve e platformave të ndryshme.

“Në shtator të vitit 2021, pak para zgjedhjeve lokale, me iniciativë të Institutit “Demokraci për Zhvillim” (D4D), ishte nënshkruar Deklarata e Mirësjelljes nga disa organizata të shoqërisë civile, partitë politike dhe mediat, me zotimin se palët do të përmbaheshin nga diskursi negativ në rrjete sociale. Mirëpo, këtij zotimi nuk u ishin përmbajtur plotësisht partitë politike. Ka qenë D4D-ja ajo që gjatë dy rundeve të zgjedhjeve ka bërë monitorimin e rrjeteve sociale dhe nga analizimi i mbi 6 mijë artikujve, janë konstatuar 198 shkelje të Deklaratës së Mirësjelljes, më së shumti në “Facebook”, e ku dominuese ka qenë gjuha e urrejtjes.

Pra, komunikimi politik del të jetë ndër burimet kryesore të gjuhës së urrejtjes. Liderët politikë nuk janë të vetëdijshëm mjaftueshëm për përgjegjësinë që bart fjala e tyre dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes, sidomos në rrjetet sociale të cilat në pamundësi të një vetëkontrolli të mirëfilltë shërbejnë si çerdhe për përhapjen e kësaj gjuhe.

Një nga shumë shembujt e këtij lloji, ishte “lufta” me deklarata e presidentes aktuale të Kosovës Vjosa Osmani dhe kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama. Kjo betejë, dhe të tjera të kësaj natyre mes politikanësh, kishin nxitur një mori komentesh nga ana e qytetarëve, me gjuhë ekstreme të urrejtjes.

Publikos • Follow
Jul 8, 2022 · 🌐

Vjosa Osmani Sulmon Ramën: Vëlla Me Vuçiçin Dhe Vëlla Me Albin Kurtin Nuk Mund Të ...

news.truenewsq.com
Vjosa Osmani Sulmon Ramën: Vëlla Me Vuçiçin Dhe Vëlla Me Albin Kurtin Nuk Mund Të ... – Lexo

👍 271 73 comments · 10 shares

👍 Like 💬 Comment ➦ Share

Foket i ke kacurrel dhe te gjata por je drit shkurter
1y Like Reply

Vallahi as ti zdel e paqt hiq veq te baba me tprek pak del ni e dikujt qe jav ka nanen shiptarve edhe mas me kan qashtu ti nuk ishe qetu kuje presidente ...
1y Like Reply

Bravo bravo mbretëresha e shqiptarisë
1y Like Reply

ti duhesh mepas kujdes per udhëheqsat shqiptar drejtone shtetin ton erama edrejton tevetin ju kryni pushimet naper detna te huj dhe akuzone shqiprin membrojt tradhtit ejuve zoti jumarroft po ku nuk eharrut idejen e baballarve mepunu per komunizum
1y Like Reply

a kralic bre, ska vlla me ata qe tka pre e tka perzan, po kta e bojn veq l me e drenices e dukagjinit
1y Like Reply

Të nxitura nga deklaratat e shpeshita politike, komentet fyese të militantëve partiakë nuk mungojnë as kundër korit diplomatik apo përfaqësuesve të shteteve euro – atlantike, të përfshira në zhvillimet politike në vendin tonë.

Një shembull i tillë është edhe fotoja e mëposhtme, në të cilën mund të shihen disa komente fyese e kërcënuese ndaj ambasadorit amerikan në Kosovë Jeffrey M. Hovenier, të bëra pas një deklaratë të tij në lidhje me gjendjen në veriun e Kosovës. Komentet shkojnë aq largë, sa që ambasadori Hovenier dhe shteti që ai përfaqëson shpallen si armiq të Kosovës, ndërsa ngritet lartë presidenti rus Vladimir Putin.

👍 35 >

Me pas lendu ni i minire kjaemeti ish bo për neve edhe me kejt amarin me qetsim kit pun
7m Like Reply 5

Qishtu thojn kta niher ather me ba me arrestu kand thojn jeni ka e tensiononi situaten!
9m Like Reply 1

Valla nja me arrestu po tranoni tine aj serbi lajqaku escobari met po ju lan tash ban filma kty kishe pe denoj
2m Like Reply

frikacakëve Amerikan ju Veq Putin Kingu jav mother
2m Like Reply

Ftyren si dhe presim drejtsi nga kta
5m Like Reply

Shko ne se qasi i jeni edhe ji
5m Like Reply

Diskursi negativ i komenteve në Facebook, kryesisht është rritur pas hyrjes në skenën politike të organizatës politike Lëvizja Vetëvendosje. Duke akuzuar gjithkënd që është deklaruar kundër

këtij subjekti, e për gjithçka që ka ndodhur në Kosovë, anëtarët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, kanë ndikuar dukshëm në ngritjen e nivelit të komenteve fyese dhe me gjuhë përjashtuese e të urrejtjes. Gjatë vitit 2023, vetëm brenda dy javësh, janë dënuar dy persona për shfaqje të gjuhës së urrejtjes në Facebook, ndaj dy figurave politike në Kosovë, ish kryeministrit Avdullah Hoti dhe deputetes Ganimete Musliu. Në të dyja rastet, të dënuarit kanë deklaruar para gjykatës se në menyrë indirekte kanë qenë të motivuar politikisht nga subjekti politik që qeverisë me vendin, Lëvizja “Vetëvendosje”. Jo në pak raste, kjo organizatë politike akuzohet nga kundërshtarët, mediat dhe shoqëria civile si nxitëse dhe motivuese e gjuhës së urrejtjes, që rrjedhë fillimisht nga vet deklaratat e anëtarëve të këtij subjekti kundër secilit grup apo individ që guxon të shpehtë mendim ndryshe nga bindjes e tyre.

Gjuha e urrejtjes, shpesh motivohet edhe nga mediat!

Nuk janë të rralla rastet, kur për qëllime thjeshtë të klikimeve apo edhe të krijimit të bindjes apo të opinionit ndryshe, media apo faqe të mediave në rrjete sociale postojnë tekste apo video, të cilat mbrapa kanë një vegëz që mundëson dhe nxitë komentet me gjuhë të urrejtjes.

Nëse një faqe e një mediumi në rrjetin social Facebook, poston një fotografi të një politikani me pyetjen: Cfarë mendoni për këtë politikan? atëherë gjasat do të jenë shumë të mëdha, që mbi gjysma e komenteve të jenë negative dhe me gjuhë konkrete të urrejtjes apo fyerjes.


Një shembull i tillë, paraqitet në foton e mëposhtme, me kryetarin e subjektit politik BDI në Maqedoninë e Veriut, Ali Ahmeti.



news33.tv
Sot feston ditëlindjen Ali Ahmeti
Cfarë mendoni për këtë politikan?
Jan 4, 2021 · 🌐



Por, nëse news33.tv mund të jetë një faqe anonime dhe pa shumë ndikim, mundësi të tilla ofrojnë edhe mediumet që konsiderohen si më serioze dhe me besueshmëri të lartë tek qytetarët. Shembull më i freskët është televizioni Klan Kosova, i cili përmes postimeve të shpeshta e ndonjëherë edhe me tituj provokues të informacioneve nga programi “Big Brother”, krijon hapësirë për nxitjen e komenteve urrejtëse e fyese nga qytetarët.



Nga diçka e shenjtë dhe personale, feja po kthehet në arenë të dhunës?

Tradicionalisht, feja në Kosovë është konsideruar si diçka e shejtë dhe bindje e vullnet personal për secilin njeri. Përgjatë viteve, fetë në Kosovë kanë bashkëjetuar në harmoni të plotë e në shumë raste klerikë të ndryshëm edhe kanë bashkëpunuar në aktivitete në shërbim të popullit dhe Kosovës në përgjithësi.

Por, sot, falë edhe shtrirjes së madhe të rrjeteve sociale, feja është kthyer në një motiv të fuqishëm për nxitje të dhunës dhe urrejtjes në mes të njerëzve.

Në krijimin e kësaj atmosfere, nuk janë pa ndikim edhe klerikë të ndryshëm e personalitete tjera publike, postimet e të cilëve janë të mbushur me dhunë e urrejtje ndërfaqetare.

Shembulli i më poshtëm i takon një imami në Kosovë, i cili në ditën e vdekjes së babait të Ramush Haradinajt, nuk ka hezitur të postojë akuza e ofendime ndaj ish – kryeministrit të Kosovës. Ai kishte kërkuar që hoxhallarët të mos marrin pjesë në varrimin e Hilmi Haradinajt.



Nga ana tjetër, edhe deklaratat që nxisin komente islamofobe janë tejet të shpeshta nga personalitete dhe individë të ndryshëm. I tillë është rasti i një shkrimtari të njohur, i cili në shumë raste edhe publikisht nxitë debate kundër fesë islame e rrjedhimisht nxitë edhe gjuhë të urrejtes nga komentuesit, përkrahës të tij.



16 >



Most relevant ▾



Leni keta me lesh se dreqen jane

1y Like Reply

Gjuha e Urrejtjes në baza gjinore dhe të orientimit seksual

“Kur një grua u dhunua seksualisht në një qytet të Kosovës, një komentues shkroi në rrjete sociale: “Hajt se nuk është dhunuar fare, por ajo ka dashur vet”. Kjo dhe disa komente të kësaj natyre, janë publikuar së fundmi nga Organizata D4D, në një hulumtin të bërë përgjatë vitit 2022 e të publikuar në vitin 2023, e në të cilin është analizuar gjuha e urrejtjes në baza seksiste, të orientimit seksual, të qytetarëve të etniteteve pakicë dhe të personave me aftësi të kufizuara.

“Raporti përfshinë monitorimin e periudhës Janar-Tetor të vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar 20,585 artikuj, prej të cilave janë analizuar 3461 lajme (me përmbajtje të evidentuar të gjuhës së urrejtjes, seksiste apo raciste) nga mediat ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë me fokus gratë, komuniteti LGBTI+, minoritetet etnike dhe personat me aftësi të kufizuara, dhe shpërndarjes së tyre në rrjete sociale.”.

Gjuhë të urrejtjes së kësaj natyre mund të haset në shumë raste edhe tek aktivistet apo aktivistët që mbrojnë të drejtat e kësaj pjese të shoqërisë. I tillë është rasti i aktivistes Arta Avdiu, në një status të saj përmes së cilit e kishte dënuar vrasjen e një gruaje nga bashkëshorti i saj, të dy shqiptar me banim në Gjermani.



Krimet e pasionit njihen në tërë boten. Nuk mund te pergjithesohet në kete menyre ky fenomen sikur te tërë meshkujt shqiptare kane tendence për te vrare grate, apo ish-grate. Si kudo, edhe për shqipot, nqs ndahen jeta vazhdon. Natyrisht, gjithandej ka dhe do kete psikopate qe kryejne krime te kesaj natyre.

33w Like Reply

11



David Miko krimet e pasionit nu...

View 14 more replies...



Oj e menqur, e gjithëdijshme! Nuk përfshihet një komb i tërë në një rast krimi! Pyete veten njëhere , kush je ti me thanë KULTURA SHQIPTARE ! A e din ti se njëqind herë më shumë raste ndodhin tek kombet tjera sesa tek kombi shqiptarë!

33w Like Reply

4



Kur fol per moral prite kiametin.

33w Like Reply

4



Nje grua u vra edhe dje ketu ne Amerik,po sdo me than qe krejt Amerika jan vrases

Situatë dukshëm më alarmante e shprehjes së gjuhës së urrejtjes mund të shihet edhe në rastet e promovimit të komunitetit LGBTI. Vetëm në 6 komente tek një njoftim për organizimin e Paradës së Krenarisë në Prishtinë, mund të gjesh, në shenjë hakmarrje, lutje për ringjalle të Enver Hoxhës, Adolf Hitlerit e deri tek Slllobodan Milloshevicit. Po aty mund të gjesh edhe thirrje për “pastrim” të botës.



Çfarë bën shteti?

Në Kosovë, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik është e ndaluar. Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje ose mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike apo grupe të tjera të tilla, që jetojnë në Republikën e Kosovës, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 5 vjet.

Por, ky “kërcënim” thjeshtë duket se përfundon aty ku edhe ka nisur, në letër.

Policia e Kosovës apo institucionet e drejtësisë në vend nuk kanë paraqitur ndonjëherë ndonjë statistike për rastet eventuale të arrestimit dhe dënimit të personave që kanë pasur qasje të dhunës apo urrejtjes në shkrimet apo komentet e tyre. Megjithatë, nga shënime të cunguara, të grumbulluara nga organizata të ndryshme joqeveritare, mendohet se brenda 4 viteve, 2016-2019, janë arrestuar vetëm dy persona që kanë përdorur gjuhën e urrejtjes në rrjete sociale. Ndërsa, në vitin 2020, 2021 dhe 2022 nga dy raste për secilin vit.

Nga ana tjetër, shoqëria civile në vazhdimësi kritikon autoritetet se gjuha kërcënuese në media sociale nuk trajtohet njësoj kur ajo është e drejtuar ndaj politikanëve dhe ndaj qytetarëve.

Pasojat

Shumë studime shkencore japin idenë se përdorimi i gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale mund të shkaktojë plagë më të thella sesa ndjenjat e lënduara në të dy nivelet: shoqërore dhe personale. Kërkimet neurologjike dhe sociologjike kanë vërtetuar se gjuha e urrejtjes çon në 'një efekt dehumanizues' i cili zvogëlon ndjeshmërinë tonë për njerëzit e tjerë. Gjuha e urrejtjes jo vetëm që përforcon paragjykimet dhe stereotipet në shoqëri (Citron dhe Norton, 2011), por gjithashtu ka një ndikim negativ në shëndetin mendor dhe emocional të grupeve të synuara, veçanërisht të individëve të synuar (Citron dhe Norton, 2011; Festl & Quandt, 2013). Gjuha e urrejtjes manifestohet si një akt komunikimi fytes, përjashtues, frikësues ose diskriminues kundër një grupi të caktuar jashtë Schulzke (2016); Simpson (2013).

Sipas studiuesit gjerman Albrecht Koschorke, lejimi i shpërndarjes së gjuhës së urrejtjes në rrjete sociale çon në dehumanizimin e shoqërisë dhe interneti po merr kahje të kundërt nga ideja fillestare e zbulimit të tij. Deri më sot, këto shpresa të mëdha në potencialin emancipues të publikut dixhital kanë hasur në zhgënjim: në publik dhe në diskursin shkencor, janë më tepër fenomenet jofunksionale që vijnë nga formimi i publikut dixhital ato që janë bërë të dukshme. Ajo që ne shohim është gjuha e urrejtjes, radikalizimi, vulgarizimi dhe brutalizimi i diskursit, komunikimi polemizues dhe antagonist, forma fyerjeje dhe përçmimi, si dhe shpifje dhe pacipësi. Publiku dixhital që dikur supozohej të avanconte integrimin e shoqërive të diferencuara dhe pluraliste në një unitet racional, kanë zhvilluar një mënyrë komunikimi që ka ardhur duke u perceptuar si tërbimi irracional i një turme dixhitale. Ato prodhojnë patologji të fjalës publike dhe minojnë themelet e demokracisë duke polarizuar dhe radikalizuar konfliktet. Si pasojë, platformat gjithnjë e më shumë duken të jenë media de-civilizimi (Koschorke, 2021).

Megjithëse gjuha e urrejtjes është një shprehje fyese dhe e ulët e mospajtimit, ajo mund të konsiderohet gjithashtu si një dritare drejt tensioneve dhe pabarazive të rrënjësura thellë, të cilat vetë duhet të adresohen përtej çështjeve të thjeshta të të folurit dhe përtej dimensionit online. Nga pikëpamja normative, komunikimi i urrejtjes mund të ketë pasoja të rënda për demokracitë liberale (Papacharissi, 2004).

Rekomandime

Trajtimi i gjuhës së urrejtjes vazhdon të mbetet njëra prej sfidave më të mëdha për shoqërinë tonë. Përveç shumë aspekteve tjera, sfiduese vazhdon të mbetet edhe mos përcaktimi i drejtë se çfarë në të vërtetë është gjuha e urrejtjes dhe cili është dallimi apo tejkalimi i saj nga liria e të shprehurit.

Për çdo Makiaveli që nxit ligjin të ndalojë fjalimin që shkakton urrejtje ndaj shtetit, ekziston një Walt Whitman që na nxit të 'urrejmë tiranët'" (Post et al. 2009).

